

Raport përfundimtar

**Raport kërkimor, analiza e kuadrit legjislativ dhe rregullator kombëtar shqiptar në zbatim të
standardeve EITI**

Raport përfundimtar

Data e dorëzimit
25/01/2017

EUROSUPPORT E

Të dhënat e projektit

Vendndodhja e projektit:	Tiranë, Shqipëri
Data e fillimit të Projektit:	08/08/2016
Data e përfundimit të projektit:	31/12/2016

Të dhënat e kontraktorit

Emri i kompanisë:	Eurosupport-Fineurop Support S.r.l.
Personi i kontaktit:	Z. Marco Sebastiani
Adresa postale:	Via Santa Margherita 6, 20121 Milano
Numër telefoni:	+39 02 7749311
E-mail:	m.sebastiani@fineurop.it
Skype:	marcosebastiani

Shënim: Mendimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimin zyrtar të Bankës Botërore dhe Sekretariatit EITI në Shqipëri.

Përmbledhje ekzekutive

Burimet nxjerrëse përbëjnë pasurinë e një vendi dhe konsiderohen si burime thelbësore të qeverisë për të financuar, shpeshherë nën presion, shpenzimet dhe zhvillimet kombëtare, përfshirë shpenzimet sociale dhe komunitare. Për këtë arsye, keqmenaxhimi i tyre mund të sjellë pasoja të rënda dhe të rrisë pakënaqësitë dhe kritikën publike. Për të shmangur këto pasoja, duhet të vlerësohet me kujdes dhe të promovohet në vazhdimësi mirëqeverisja në sektorin e industrisë nxjerrëse për të siguruar një efektivitet të lartë.

Ky raport synon rishikimin e përputhshmërisë së legjislacionit përkatës shqiptar kundrejt zbatimit të standardeve EITI. Ky raport i është referuar kërkesave të Standardit EITI 2016, të cilat zëvendësuan kërkesat EITI të vitit 2011, pasi Shqipëria, si vend zbatues i EITI, duhet të vlerësohet në lidhje me standardet e reja. Ky raport thekson mangësitë dhe identifikon ndryshimet dhe/ose shtesat që duhet të pasqyrohen në pjesët korresponduese të legjislacionit përkatës, me qëllim që të sigurohet jo vetëm përputhshmëria me standardet EITI, por mbi të gjitha transparenca dhe llogaridhënia në mënyrën e mbledhjes dhe përdorimit të të ardhurave të gjeneruara nga industria nxjerrëse në Shqipëri. Në këtë drejtim, objekt i hartimit të këtij Raporti, nuk janë vetëm ligjet që mbulojnë sektorët e industrive nxjerrëse, por edhe ligjet tatimore apo legjislacioni sekondar përkatës. Në këtë aspekt, ky raport synon të bëjë një rishikim të plotë dhe gjithëpërfshirës të të gjithë kuadrit ligjor dhe institucional që rregullon përdorimin e duhur të pasurive të burimeve natyrore të Shqipërisë.

Qëllimi kryesor i këtij rishikimi është përmirësimi i kuadrit ligjor kombëtar duke e harmonizuar atë me standardet EITI. Vendeve anëtare të EITI i kërkohet që të prodhojnë raporte periodike EITI, për të vlerësuar pajtueshmërinë e qeverisë së tyre me standardet EITI, si dhe për të identifikuar fushat të cilat ende kanë nevojë për përmirësim. Raportet EITI përkufizohen nga EITI si “*në zemër të iniciativës*”. Për këtë arsye, paraqitet me rëndësi që procesi i raportimit EITI, i cili sjell prodhimin e Raportit EITI, të kryhet në mënyrë të tillë që të përmbajë një informacion në kohë, të plotë, të besueshëm dhe të kuptueshëm. Gjithashtu, me rëndësi në këtë drejtim është dhe realizimi i një procesi të qartë për grumbullimin e të dhënave përkatëse, nëpërmjet përdorimit të mekanizmave efektivë të publikimit të informacioneve shpjeguese, të cilat duhet të zbatohen sipas rastit.

Në këtë drejtim, është thelbësore përfshirja e të gjithë aktorëve si institucionet qeveritare, kompanitë që ushtojnë aktivitetet në sektorin e industrisë nxjerrëse dhe organizatat e shoqërisë civile. Po aq thelbësore është, dhe rishikimi i vazhdueshëm i situatës ekzistuese në zbatimin e standardeve EITI, në mënyrë që të hartohet një plan udhëzues për të ndihmuar më tej në dorëzimin e suksesshëm të tij dhe në arritjen e objektivit të përgjithshëm të menaxhimit transparent dhe të përgjegjshëm të burimeve të naftës, gazit dhe mineraleve të vendit.

Referuar sa më lart, kjo detyrë do të konsistojë në kryerjen e një rishikimi ligjor gjithëpërfshirës të ligjeve ekzistuese, VKM-ve, dhe akteve nënligjore të Ministrit që rregullojnë sektorin e naftës, gazit dhe mineraleve si edhe sektorin e hidroenergjisë, përfshirë dhe rishikimin e çdo dispozite të lidhur me këto fusha të legjislacionit tatimor dhe doganor. Objektivi i përgjithshëm është përcaktimi i të gjitha hapave të nevojshme, që duhet të ndërmerren për të përmirësuar procesin e raportimit EITI në Shqipëri, duke identifikuar çdo mangësi ose pengesë në legjislacionin kombëtar në lidhje me zbatimin e suksesshëm të Standardeve EITI. Përveç kësaj, ky raport ofron propozime konkrete dhe rekomandime për çdo akt ligjor dhe nënligjor përkatës, që do të ndryshohet apo të prezantohet për herë të parë, në bazë të gjetjeve që rrjedhin nga ky vlerësim ligjor. Kuadri i përmirësuar ligjor dhe rregullator do të synojë të sigurojë një grumbullim të të dhënave dhe një proces raportimi të standardizuar, në kohë, dhe të plotë.

Në zhvillimin e kësaj detyre, një vëmendje e veçantë i kushtohet përcaktimit të përgjegjësivë të aktorëve publikë dhe privatë të cilët, për shkak të misionit dhe rolit, kanë përgjegjësinë të publikojnë të dhëna, t'i vendosin në dispozicion të publikut dhe të sigurojnë që të dhënat e publikuara të jenë të besueshme. Informacioni duhet të paraqitet në të njëjtën metodë/metodologji në mënyrë që të mund të dallohet progresi i arritur nga raportimet e mëparshme.

Që nga viti 2009, kur u pranua si një vend kandidat i EITI, Shqipëria ka ndërmarrë disa hapa për të përmirësuar transparencën e menaxhimit të burimeve të industrisë nxjerrëse. Në vitin 2013, Shqipëria iu bashkua nismës EITI si një vend anëtar, por sërish ekziston nevoja për përmirësim. Rishikimi ligjor është kryer për të siguruar që legjislacioni ekzistues përkatës të përafrohet sa më shumë të jetë e mundur me standardet EITI. Praktikën më të mira ndërkombëtare dhe legjislacioni/udhëzimet e BE-së përbëjnë gjithashtu një pjesë integrale të procesit të përgjithshëm të shqyrtimit, pasi ato ofrojnë një mjet të vlefshëm për të vlerësuar nivelin e përputhshmërisë dhe identifikimin e sfidave të mundshme në zbatimin e strategjive.

Gjetjet dhe rekomandimet e raportit final janë prezantuar në formën e tabelave të përputhshmërisë, si Aneksë bashkëngjitur dhe pjesë e këtij raporti. Përveç kësaj, ekipi i zbatimit të projektit ka propozuar dhe hartuar masa korriguese ligjore për të siguruar përputhjen më të mirë të mundshme me standardet EITI dhe standardet e tjera ndërkombëtare për të përmirësuar administrimin e financave dhe përgjegjësi publike, si dhe për të inkurajuar standarde të larta transparence.

Gjetjet dhe rekomandimet kryesore të përzgjedhura:

Më poshtë janë prezantuar gjetjet dhe rekomandimet kryesore që dalin nga ky rishikim ligjor. Informacione më të hollësishme mbi gjetjet dhe rekomandimet janë përfshirë në anekset bashkëngjitur këtij raporti.

1. Qeveria Shqiptare ka treguar angazhimin e saj në zbatimin e nismës ndërkombëtare të EITI me qëllim përmirësimin e transparencës në lidhje me pagesat dhe të ardhurat nga sektorët e industrisë nxjerrëse dhe sektori i hidroenergjisë, nëpërmjet krijimit të Sekretariatit EITI dhe të Grupit Shumë-palësh (MSG). Megjithatë, baza përkatëse ligjore duhet të rishikohet në

përputhje me Standardin EITI të vitit 2016. Përveç kësaj, qeveria duhet të angazhojë publikun, kryesisht në aktivitete në terren për të mbledhur reagimet nga grupet e interesit që ndodhen në rajonet e afektuara nga aktivitetet nxjerrëse;

2. Aspektet e lidhura me raportimin EITI, përfshirë përmbajtjen, afatet kohore dhe frekuencën janë dhënë në mënyrë sporadike në pjesë të ndryshme përkatëse të legjislacionit. Për të unifikuar këto procedura grupi i punës ka propozuar një projektligj të ri i cili vendos sanksione për zyrtarët përgjegjës për këtë raportim, në rast se nuk realizojnë dorëzimin e tij ose dorëzojnë raporte të paplota dhe/ose të pasakta;
3. Në bazë të Direktivës 2013/34/BE dhe Kërkesës 4 të EITI, Qeveria Shqiptare dhe parlamenti menjëherë duhet të miratojnë legjislacionin i cili transponon kushtet e Direktivës në ligjin përkatës kombëtar dhe më tej sugjerojmë modelimin e këtij projektligji në kushte të ngjashme me ato të Rregullores së Britanisë së Madhe. Kjo jo vetëm që do të plotësonte kriteret përkatëse të përcaktuara në Kërkesat EITI 4, por do të siguronte që çdo legjislacion i ri hartohet duke marrë parasysh zhvillimet e fundit ndërkombëtare, veçanërisht në dritën e kërkesës së anëtarësimit të Shqipërisë në BE.
4. Përkufizimi i pronësisë përfituese për kompanitë që ushtrojnë aktivitetin e tyre në sektorin e industrisë nxjerrëse dhe hidroenergjisë mungon në legjislacionin aktual në fuqi. Në këtë aspekt, ekipi i ekspertëve ka propozuar hartimin e dispozitave të reja për t'i dhënë kuptimin termit “pronësi përfituese”. Është e rëndësishme që të caktohen dhe dakordësohen limitet në përputhje me udhëzimet e fundit të BE-së. Në këtë drejtim grupi i punës rekomandon përfshirjen e një dispozite për caktimin e përqindjeve minimale për t'u kualifikuar si pronar përfitues në bazë të pjesëmarrjes dhe/ose kontrollit mbi shoqëritë që operojnë në sektorët e industrisë nxjerrëse dhe hidroenergjisë ose në shoqëritë që nuk ushtrojnë veprimtari ekonomike, por veprojnë si ndërmjetës, për kanalizimin e të ardhurave nga burime të tjera. Gjithashtu, rekomandojmë krijimin e një regjistri publik që përmban informacionin e kërkuar në lidhje me pronarët përfitues, regjistër i cili duhet të reflektojë çdo ndryshim në këtë drejtim.
5. Gjithashtu, rekomandohet që MSG të konsiderojnë dhe rishikojnë në bashkëpunim me palët e interesuara mënyrën më efektive për të mbledhur të dhëna për Pronësi Përfituese (PP)/Persona të Ekspozuar Politikisht (PEP) dhe në këtë kontekst duhet gjithashtu të marrë në konsideratë formën e deklarimit të PP (shih Aneksin 6), e cila duhet të përdoret nga kompanitë përkatëse për të siguruar këtë informacion për PP. MSG duhet të shqyrtojë nëse është e nevojshme organizimi i seminareve të rëndësishme për të siguruar që kompanitë të kuptojnë se çfarë është PP dhe pse është e rëndësishme që një informacion i tillë të jepet në mënyrë të saktë dhe në kohë.
6. Në shumicën e rasteve, pjesët përkatëse të legjislacionit respektiv, nuk përputhen me kërkesat e EITI. Për ilustrim, detyrimi për deklarimin plotë të taksave dhe të ardhurave në sektorin e hidrokarbureve, nuk është plotësisht në përputhje me kërkesat e EITI, pasi akti normativ që adreson këtë kërkesë, përcakton detyrimin të miratojë një akt nënligjor që të rregullojë këtë proces, i cili nuk është hartuar dhe miratuar akoma. Në të njëjtin kontekst, i vetmi akt administrativ që rregullon bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucioneve publike përkatëse në lidhje me importin, eksportin, prodhimin dhe transportin e hidrokarbureve, i shërben qëllimit kryesor për të identifikuar çdo shkelje të mundshme nga ana e operatorëve, por nuk siguron

asnjë detyrim për këto institucione për të siguruar transparencë për të dhënat, siç kërkohet nga EITI. Në këtë aspekt, ekipi i ekspertëve ka propozuar hartimin dhe miratimin e një akti nën-ligjor që rregullon procesin e raportimit nga Zyra e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave e të dhënave që i shërbejnë transparencës në këtë sektor;

Metodologjia

Në mënyrë që t'i shërbejë më mirë objektivave të detyrës, një metodologji e mirë-orientuar është thelbësore. Hartimi i një inventari të ligjeve kombëtare, VKM-ve ekzistuese dhe akteve nënligjore të Ministrit në sektorët e naftës, minierave dhe hidroenergjisë ishte pika e fillimit. Informacioni i mbledhur është shqyrtuar, analizuar dhe vlerësuar në mënyrë që të identifikohen mangësitë dhe niveli i përputhshmërisë në mes të kuadrit ligjor dhe rregullator shqiptar dhe standardit përkatës EITI. Edhe pse standardet EITI janë standardet themelore për qëllimet e këtij raporti, rishikimi legjislativ merr parasysh normat e tjera përkatëse ndërkombëtare.

Burimi kryesor në kryerjen e shqyrtimit të pengesave është kuadri ligjor në fuqi, duke përfshirë ligjet, vendimet e Këshillit të Ministrave dhe urdhërat/udhëzimet/rregulloret e miratuara në nivel ministrie. Ky raport merr gjithashtu parasysh disa studime kërkimore dhe raportin e botuar në Shqipëri dhe vende të tjera anëtare të EITI.

Ekipi i zbatimit të projektit i është referuar terminologjisë së dhënë në standardet EITI 2016 duke identifikuar veprimet e detyrueshme e fakultative që do të ndërmerren. Në përputhje me këtë terminologji, termi "Raporti EITI" i referohet informacionit dhe të dhënave që përbën detyrim në përputhje me standardet EITI.

Përveç kësaj, tabelat e përputhshmërisë janë hartuar për të prezantuar në mënyrë të strukturuar të gjitha gjetjet e dala nga analiza e mangësive në kuadrin ligjor dhe rregullator. Tabela e përputhshmërisë mbulon legjislacionin kombëtar në industrinë nxjerrëse dhe standardin përkatës EITI dhe tregon nëse legjislacioni shqiptar përputhet plotësisht/pjesërisht/nuk përputhet me standardet EITI të nevojshme për raportimin EITI.

Ky raport përfundimtar dhe anekset e tij gjithashtu paraqesin komente dhe rekomandime që kanë për qëllim përmirësimin e legjislacionit aktual drejt nevojës për përmirësimin e pjesëve të legjislacionit ekzistues pësa i përket përafrimit me standardet e detyrueshme EITI dhe norma të tjera ndërkombëtare.

Në përfundim, do të organizohet një seminar me aktorët kryesorë në mënyrë që të ndahen dhe të vleftësohen gjetjet e rishikimit, rekomandimet, si dhe të prezantohen projekt-aktet ligjore/nënligjore të propozuara.

Përshkrimi i projektit

Duke filluar nga muaji Maj i vitit 2013, Shqipëria njihet si “Vend që zbaton EITI”, që do të thotë se Shqipëria ka siguruar një proces efektiv për deklarimin vjetor dhe rakordimin e të gjitha të ardhurave të paguara për qeverinë nga industria nxjerrëse dhe sektori i hidroenergjisë.

Parimet EITI janë hartuar mbi besimin se pasuria e burimeve natyrore është një burim thelbësor për zhvillimin ekonomik të një vendi dhe se qytetarët dhe interesat kombëtare duhet të përfitojnë prej tyre.

Transparenca është në emër dhe në zemër të iniciativës EITI, i cili është një tipar që ushqen llogaridhënien në menaxhimin e financave publike, por edhe në bërjen biznes dhe jetën publike në përgjithësi. Kërkesat EITI kanë për qëllim të zbatohen në mënyrë të barabartë për të gjithë subjektet që i përkasin palëve të interesuara në EITI.

Nisma EITI përfshin një gamë të gjerë të palëve të interesuara, duke përfshirë institucionet dhe agjencitë qeveritare, kompanitë që operojnë në sektorin e industrisë nxjerrëse e hidroenergjisë dhe organizatat jo-qeveritare. Kjo u jep atyre një mundësi të barabartë për të dhënë mendime dhe rekomanduar zgjidhje për një qasje të realizueshme dhe efektive drejt publikimit të pagesave dhe të ardhurave.

Të gjitha vendet zbatuese, si Shqipëria, inkurajohen të tejkalojnë kërkesat e EITI, ndërsa këto kërkesa paraqesin vetëm kërkesat minimale për një vend zbatues. Për këtë qëllim standardet EITI specifikojnë kur një çështje është e detyrueshme duke përdorur termat "domosdoshmëri", "duhet" dhe "kërkohet". Në këtë aspekt, ky rishikim i referohet vetëm kërkesave minimale të cilat do të merren parasysh në vlerësimin e Shqipërisë drejt standardit të ri EITI 2016.

Raportimi EITI nuk përbën një format të përcaktuar dhe jo fleksibël për t'u plotësuar nga vendet zbatuese. Përkundrazi, vendet inkurajohen për të ndëruar sistemet dhe praktikën më të përshtatshme për mbledhjen e të dhënave EITI, publikimin e të dhënave dhe raportimin e tyre.

Procesi i përputhjes me standardet EITI përfshin agjenci të ndryshme shtetërore, detyrat dhe përgjegjësitë e të cilave në lidhje me publikimin e të ardhurave të marra nga kompanitë që kryejnë veprimtarinë e tyre në sektorët e industrisë nxjerrëse e hidroenergjisë janë të përcaktuara në ligje dhe akte nënligjore të veçanta. Për këtë arsye, është e nevojshme të përgatitet një përmbledhje e kuadrit specifik ligjor dhe rregullator dhe një analizë e roleve dhe përgjegjësi të agjencive përkatëse shtetërore.

Përveç kuadrit specifik ligjor dhe rregullator të industrisë nxjerrëse, ka dhe ligje të tjera që lidhen me këtë sektor. Për shembull, detyrimi i kompanive për të zbatuar rregullat tatimore dhe doganore rregullohen në akte të tjera. Ndërveprimi mes agjencive shtetërore si dhe mes kompanive që operojnë në fushën e naftës, gazit, minierave e hidroenergjisë duhet të koordinohet për të siguruar një publikim të saktë dhe në kohë të pagesave të bëra kundrejt qeverisë.

Legjislacioni shqiptar ka pësuar ndryshime në këtë drejtim, duke përfshirë në mënyrë të veçantë ndryshimet në ligjin e hidrokarbureve dhe ligjin për sektorin e minierave. Megjithatë, përmirësime të tjera janë ende të nevojshme. Si një masë e përkohshme, Sekretariati i EITI në Shqipëri ka nënshkruar disa Memorandume Mirëkuptimi me kompanitë e naftës dhe të gazit, si dhe me administratën fiskale në zbatimin e standardeve EITI, deri në momentin që kuadri ligjor do të mbulojë në mënyrë të duhur zbatimin e standardeve të tilla.

Objektivi i përgjithshëm

Qëllimi i Raportit EITI është të kontribuojë në debatin publik, në lehtësimin e reformave të qeverisë dhe në përmbushjen e kërkesave të Standardeve EITI. Kjo detyrë do të sigurojë një raport të përshtatshëm dhe gjithëpërfshirës i cili do të përfshijë një analizë të situatës aktuale, si dhe kërkon identifikimin e fushave kryesore për përmirësim me qëllim promovimin më të mirë të një bashkëpunim efektiv dhe të suksesshëm midis institucioneve qeveritare dhe operatorëve të biznesit në lidhje me mbledhjen e të dhënave cilësore dhe sasiore dhe procesin e raportimit në tërësi. Një proces i vazhdueshëm i mbledhjes së të dhënave dhe raportimit është i nevojshëm për përmirësimin e të kuptuarit, analizimin dhe llogaridhënien e sektorëve nxjerrës dhe të hidroenergjisë.

Objektivi kryesor i kësaj detyre është kryerja e një shqyrtimi kritik të kuadrit ligjor dhe institucional ekzistues dhe analizimi i rregullave dhe procedurave ligjore dhe rregullatore që lidhen me zbatimin e EITI në Shqipëri dhe standardet EITI. Vëmendje e veçantë i është kushtuar ligjeve, Vendime të Këshillit të Ministrave, Rregulloreve dhe Udhëzimeve.

Bazuar në mangësitë dhe mospërputhjet e identifikuar, ekipi i zbatimit të projektit, ka rekomanduar propozime konkrete për rishikimin/ndryshimin e akteve specifike ligjore dhe/ose nënligjore. Këto propozime konsistojnë në konsultimin e disa projekt-akteve me grupet e interesit. Në fazën përfundimtare të kësaj detyre do të zhvillohet një seminar me grupet kryesore të interesit.

Kjo detyrë është zhvilluar nga një grup ekspertësh të përbërë nga juristë vendas, të cilët kanë njohuri të detajuara për kuadrin ligjor shqiptar dhe një jurist ndërkombëtar që është angazhuar në këtë detyrë për të sjellë aty ku mund të zbatohen, praktikat më të mira ndërkombëtare dhe standardet evropiane dhe/ose legjislacionin më të azhurnuar ndërkombëtar.

Qëllimi i detyrës

Qëllimi i kësaj detyre është identifikimi dhe vlerësimi i dispozitave të Standardeve EITI që janë të zbatueshme në kuadrin ligjor dhe rregullator kombëtar, e ndjekur kjo nga rekomandimet korresponduese në lidhje me ndryshimet e nevojshme të këtij legjislacioni për të siguruar përputhshmëri me standardin EITI.

Ekipi i zbatimit të projektit ka shqyrtuar, ndër të tjera, çdo mekanizëm publikimi ekzistues në lidhje me kuadrin ligjor dhe institucional, alokimin e kontratave dhe licencave, proceset e kërimit e prodhimit, mbledhjen e të ardhurave dhe ndarjen e shpenzimeve sociale dhe ekonomike. Ky ekip ka shqyrtuar më tej të gjithë legjislacionin përkatës kombëtar përkundrejt Standardeve EITI, akteve udhëzuese si dhe çdo legjislacioni të BE-së dhe standardet ndërkombëtare apo praktikrat e mira.

Në përfundim të shqyrtimit, ekipi i zbatimit të projektit ka formuluar rekomandimet e veta për çdo veprim/hap të sugjeruar, në mënyrë që të evitohen pengesat ekzistuese të identifikuara për grumbullimin efikas dhe të besueshëm të të dhënave dhe zbatimin e suksesshëm të Standardeve EITI.

Pronësia Përfituese – Kuadri Ndërkombëtar –Rritja e Transparencës dhe Llogaridhënies

Direktiva e BE për Transparencë dhe Llogaridhënie

Në zbatim të standardeve EITI, vendet në përputhje duhet të sigurojnë që kompanitë e industrive nxjerrëse të publikojnë të ardhurat që ata paguajnë për secilën qeveri në mënyrë që të sigurohet që të gjitha të ardhurat e gjeneruara përmes aktiviteteve të tilla, të llogariten në mënyrën më të duhur e transparente. Për këtë qëllim, MSG-të duhet të dakordësojnë se cilat pagesa janë më të rëndësishme dhe të konsiderojnë limitin përkatës. (shih Kërkesën EITI 4).

Përveç kësaj, me miratimin e Direktivës së re të Kontabilitetit, përkatësisht Direktivën 2013/34/BE, kërkesat për transparencë janë rritur në mënyrë të konsiderueshme në nivelin e BE-së. Direktiva kërkon që kompanitë e listuara në bursë në vendet e BE-së dhe më gjerë, kompanitë e mëdha të palistuara të vendosura në BE, të publikojnë pagesat e kryera përkundrejt qeverisë, specifikisht pagesat që kanë lidhje me sektorin e naftës, gazit, mineraleve dhe lëndëve drusore, të ndara sipas vendit dhe projektit.

Për këtë arsye, kompanive të mëdha nxjerrëse dhe prerëse do t'i kërkohet të publikojnë pagesat që ata bëjnë për qeveritë, (referuar si *“raportim vend pas vendi”*- CBCR).

Një “**pagesë**” nënkupton njëkohësisht pagesat monetare dhe pagesat në natyrë, dhe “qeveria” nënkupton çdo departament, agjenci apo ndërmarrje të kontrolluar nga një autoritet kombëtar ose lokal. Llojet e pagesave që duhet të raportohen, përcaktohen si më poshtë:

- a) të drejtat e prodhimit;
- b) taksat mbi të ardhurat, prodhimin ose fitimin e kompanive;
- c) honoraret/royalties;
- d) dividendët;
- e) bonuset e nënshkrimit, zbulimit dhe prodhimit;
- f) tarifat e licencave, tarifat e qirave, tarifat e hyrjes dhe shpërblime të tjera për licenca dhe/ose koncesione;
- g) pagesat për përmirësimin e infrastrukturës.

Çdo pagesë, si e bërë në mënyrë të njehershme ose në një seri pagesash të lidhura, duhet të përfshihen në raport nëse është në shumën 100,000 € ose më shumë, brenda një viti të caktuar financiar.

Raportimi gjithashtu mund të kryhet në bazë projekti, ku pagesat i atribuohen projekteve specifike. Direktiva e Kontabilitetit rregullon informacionin e dhënë në pasqyrat financiare të të gjitha shoqërive me përgjegjësi të kufizuar të cilat janë të regjistruara në Zonën Ekonomike Europiane (EEA).

E njëjta kërkesë për publikim është përfshirë në propozimin për rishikimin e Direktivës për Transparencë (2004/109/KE). Kjo përfshin të gjitha kompanitë të cilat janë të listuara në tregjet e rregulluara të BE-së edhe nëse ata nuk janë të regjistruar në EEA dhe të themeluara në një vend të tretë.

Informacioni i publikuar mbi pagesat ndaj qeverive do të jetë në dispozicion të publikut për të gjitha palët e interesuara nëpërmjet mbledhjes së informacionit të tregut të aksioneve ose nëpërmjet regjistrimit të biznesit në vendin e themelimit (në të njëjtën mënyrë si janë vënë në dispozicion pasqyrat financiare).

Kërkesa e detyrueshme të BE-së për publikim do të plotësojnë përpjekjet e EITI për t'i kërkuar ligjërisht kompanive të regjistruara ose të listuara në BE të publikojnë pagesat ndaj qeverive në të njëjtën linjë si EITI. Duke vepruar kështu, objektivi përfundimtar është që të kontribuojë në forcimin e EITI dhe zgjerimin e qëllimit të saj në të gjitha vendet e pasura me burime. Direktiva prezanton

një kërkesë për publikim informacionesh shpjeguese për pagesat kundrejt qeverive nga kompanitë e listuara dhe nga kompanitë e mëdha të palistuara që kryejnë veprimtari në fushën e industrisë nxjerrëse dhe prerëse të pyjeve.

Një “kompani e madhe”, është përcaktuar në Direktivën e Kontabilitetit si një biznes që, në datën e bilancit, plotëson dy ose tre nga kriteret e mëposhtme: (i) aktivet e bilancit prej €20 milionë; (ii) qarkullimin neto prej € 40 milionë; (iii) numrin mesatar prej 250 punonjës gjatë vitit financiar.

Megjithatë, dhënia e informacioneve shpjeguese kërkohet gjithashtu dhe nga “njësitë ekonomike me interes publik” të çdo madhësie, përkatësisht, (i) kompanitë me përgjegjësi të kufizuar që janë pranuar të tregtojnë në një treg të rregulluar të BE-së; (ii) institucionet e kreditit; (iii) shoqëritë e sigurimit; ose (iv) ato të përcaktuara në këtë mënyrë nga Shtetet Anëtare, për shkak të rëndësisë së tyre në publik.

Neni 36 i Direktivës së Kontabilitetit e përkufizon një “ndërmarrje aktive në industrinë nxjerrëse” si “një ndërmarrje që ushtron çdo veprimtari që lidhet me kërkimin, zbulimin, gjetjen, zhvillimin dhe nxjerrjen e mineraleve, naftës, depozitave të gazit natyror ose materialeve të tjera, brenda aktiviteteve ekonomike të listuara [...]”, që përfshin: minierat e metaleve të caktuara dhe minerale; nxjerrjen e naftës bruto dhe gazit natyror; guroret; nxjerrjen e torfës dhe kripës; dhe veprimtaritë që lidhen me zhavorrin dhe rërën.

Palët që janë subjekt deklarimi sipas detyrimeve të Direktivës i kërkohet të përgatisin dhe publikojnë një raport vjetor që përmban informacionin e mëposhtëm në lidhje me aktivitetet e mbuluara, nxjerrëse apo prerëse: (i) shumën totale të pagesave, duke përfshirë pagesat në natyrë për çdo qeveri në një vit financiar; (ii) shuma e përgjithshme për llojin e pagesës, duke përfshirë pagesat në natyrë, për çdo qeveri brenda një viti financiar; (iii) në çdo kohë kur pagesat e mësipërme i ngarkohen një projekti të caktuar, shumën për llojin e pagesës, duke përfshirë pagesat në natyrë, për çdo projekt të tillë brenda një viti financiar dhe shumën totale të pagesave për secilin projekt.

Mbretëria e Bashkuar (MB) ka miratuar “Raportet për Rregulloret e Pagesave kundrejt Qeverive 2014” (“Rregulloret e MB”), të cilat transpozuan Direktivën në ligjin përkatës kombëtar.

Rekomandimi i grupit të punës është që qeveria shqiptare dhe parlamenti duhet të miratojnë menjëherë legjislacionin, i cili transponon kushtet e Direktivës në ligjin kombëtar, thuajse në të njëjtën mënyrë që MB dhe vendet e tjera kanë bërë dhe më tej sugjerojmë modelimin e një ligji të ri në përputhje me kushtet e Rregulloreve të MB. Kjo jo vetëm që do të plotësonte kriteret përkatëse të përcaktuara në Kërkesat EITI 4 por edhe do të siguronte që çdo legjislacion i ri ka kaluar duke u bazuar në tendencat e fundit ndërkombëtare, veçanërisht në dritën e kërkesës së anëtarësimit të Shqipërisë në BE.

Kompanitë që duhet të publikojnë këtë informacion në raportet vjetore duhet t'i dorëzojnë ato pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (ose ndonjë subjekt tjetër që konsiderohet i përshtatshëm për regjistrime të tilla), dhe secili prej këtyre raporteve duhet të bëhen lehtësisht i arritshme, mundësisht pa pagesë.

Mbretëria e Bashkuar

Kush është subjekt i kërkesave të raportimit?

Një ndërmarrje e madhe është ajo që përmbush të paktën dy nga tre kriteret e mëposhtme: (a) totali i bilancit në datën e bilancit të gjendjes të tejkalojë GBP £ 18 milionë; (B) qarkullimi neto në datën e bilancit të gjendjes të kalojë GBP £36 milionë; (c) numri mesatar i të punësuarve gjatë vitit financiar për të cilin lidhet bilanci të tejkalojë 250.

Informacioni që duhet të deklarohet

Kompanitë duhet të deklarojnë, në një raport vjetor, pagesat e tyre të bëra tek qeveritë në lidhje me aktivitetet e tyre përkatëse për çdo vit financiar, në formën e mëposhtme: (a) qeverinë ndaj të cilës është bërë pagesa, përfshirë edhe vendin e kësaj qeverie; (b) shumën totale të pagesave të bëra për çdo qeveri; (c) shumën totale për llojin e pagesës së bërë për çdo qeveri; dhe (d) kur këto pagesa i janë ngarkuar një projekti të caktuar, shumën totale për llojin e pagesës së bërë për çdo projekt dhe shumën totale të pagesave për secilin projekt. Pagesat në natyrë duhet të raportohen në vlerë dhe, kur është e zbatueshme, në vëllim, me shënime shpjeguese se si është përcaktuar vlera. Ku pagesat nuk i ngarkohen një projekti të veçantë, duhet të deklarohen në raport pa e ndarë dhe pa ja caktuar pagesën një projekti të veçantë.

Një pagesë më vete duhet të deklarohet në qoftë se ajo arrin të paktën vlerën GBP £ 86,000. Një seri e pagesave të ngjashme brenda një viti financiar duhet të deklarohet në qoftë se seritë e pagesave arrijnë në të paktën vlerën GBP £ 86,000.

Si është aksesuar dhe deklaruar informacioni

Raportet janë paraqitur në Regjistrin e Kompanisë së MB të cilat, që nga Janari i vitit 2016 kanë prezantuar “shërbimin nxjerrës” për kompanitë me qëllim t'i përdorin në lidhje me dorëzimin elektronik të këtyre raporteve dhe për palët e treta për akses (pa pagesë).

PRONËSIA PËRFITUESE

Zhvillimi i një plani udhëzues për deklarimin e pronësisë përfituese

Hyrje

Me miratimin e standardeve EITI 2016, dhe në veçanti Kërkesa 2.5, është e detyrueshme që të gjitha vendet zbatuese të sigurojnë që subjektet që konkurrojnë, të ushtojnë veprimtari ose të investojnë në të gjitha pasuritë nxjerrëse që të deklarojnë identitetin e pronarëve të tyre përfitues. Standardet e EITI gjithashtu kërkojnë që çdo “person i ekspozuar politikisht”, që është pronari përfitues duhet të identifikohet nga 1 Janar i vitit 2020.

Rekomandohet që informacioni i pronësisë përfituese të vihet në dispozicion përmes një regjistri publik. Është minimum i mundshëm për një informacion të tillë që të përfshihet në Raportin EITI, ose raporti duhet të përmbajë një link të një platformë online të informacionit për pronësinë përfituese.

Për të siguruar që janë ndërmarrë hapat përkatëse, qarqeve zbatuese i është kërkuar të dakordësojnë dhe të **publikojnë një plan udhëzues për dhënien e informacioneve shpjeguese të pronësisë së tyre përfituese nga 1 Janar 2017.**

Bazuar në sa më sipër, kjo pjesë e raportit ka për qëllim që të udhëheqë MSG në Shqipëri drejt krijimit të një plani udhëzues të suksesshëm për deklarimin e pronësisë përfituese.

Çfarë duhet të përmbajë plani udhëzues?

Kërkesa 2.5.b.ii përcakton:

“Nga 1 janari 2017, MSG publikojnë një plan udhëzues për dhënien e informacioneve shpjeguese të pronësisë përfituese në përputhje me klauzolat (c) - (f) më poshtë. MSG do të përcaktojnë të gjitha piketat dhe afatet në planin udhëzues dhe do të vlerësojnë zbatimin e këtij plani, si pjesë e raportit të aktivitetit vjetor të MSG-ve “.

Çfarë duhet të përmbajë një plan udhëzues?

Një plani udhëzues nevojitet të përmbajë dhe të adresojë çështjet si më poshtë:

Planet dhe aktivitetet për mënyrën se si Qeveria do të sigurojë se “subjektet e korporatave që konkurrojnë, ushtrojnë aktivitet ose investojnë në aktive nxjerrëse” deklarojnë “identitetin e pronarëve të tyre përfitues, nivelin e pronësisë dhe të dhëna rreth asaj se si pronësia ose kontrolli është ushtruar”.

Për të arritur këtë, EITI rekomandon që plani udhëzues të përfshijë aktivitete që synojnë konsultime të gjera me agjencitë qeveritare dhe aktorë të tjerë për të identifikuar agjencinë/të përgjegjëse, ose që mund të përshtatet më mirë për të mbikëqyrur, mbledhur dhe për të ruajtur informacione të pronësisë përfituese si dhe çdo proces ekzistues të dorëzimeve publike që mund të akomodojnë lehtësisht deklaratimet e pronësisë përfituese. Kjo mund të përfshijë rishikimin dhe/ose ndryshimin e kërkesave ekzistuese të dorëzimeve të kompanisë pas regjistrimit të kompanisë, për të përfshirë informacion mbi pronësinë përfituese dhe për të konsideruar për të shtuar kërkesat për dorëzim në lidhje me deklaratimet e pronësisë përfituese në proceset e tenderimit dhe regjistrat e licencës, në lidhje me projektet nxjerrëse.

Projekti pilot i EITI mbi pronësinë përfituese doli në përfundimin se në shumicën e vendeve koncepti i pronësisë përfituese nuk ishte rregulluar nga legjislacioni ekzistues, çka tregon se ekziston një shans shumë i vogël i identifikimit të pengesave ligjore për deklaratimin e informacioneve të pronësisë përfituese. Në të njëjtën kohë, shumë vende dolën në përcaktimin se **publikimi i legjislacionit do të sillte realizimin e një përputhje shumë të mirë me kërkesat e deklaratimit të informacionit mbi pronësinë përfituese**. Është e rëndësishme që për këtë arsye MSG të kërkojnë të identifikojnë se kur një kërkesë e tillë mund të përshtatet në termat të instrumenteve ligjore kombëtare. Ne kemi përcaktuar rekomandimin tonë në këtë drejtim në vijim të raportit.

Përkufizimi i “pronësisë përfituese”

Kërkesa 2.5.f.i përcakton një pronar përfitues si “personi/at fizik të cilët direkt ose indirekt përfundimisht zotërojnë ose kontrollojnë subjektin korporatë”.

Standardi EITI vëren se MSG duhet të dakordësojnë një përkufizim të duhur të termit "pronar përfitues", e cila duhet të përafrohet me praktikën ndërkombëtare dhe të marrë parasysh ligjet kombëtare në fuqi dhe duhet të përfshijë gjithashtu limitet përkatëse të pronësisë. Ky përkufizim duhet të përfshijë në vijim detyrimin për raportim për “personat e ekspozuar politikisht”.

Më poshtë janë dhënë disa përkufizime të “pronësisë përfituese” që përdoren ndërkombëtarisht:

- **Përkufizimi i Task Forcës Financiare (FATF):** personi/at fizik, që përfundimisht zotërojnë ose kontrollojnë një klient dhe/ose personi fizik në emër të të cilit një transaksion është duke u kryer. Gjithashtu përfshihen dhe ata persona që ushtrojnë kontrollin e fundit efektiv mbi personin juridik ose një marrëveshje.

Ky përkufizim shtrihet përtej pronësisë ligjore dhe kontrollon e fokusohet në pronësinë e fundit (aktuale) natyrore. Ky është, personi i cili aktualisht merr benefitet e kapitalit apo pasurive të personit juridik, si dhe ata të cilët me të vërtetë ushtrojnë kontroll efektiv mbi të (nëse zënë apo jo pozita formale brenda personit juridik). Një tjetër element thelbësor i përkufizimit të FATF është se përfshin

personin fizik në emër të të cilit një transaksion është duke u zhvilluar edhe kur ky person nuk ka pronësinë aktuale ose juridike ose kontrollin mbi konsumatorin.

- **Përkufizimi i Direktivës së 4-t të Pastrimit të Parave (4MLD):** “Pronari përfitues” nënkupton çdo person fizik i cili përfundimisht zotëron ose kontrollon klientin dhe/ose personin fizik në emër të të cilit një transaksion është duke u kryer dhe përfshin, të paktën:

(a) në rastin e subjekteve korporata:

(i) Personin t fizik, i cili përfundimisht zotëron ose kontrollon një person juridik me anë të pronësisë së drejtpërdrejtë ose të tërthortë, me një përqindje të mjaftueshme të aksioneve apo të drejtave të votimit ose interes pronësor në atë subjekt, duke përfshirë mbartësin e aksioneve ose përmes kontrollit nëpërmjet mjeteve të tjera, përveç një kompanie të listuar në një treg të rregulluar që është subjekt i kërkesave të deklarimit në përputhje me ligjin e BE ose që i nënshtrohen standardeve ndërkombëtare ekuivalente të cilat sigurojnë transparencën e duhur të informacionit të pronësisë.

(i) Mbajtja e 25% të aksioneve plus një aksion, ose e një interesi pronësie prej më shumë se 25% të klientit të mbajtur nga një person fizik duhet të jetë një tregues i pronësisë direkte. Mbajtja e 25% e aksioneve plus një aksion ose e një interesi pronësor prej më shumë se 25% të klientit që mbahet nga një entitet i korporatave, i cili është nën kontrollin e një personi fizik, ose nga subjektet e shumta të korporatave, të cilat janë nën kontrollin e të njëjtit personi fizik, do të jetë një tregues i pronësisë të tërthortë. Kjo zbatohet, pa cënuar të drejtën e Shteteve Anëtare për të caktuar që një përqindje më të vogël mund të jetë një tregues i pronësisë ose i kontrollit.

(ii) Në qoftë se, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet e mundshme dhe të sigurohet që nuk ka asnjë arsye për dyshim, nuk është identifikuar asnjë person sipas pikës (i), ose në qoftë se ekziston ndonjë dyshim që personi/at e identifikuar të jenë pronarërt përfitues, personi/at individë, që mbajnë pozitën e zyrtarit/ëve të lartë drejtues, subjektet përgjegjëse duhet të mbajnë shënime për veprimet e ndërmarra me qëllim të identifikimit të pronësisë përfituese sipas pikës (i) dhe kësaj pike.

(b) Në rastin e trusteeve:

(i) Administratori/ët;

(ii) Mbrojtësi, nëse është rasti;

(iii) Përfituesi;

- (iv) Çdo person tjetër individ që ushtron kontroll përfundimtar mbi trustet me anë të pasurisë së drejtpërdrejtë ose jo të tërthortë ose me mënyra të tjera.

Projekti Pilot i EITI tregoi se gjysma e vendeve pilote përfshijnë një limit minimal në përkufizimet e tyre, ku një person i cili zotëron direkt ose indirekt një përqindje minimale të pronësisë ose kontrollit të kompanisë të konsiderohet si një pronar përfitues. Kjo qasje është zbatuar edhe në rastet e kontrollit të tërthortë, p.sh. ku pronësia është mbajtur ndërmjet një vargu kompanish apo personash juridike. Kufinj të limiteve variojnë nga 5% në 25%. Këto limite duhet të përcaktohen duke marrë parasysh strukturën e kompanive që operojnë në vend, interesin e plotë të një individi si dhe mjetet e ndryshme të ushtrimit të pronësisë dhe kontrollit.

Shteti i Libërisë është shembulli i një vendi i cili ka rënë dakord për një përkufizim ku përfshihen dhe raste ku asnjë individ i vetëm nuk ka pronësinë e mjaftueshme për të arritur këtë limit. Ata kanë caktuar një limit prej 5%/10% (në varësi të sektorit), si edhe kanë rënë dakord se në rastet kur një individ i vetëm nuk zotëron të paktën 5%/10%, informacioni për pronësinë përfituese do t'i kërkohej pesë aksionarëve të lartë që kanë përqindjen më të madhe të të drejtave të pronësisë.

Përkufizimi i “Personave të Ekspozuar Politikisht”

Kërkesa EITI 2.5.f.ii përcakton se “përkufizimi i një pronari përfitues duhet të specifikojë detyrimet për raportim të personave të ekspozuar politikisht”. Modeli EITI i formularit të deklarimit të pronësisë përfituese përfshin fusha për zbulimin nëse ndonjë pronar përfitues është person i ekspozuar politikisht (“PEP”), si edhe informacione mbi pozicionin e punës në shtet dhe përgjegjësitë si edhe datat e mbajtjes së këtyre pozicioneve.

EITI rekomandon që plani udhëzues të përfshijë aktivitete që kanë për qëllim hetimin e përkufizimeve ekzistuese kombëtare dhe kërkesat e raportimit për PEP me qëllim të identifikimit të objektivave të politikës kombëtare në këtë çështje dhe përafrimin e përkufizimit të pronësisë përfituese në përputhje me rrethanat.

Përkufizimi i Direktivës së 4-t e Pastrimit të Parave (4MLD): “person i ekspozuar politikisht” nënkupton një person fizik të cilit i është besuar një funksione i rëndësishëm shtetëror dhe përfshin si më poshtë:

- (a) Krerët e Shtetit, krerët e Qeverisë, ministrat dhe zëvendës ministrat ose ndihmësit e ministrave;
- (b) Anëtarët e parlamentit apo të organeve të ngjashme legislative;
- (c) Anëtarët e organeve të partive politike qeverisëse;
- (d) Anëtarët e gjykatave të larta, të gjykatave kushtetuese ose të organeve të tjera të nivelit të lartë gjyqësor, vendimet e të cilave nuk janë objekt ankimi të mëtijshëm, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme;
- (e) Anëtarët e gjykatave të auditorëve ose të bordeve të bankave qendrore;

- (f) Ambasadorët, diplomatët dhe oficerë të rangut të lartë në forcat e armatosura;
- (g) Anëtarët e organeve administrative, menaxheriale apo organeve mbikëqyrëse të ndërmarrjeve shtetërore;
- (h) Drejtorë, zëvendësdrejtorë dhe anëtarët e bordit ose funksionë ekuivalente me to në një organizatë ndërkombëtare.

- **Task Forca Financiare:** PEP të huaj janë individë të cilët janë ose kanë qenë të ngarkuar me funksione të spikatura publike nga një shtet i huaj, për shembull Krerët e Shtetit apo të Qeverisë, politikanë të lartë, qeveritarë të lartë, zyrtarët gjyqësorë ose ushtarake, drejtuesit e lartë të korporatave shtetërore, zyrtarë të rëndësishëm të partive politike. PEP vendas konsiderohen individë që janë ose kanë qenë të ngarkuar brenda vendit me funksione të rëndësishme publike, për shembull Krerët e Shtetit apo të Qeverisë, politikanë të lartë, qeveritarë të lartë, zyrtarët gjyqësorë ose ushtarake, drejtuesit e lartë të korporatave shtetërore, zyrtarë të rëndësishëm të partive politike.
- **Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit:** Neni 53 përcakton PEP si “individë të cilët janë apo kanë qenë, të ngarkuar me funksione të rëndësishme publike, si dhe familjarët e tyre dhe bashkëpunëtorë të ngushtë”.

Informacionet që nevojiten për t’u deklaruar

Kërkesa EITI 2.5.c and 2.5.d përcakton që deklarimi i informacioneve për pronësinë përfituese:

“duhet të përfshijnë identitetin/et e pronarit/eve të tyre përfitues, nivelin e pronësisë dhe të dhëna rreth asaj se si pronësia ose kontrolli ushtrohet” dhe se “informacioni në lidhje me identitetin e pronarit përfitues duhet të përfshijë emrin e pronari përfitues, (ii) kombësinë dhe vendbanimin, si dhe (iii) identifikimin e çdo personi të ekspozuar politikisht. Gjithashtu rekomandohet të deklarohen numri kombëtar i identitetit, datëlindja, adresa e banimit ose shërbimit dhe mjetet e kontaktit”.

Modeli i EITI i formularit të deklarimit të pronësisë përfituese kërkon deklarimin e të gjithë këtij informacioni dhe rekomandon që plani udhëzues të përfshijë aktivitete që synojnë konsultimin me qeverinë, shoqërinë civile, dhe kompanitë në lidhje me nivelin e detajeve shtesë të informacioneve shpjeguese të deklarimit të pronësisë përfituese, përfshirë mundësitë dhe sfidat për informacionin e rekomanduar për deklarim si data e lindjes dhe mënyrat e kontaktit. Planin udhëzues gjithashtu mund të specifikojë nëse MSG synojnë të përdorin modelin e formularit të deklarimit të pronësisë përfituese EITI, ndoshta me disa përshtatje lokale ose nëse synojnë të zhvillojnë formën e vet të deklarimit.

FATF rekomandon që shtetet duhet të sigurojnë disponimin e një informacioni të mjaftueshëm, të saktë dhe në kohë për pronësinë përfituese të të gjithë personave juridikë dhe se autoritetet kombëtare mund të askesojnë këtë informacion në kohën e duhur.

Si duhet të mblidhet informacioni

Kërkesa EITI 2.5.a përcakton: “rekomandohet që vendet zbatuese të mbajnë një regjistër në dispozicion të publikut e pronarëve përfitues të subjekteve të korporatave që konkurrojnë, veprojnë ose investojnë në pasuritë nxjerrëse, duke përfshirë çdo identitet të pronarëve të tyre përfitues, nivelin e pronësisë dhe detajet se si ushtrohet kontrolli i pronësisë. Kur është e mundur, informacioni i pronësië përfituese duhet të përfshihet në dosjet ekszistuese nga kompanitë për rregullatorët e korporatave, bursat apo agjenci që rregullojnë licencimin e industrisë nxjerrëse. Kur ky informacion vihet në dispozicion të publikut, Raporti EITI duhet të përfshijë udhëzime se si mund të aksesojmë këtë informacion”.

Është e rëndësishme të theksohet se kërkesa për të marrë parasysh subjektet të cilat "konkurrojnë, veprojnë ose investojnë" në pasuritë nxjerrëse nënkupton që më zbatim të kësaj, MSG duhet të marrin në konsideratë një grup më të gjerë të kompanive përvec atyre që konsiderohen si të rëndësishme për qëllime të raportimit financiar EITI.

Informacioni i siguruar në Regjistrat e Kompanive për Pronësinë përfituese

Mekanizma efektive që sigurojnë informacionin e PP të mbajtur në regjistrat e kompanisë mund të përfshijnë disa ose të gjitha rregullimet e mëposhtme:

- Kompanitë duhet të sigurojnë të dhëna bazë dhe informacion për PP për regjistrin e kompanisë pas regjistrimit.
- Kompanitë duhet të sigurojnë të dhëna bazë dhe informacion për PP çdo vit ose/dhe kur ndodhin ndryshime për të siguruar që informacioni është i azhurnuar.
- Kompanitë duhet të bëjnë një deklaratë në lidhje me pronarin përfitues dhe strukturën e pronësisë. Kjo mund të përfshijë sigurimin e kopjeve të dokumentacionit për verifikimin e identitetit.
- Autoriteti i mbajtjes së Regjistrit të Kompanisë duhet të verifikojë identitetin e pronarëve përfitues.
- Kompanitë që nuk arrijnë të japin informacion mbi PP janë subjekt i sanksioneve shtrënguese administrative, të tilla si kufizime në themelimin dhe sanksione të tilla zbatohen.
- Ofrimi i informacionit të rremë është subjekt i sanksioneve proporcionale dhe shtënguese administrative dhe penale për kompaninë. Përfaqësuesi i kompanisë është personalisht përgjegjës.
- Autoriteti përgjegjës për mbajtjen e Regjistrit të Kompanisë aplikon rregullisht sanksione të tilla kur detyrimet janë shkelur.
- Autoriteti përgjegjës për mbajtjen e Regjistrit të Kompanisë merr një rol proaktiv, duke përfshirë kontrollin e informacionit ndaj burimeve të tjera (të tilla si regjistrat e identifikimit të aksionarëve, popullsisë ose

kombëtar), për të identifikuar parregullsi apo mospërputhje.

- Informacioni në regjistrin e kompanisë është i regjistruar në mënyrë dixhitale dhe është i kërkueshëm. Funkcioni i kërimit mbulon kërkimet nga fusha të shumta.
- Autoritetet kompetente kanë akses në regjistrin e kompanisë në internet si edhe aftësi të plota kërrimi.
- Autoriteti përgjegjës për mbajtjen e Regjistrit të Kompanisë ka në kompetencë identifikimin etreguesve të keqpërdorimit apo aktivitetet e pazakonta (flamuj të kuq) në bazën e të dhënave
- Informacioni bazë i kompanisë vihet në dispozicion të publikut, informacioni mbi PP gjithashtu mund të vihet në dispozicion të publikut, ose në dispozicion të institucioneve financiare dhe DNFBPs.
- Autoriteti përgjegjës për mbajtjen e Regjistrit të Kompanisë mund të marrë dhe të mbajë informacion të aksionarëve për kompanitë përveç informacionit të pronësisë përfituese.
- Autoriteti përgjegjës për mbajtjen e Regjistrit të Kompanisë mbledh informacion për bordin e drejtorëve, zyrtarëve të menaxhmentit dhe personit individ të autorizuar për të vepruar në emër të kompanisë. Përveç kësaj, drejtorët duhet të jenë persona individë.
- Masat sipas këtij mekanizmi janë të kombinuara me aspektet e mekanizmit 2 (të përshkruara më poshtë) duke pasur parasysh se kompania do të sigurojë informacion në regjistër.

Kompanive i kërkohet që të mbajnë informacione për pronësinë përfituese ose për të marrë hapa të arsyeshme

Një mekanizëm i cili siguron që kompanitë të kenë, ose të marrin masa të arsyeshme për të patur informacion mbi PP mund të përfshijë disa ose të gjitha karakteristikat e mëposhtme:

- Kompanitë duhet të mbajnë informacione të pronësisë përfituese, dhe ata kanë autoritetin për të kërkuar informacion nga aksionarët për aksionet e pronësinë përfituese.
- Kompanitë mund të kërkojnë të zbatojnë kufizime kundrejt aksionarëve për mospërmbushjen e tyre për të dhënë informacion mbi PP nëpërmjet gjykatave ose autoriteteve përkatëse, si në lidhje me të drejtat e votimit të aksionarëve, ose shitjen e aksioneve.
- Sigurimi i informacionit të rremë nga aksionerët është subjekt i sanksioneve shtënguese administrative apo penale.
- Aksionerët janë të detyruar të japin informacion mbi ndryshimet në pronësinë përfituese pa vonesë.
- Kompanitë duhet të sigurojnë lista të aksionarëve dhe pronarëve përfitues të organeve kompetente sipas kërkesës në kohën e duhur.
- Mospërmbushja nga ana e kompanisë e sigurimit të një informacioni për autoritetet përkatëse, e bën atë subjekt të vendosjes së sanksioneve, të cilat mund të përfshijnë vendosjen e gjobave administrative apo

kufizimet në themelim.

- Është e nevojshme mbajtja dhe sigurimi në formë elektronike i listës së aksionerëve dhe pronarëve përfitues.
- Kur listat e aksionerëve dhe pronarëve përfitues është mbajtur, në emër të kompanisë, nga një ofrues palë e tretë, kompania mbetet përgjegjëse për detyrimet.
- Kompanitë duhet të kuptojnë dhe të mbajnë të dhëna për strukturën e tyre të pronësisë, përfshirë çdo zinxhir pronësie.
- Kur informacioni mbi PP nuk mund të identifikohet, kompanitë janë të detyruara të publikojnë këtë fakt në faqen e tyre.
- Çdo kompani e përjashtuar nga mbajtja e informacionit për PP, është e përjashtuar nga shteti në bazë të rrishtit të ulët ML/TF.
- Informacioni i pronësisë përfituese është e nevojshme të mbahet në vendin e themelimit.
- Kompanitë dhe aksionarët janë të vetëdijshëm për detyrimet e tyre përmes ofrimit të udhëzimeve dhe aktiviteteve të rritjes së ndërgjegjësimit, për shembull, përmes ofrimit të informacionit të kompanive mbi regjistrimin.

Bazueshmëria në informacionin ekzistues

Një mekanizëm i cili përcakton një qasje të kombinuar për pronësinë përfituese mund të përfshijë disa ose të gjitha karakteristikat e mëposhtme:

- Institucionet financiare që kryejnë CDD dhe kuptojnë detyrimet e tyre në lidhje me pronësinë përfituese, dhe i nënshtrohen mbikëqyrjes AML/CFT.
- Nëse regjistri i kompanisë nuk duhet të marrë apo mbajë informacione mbi pronarin përfitues, ajo mund të mbajë informacionin përkatës për pronësinë përfituese, duke përfshirë drejtorët, zyrtarët e lartë të menaxhimit dhe përfaqësuesit e kompanisë.
- Informacioni i PP që mbahet nga autoriteti tatimor vihet në dispozicion në kohën e duhur për autoritetet kompetente dhe ato zbatuese që janë në dijeni të informacionit në dispozicion dhe kanë mekanizma për aksesimin e tij në kohë.
- Autoritetet kompetente janë në gjendje të identifikojnë institucione financiare që mund të mbajnë informacione PP në kohën e duhur, për shembull, nëpërmjet një regjistri kombëtar të llogarive bankare.
- Autoritetet kompetente janë në gjendje të identifikojnë TCSPs që mund të mbajnë informacion për PP në kohën e duhur, për shembull, nëpërmjet një regjistri qendror të transaksioneve të aksioneve, ose një regjistër të TCSPs, apo ndonjë mekanizmi tjetër që mbikëqyrësi përdor për të identifikuar TCSPs.

- Informacione të tjera të sakta dhe aktuale për pronësi përfituese vihen në dispozicion nga regjistrat e aseteve të tilla si toka, prona, automjetet, aksionet ose pasuritë e tjera.

Koha për dorëzimin e informacionit

Plani udhëzues gjithashtu duhet të përcaktojë kohën më të përshtatshme për mbledhjen e të dhënave të informacionit për pronësinë përfituese (p.sh. kompanitë që duhet të dorëzojnë informacionin pas themelimit, kur konkurojnë për licenca të pasurive nxjerrëse, gjatë nënshkrimit të një kontrate, ose kur paraqesin raporte të rregullta vjetore).

Projekti pilot EITI theksoi se ka pasur një paqartësi në shumicën e vendeve mbi këtë çështje, pra nuk ishte e qartë nëse emrat e renditur ishin pronarët përfitues që nga data e publikimit të raportit përkatës EITI, apo nëse ky informacion daton më vonë.

Është treguar që ka një mungesë të konsiderueshme të ndërgjegjësimit dhe përvojës me pronësinë përfituese tek të gjitha grupet e interesit dhe se mungesa e një dallimi të qartë midis pronësisë ligjore dhe përfituese ka shkaktuar konfuzion të madh. Prandaj rekomandohet që MSG-të të konsiderojnë përfshirjen e ndërtimit të kapaciteteve dhe fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit në planin udhëzues. Në shumë raste, mund të jetë e nevojshme të niset me një fushatë të thjeshtë sensibilizuese për të shpjeguar kuptimin e pronësisë përfituese. Kjo mund të plotësohet më pas me ndërtimin e kapacitetve teknike për agjencitë përkatëse qeveritare, për shembull në lidhje me zbatimin e ligjit që rregullon pronësinë përfituese, krijimin dhe mirëmbajtjen e një regjistri të pronësisë përfituese, mekanizmat e verifikimit, komunikimi me kompanitë dhe çështje të tjera të lidhura me këto. Ngritja e kapaciteteve për kompanitë mund të jetë e nevojshme për të siguruar më shumë njohuri për raportimin e pronësisë përfituese, udhëzime për identifikimin dhe mbledhjen e informacionit fillestar të pronësisë përfituese etj.

MSG duhet gjithashtu të nxitojnë në identifikimin e mundësive të **financimit dhe asistencës teknike që mund t'i nevojitet për zbatimin e planit udhëzues** (shih kërkesën EITI 1.5.d). MSG mund të nxjerrin në vazhdimësi vlerësimet e kostove për aktivitetet dhe të tregojnë se si do të financohen, si dhe të ndërmarrin çdo veprim që ka për qëllim sigurimin e financimit të mëtijshëm për zbatimin e planit dhe të identifikojnë se për cilat aktivitete do t'i nevojitet asistencë teknike.

Afatet dhe përgjegjësitë për aktivitetet e planit udhëzues

Rekomandohet që plani udhëzues të **përfshijë aktivitete të matshme dhe me afat të caktuar kohor si edhe të caktojë përgjegjësitë për secilin prej tyre**. MSG mund të krijojë një grup pune apo komitet për të mbikëqyrur zhvillimin dhe zbatimin e planit udhëzues dhe për të paraqitur raporte të rregullta për qeverinë.

Propozimi i Komisionit Evropian për ndyshimin e Direktivës 2015/849 dhe Direktives 2009/101/EC

Është e rëndësishme të theksohet se në muajin Korrik të vitit 2016, Propozimi i Komisioni Evropian për një Direktivë të Parlamentit të BE-së dhe të Këshillit ndryshon Direktivën (BE) 2015/849 dhe Direktiva 2009/101 / EC përmend në mënyrë specifike që, në lidhje **me subjektet ndërmjetësuese që nuk kryejnë aktivitet ekonomik, por më së shumti kanalizojnë të ardhura nga burime të tjera** dhe shërbejnë vetëm për të distancuar pronarët përfitues nga asetet, limiti prej 25% mund të anashkalohet lehtë dhe në këto rrethana, Komisioni propozon **për të ulur këtë limit në 10%.**

Komisioni më tej sqaroi se trustet dhe rregullime të ngjashme ligjore duhet të regjistrohen në vendin ku administrohen.

Është gjithashtu me rëndësi të theksohet që aksesimi në informacione specifike të pronësisë përfituese të lejohet në mënyrë koherente dhe të koordinuar, me anë të regjistrave qendrore në të cilën ajo është regjistruar, duke caktuar një rregull të qartë të qasjes publike, në mënyrë që palët e treta në të gjithë BE-në, të mund të vendosin se kush janë pronarët përfitues përkatës.

Tërësia e të dhënave që do të vihen në dispozicion të publikut duhet të jenë të kufizuara dhe përcaktuara në mënyrë të qartë dhe ezauruese, dhe duhet të jenë të një natyre të përgjithshme, në mënyrë që të minimizohet çdo paragjykim i mundshëm ndaj pronarëve përfitues. Është e rëndësishme që çdo informacion i tillë të vihet në dispozicion të publikut përmes regjistrave kombëtar dhe përmes një sistemi ndërlidhës brenda shteteve anëtare të BE-së dhe të mbetet në dispozicion për një periudhë prej **10 vjetësh pas çregjistrimit të kompanisë nga regjistri.**

Duhet të rregullohen gjithashtu dhe dispozita për përjashtime nga deklarimi dhe për aksesimin e informacionit për pronësinë përfituese në rrethana të jashtëzakonshme p.sh. kur ky informacion ekspozon pronarin përfitues ndaj rrezikut të mashtrimit, rrëmbimit, shantazhit, dhunës ose frikësimit.

Personat individ, të dhënat personale të të cilëve janë mbajtur në regjistrat kombëtarë si informacione për pronësinë përfituese duhet të informohen për publikimin e të dhënave të tyre personale, përpara se të bëhet publikimi.

Me qëllim që të sigurohet regjistrimi dhe shkëmbimi i informacionit në mënyrë koherente dhe efikase, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që autoriteti i tyre përgjegjës për mbajtjen e regjistrat me informacione mbi pronësinë përfituese të trusteve, të bashkëpunojë me homologët e tij në Shtetet e tjera Anëtare.

Është gjithashtu thelbësore që të përcaktohet një detyrim i qartë sipas ligjit kombëtar të Shqipërisë, për çdo kompani, për të ngritur një regjistër publik i cili përcakton informacionin e duhur për çdo person, i cili bie nën përkufizimin e dakordësuar për “pronarin përfitues” ose “personin e ekspozuar politikisht”. Për këtë qëllim, ndryshime gjithashtu duhet të bëhen dhe në Ligjin 9723, datë

03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i cili rregullon kompanitë që kanë detyrimin të paraqesin informacion pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Modeli i UK

Përshkrim i përgjithshëm

Kërkesat rreth pronësisë përfituese janë të përqendruara në subjektet private, të palistuara. Qasja në pronësinë përfituese është rregulluar me dispozitat që rregullojnë biznesin e vogël, ndërmarrjet dhe Aktin e punësimit 2015.

Përgjithësisht, kompanive private do t’i kërkohet të japin informacion mbi çdo individë që kanë një ndikim të rëndësishëm në kompani ose nëpërmjet mbajtjes së aksioneve të drejtpërdrejta, një ose më shumë subjekte të ndërmjetme (psh partneritetet me kompanitë, trustet) ose me mjete të tjera. Informacioni do të kërkohet për individë me ndikim politik.

Kërkesat për kompanitë e listuara (dhe filialet e tyre) janë tepër modeste. Kompanitë që janë anëtare të një grupi për të cilën mëma është listuar, do t’i kërkohet vetëm konfirmimi i mbajtjes së statusit të listuar, pasi kompanitë e listuara janë të detyruara të publikojnë informacion mbi pronësinë përfituese.

Mbrojtja e të dhënave nënkupton që në disa raste informacioni i kërkuar nuk mund të sigurohet nga pronarët përfitues, ose mund të sigurohet pa pëlqim, që është i nevojshëm për përpunimin e tij. Shih udhëzime shtesë më poshtë në lidhje me Aktin e Mbrojtjes së të Dhënave 1998.

Pronësia përfituese

Përkufizim: Një pronar përfitues në lidhje me një kompani nënkupton personin fizik i cili në mënyrë direkte ose indirekte përfundimisht zotëron ose kontrollon njësinë ekonomike të korporatave, me një kontroll të përcaktuar në vazhdimësi në përputhje me dispozitat interpretuese që aplikohen në regjistrin e ri publik të personave me kontroll të rëndësishëm të kompanive në Mbretërinë e Bashkuar të prezantuar në biznesin e vogël, ndërmarrjet dhe Aktin e Punësimit 2015 (“Regjistri PSC”).

Kuptimi i personit me kontrol të rëndësishëm: Një person me kontroll të rëndësishëm në një kompani është individ i që (vetëm ose si pjesë e një numri mbajtësish aksionesh ose të drejtash të përbashkëta) plotëson një nga kushtet e mëposhtme:

1. Individ i zotëron, drejtpërdrejt ose tërthorazi, më shumë se 25% të aksioneve në kompani. Limiti prej 25% llogaritet duke iu referuar vlerës nominale të aksioneve në rastin e një kompanie me kapital aksioner. Në qoftë se kompania nuk ka një kapital aksionar, kushti plotësohet nga një individ që zotëron të drejtën për të ndarë më shumë se 25% të kapitalit apo fitimeve të njësisë ekonomike.

2. Individi zotëron, drejtpërdrejt ose tërthorazi, më shumë se 25% të të drejtave të votës në kompani. Të drejtat e votës të zotëruara nga vetë kompania nuk merren parasysh për këtë qëllim.
3. Individi ka të drejtë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, për të emëruar ose hequr shumicën e bordit të drejtorëve të kompanisë.
4. Individi ka të drejtë të ushtrojë, ushtron aktualisht, ndikim apo kontroll të rëndësishëm mbi kompaninë. Sekretari i Shtetit për Inovacionin e Biznesit dhe Aftësi duhet të nxjerrë udhëzime për kuptimin e “ndikim ose kontroll të rëndësishëm” dhe duhet t’i kushtohet vëmendje në atë udhëzim (kur të vihet në dispozicion) interpretimi i këtij kushti.
5. Administratorët e një trusti apo anëtarët e një kompanie që nuk është një person juridik ushtrojnë kontroll mbi kompaninë përmes një ose më shumë, nga 1 deri 4 mbi kapacitetin e tyre, si në rastin po të ishin individ, dhe individi ka të drejtë të ushtrojë, ose ushtron aktualisht kontroll të konsiderueshëm apo ndikim mbi aktivitetet e atij trusti apo kompanie.

Kërkesat e listuara publikisht të kompanisë: Subjektet e listuara publikisht, duke përfshirë edhe filiale tërësisht në pronësi të subjekteve të listuara publikisht, nuk kërkohet të japin informacion shpjegues për pronarët e tyre përfitues.

Kërkesat e raportimit: Kompanitë private që nuk kryejnë pagesa të raportueshme në UK EITI për periudhën përkatëse nuk janë të nevojshme për të siguruar informacion mbi pronësinë përfituese. Kompanitë private që kanë për të raportuar për periudhën pagesa dhe që kanë pronarë përfitues (siç përcaktohet më sipër) do t’i kërkohet që të deklarojnë informacionin e mëposhtëm në lidhje me secilin nga këto persona:

1. Emri i pronarit përfitues.
2. Muajin dhe vitin e lindjes.
3. Kombësinë.
4. Vendbanimin.
5. Datën kur është siguruar interesi përfitues.
6. Adresën e shërbimit.
7. Metodën e kontrollit.

Hulumtim paraprak: Subjekti raportues duhet të marrë hapat e nevojshëm për të siguruar që informacioni i dhënë për pronësinë përfituese të jetë i saktë dhe i besueshëm.

Datë e rëndësishme: Deklarimi duhet të bazohet në njohuritë e fituara kur informacioni i raportit i është dorëzuar administratorit të pavarur.

8. Personat e Ekspozuar Politikisht

Përkufizim: UK EITI ka miratuar përkufizimin e BE për personat e ekspozuar politikisht, siç përsëritet në Direktivën e katërt të BE-së për Pastrimin e Parave. Termi “person i ekspozuar politikisht” nënkupton një person fizik të cilit i është besuar një funksion i rëndësishëm shtetëror dhe përfshin personat e listuar më poshtë, anëtarët e familjes së tyre dhe personat e tyre më të afërt:

- (a) Krerët e Shtetit, krerët e Qeverisë, ministrat dhe zëvendës ministrat ose ndihmësit e ministrave;
- (b) Anëtarët e parlamentit apo të organeve të ngjashme legislative;
- (c) Anëtarët e organeve të partive politike qeverisëse;
- (d) Anëtarët e gjykatave të larta, të gjykatave kushtetuese ose të organeve të tjera të nivelit të lartë gjyqësor, vendimet e të cilave nuk janë objekt ankimi të mëtejshëm, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme;
- (e) Anëtarët e gjykatave të auditorëve ose të bordeve të bankave qendrore;
- (f) Ambasadorët, diplomatët dhe oficerë të rangut të lartë në forcat e armatosura;
- (g) Anëtarët e organeve administrative, menaxheriale apo organeve mbikëqyrëse të ndërmarrjeve shtetërore;
- (h) Drejtorë, zëvendësdrejtorë dhe anëtarët e bordit ose funksionë ekuivalente me to në një organizatë ndërkombëtare.

Asnjë funksion publik që i referohet pikave (a) në (h) nuk duhet të kuptohet që përfshin kategoritë e zyrtarëve të rangut të mesëm ose më të ulët.

Limiti i Pronësisë: Subjektet raportuese duhet të deklarojnë informacion në lidhje me çdo person të ekspozuar politikisht (PEP) pronarët, ku pronari/ët PEP mbajnë një pjesë aksionesh në njësinë ekonomike raportuese prej më shumë se 5%.

Kërkesat e raportimit: Subjektet raportuese që kanë pronarë që plotësojnë edhe përkufizimin e personit të ekspozuar politikisht dhe përmblen testin e limitit të pronësisë, do t'i kërkojë të sigurojnë informacionin e mëposhtëm:

1. Emrin e PEP;
2. Muajin dhe vitin e lindjes;
3. Kombësinë;
4. Vendbanimin;
5. Datën kur është siguruar interesi përfitues;
6. Adresën e Shërbimit;
7. Emrin e mbajtësit të zyrës publike;
8. Pozicionin dhe rolin që mban në zyrën publike;
9. Datën kur ishte marrë zyra;

10. Data kur zyra u lëshua, nëse aplikohet;

11. Në qoftë se pronari përfitues PEP nuk është mbajtës i zyrës publike, lidhja e pronarit përfitues PEP me mbajtësin e zyrës publike.

Hulumtim paraprak: Publikimet në lidhje me personat e ekspozur politikisht duhet të reflektojnë njohuritë aktuale të subjektit raportues bazuar në informacionin e vendosur në dispozicion në rrjedhën e zakonshme të biznesit. Nuk ekziston asnjë kërkesë drejtuar subjektit, për të kryer në vazhdimësi, një hulumtim paraprak.

Datë e rëndësishme: Deklarimi duhet të bazohet në njohuritë e fituara kur informacioni i raportit i është dorëzuar administratorit të pavarur.

Kuadri Legjislativ Shqiptar

Në këtë kontekst, kemi rishikuar legjislacionin kombëtar shqiptar për të përcaktuar se cili përkufizim i PP, nëse ekziston, është në fuqi dhe nëse do të ishte e këshillueshme që të përfshihej një përkufizim më i mirë apo i ri i PP në legjislacionin ekzistues ose në qoftë se do të jetë rasti që në vend të këtij përkufizimi të kalonin ligje të reja/rregullore që kanë të bëjnë me këtë.

Ligji i vetëm i cili përfshin përkufizimin e “pronarit përfitues” është ligjit nr.9917 i datës 19 Maj 2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar (“**Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave**”).

“Pronar përfitues” është personi fizik ose juridik, që zotëron ose kontrollon i fundit një klient dhe/ose personi, për llogari të të cilit kryhet një transaksion. Këtu përfshihen edhe ata persona, të cilët ushtrojnë kontrollin e fundit efektiv ndaj një personi juridik. Kontroll i fundit efektiv është marrëdhënia, në të cilën një person: a) zotëron në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të paktën 25 për qind të aksioneve ose të votave të një personi juridik; b) i vetëm zotëron të paktën 25 për qind të votave të një personi juridik në bazë të një marrëveshjeje me ortakët ose me aksionarët e tjerë; c) përcakton de facto vendimet e marra nga personi juridik; ç) kontrollon në çdo lloj mënyre zgjedhjen, emërimin dhe largimin e shumicës së administratorëve të personit juridik.”.

Megjithëse përkufizimi i mësipërm pasqyron elementet kryesore të përkufizimeve të PP-ve të cilat janë të miratuara ndërkombëtarisht siç shihet në paragrafët e mësipërm, nuk është e qartë nëse ajo aplikohet direkt në kompanitë e industrisë nxjerrëse, pasi neni 3 nuk përfshin shprehimisht kompanitë që operojnë në këtë sektor si subjekte për të të cilat zbatohet ligji.

Ligji për parandalimin e pastrimit të parave gjithashtu përfshin përkufizimin e “**Personave të Ekspozuar Politikisht**” në të cilin përfshihen personat, të cilët janë të detyruar të bëjnë deklarimin e pasurive të tyre, në përputhje me ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, me përjashtim të nëpunësve të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues, sipas përcaktimeve të legjislacionit për shërbimin civil. Në këtë kategori

përfshihen edhe individët, të cilët kanë pasur ose kanë funksione të rëndësishme në qeveri dhe/ose shtet të huaj, si: kryetar shteti dhe/ose qeverie, politikanë të lartë, zyrtarë të lartë të qeverisë, të gjykatave ose të ushtrisë, drejtues të lartë të kompanive shtetërore, zyrtarë të rëndësishëm të partive politike".

Ky përkufizim është në të njëjtën linjë (dhe përfshin të njëjtën kategori individësh) me përkufizimin e miratuar nga FATF.

Për këtë arsye, rekomandohet që Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave të ndryshohet që t'i referohet shprehimisht zbatimit të tij për kompanitë që operojnë në sektorin e industrive nxjerrëse.

Rekomandohet që Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave të ndryshohet për të përfshirë një limit më të ulët e të përshtatshëm sipas Propozimit.

Përshkrim i përgjithshëm:

Kjo pjesë e raportit ka për qëllim të kryejë një vlerësim gjithëpërfshirës të qeverisjes së MSG, në nivel kombëtar, lidhur me praktikatat për zbatimin e EITI dhe ligjeve përkatëse, rregulloreve dhe rregullave administrative. Ky vlerësim përfshin rishikimin dhe shqyrtimin e akteve përkatëse ekzistuese që rregullojnë përbërjen, organizimin dhe funksionimin e MSG për të vëzhguar përputhshmërinë e tyre me Standardet EITI.

MSG u krijua fillimisht me urdhër të Kryeministrit nr. 156 datë 27.12.2008. Edhe pse urdhri theksoi natyrën shumëpalëshe të të grupit të punës dhe përcaktoi një gamë të gjerë të aktiviteteve kryesore të mundshme, shoqëria civile dhe kompanitë u përfaqësuan vetëm nga një anëtar për secilin. Si rezultat, pasiguria, papërshtatshmëria si dhe pabarazia në përfaqësim solli një funksionim jo efektiv dhe një komunikim të dobët brenda MSG dhe grupeve të tjera të interesit.

Në këtë drejtim, qeveria miratoi një urdhër të ri Kryeministri i cili shfuqizoi urdhrin e sipërpërmendur duke shtuar numrin e përfaqësuesve të kompanive dhe shoqërisë civile. Në vlerësimin e bërë ndaj këtij urdhri, ekipi i zbatimit të projektit doli në përfundimin se ky akt nuk është i plotë dhe nuk i plotëson të gjitha kërkesat e përcaktuara në standardin EITI lidhur me procedurat e qeverisjes së brendshme.

Përveç kësaj, një nivel më i lartë përfaqësimi nga ana e qeverisë, nevojitet me qëllim që të transpozohen plotësisht kërkesat EITI. Në këtë pikëpamje, ngrihet nevoja për hartimin e një akti të ri ku të përfshihen të gjitha kërkesat e detyrueshme në përputhje me standardet EITI në lidhje me MSG, si dhe materiale të tjera udhëzuese.

Legjislacioni kombëtar shfaq mangësi edhe në rregullimin e Termave të Referencës të anëtarëve të MSG, miratimi i të cilave përbën detyrim për çdo vend anëtar në kuadër të kërkesave të detyrueshme EITI në mënyrë që të përcaktohet në mënyrë specifike qëllimi dhe funksionimi i MSG.

Aktualisht, është në fuqi një rregullore e miratuar nga ministri përgjegjës për çështjet e energjisë dhe industrisë që ofron disa rregulla mbi rolet dhe funksionimin e MSG, por kjo rregullore paraqet dispozita shumë të përgjithshme. Në këtë kuadër, duke u udhëhequr nga rekomandimi i ekipit zbatues të projektit, është hartuar një rregullore e re e detajuar që përfshin në mënyrë të plotë Termat e Referencës për anëtarët MSG. Këto Terma Reference japin udhëzime mbi rolet, të drejtat dhe përgjegjësitë e anëtarëve MSG,

miratimin e planeve të punës, raporteve EITI dhe veprimtarinë vjetore, anëtarësimin në MSG si dhe rregullat e procedurat e qeverisjes së brendshme.

Qëllimi i VKM për organizimin dhe funksionimin e MSG dhe i urdhrit të ministri përgjegjës për industrinë nxjerrëse për përcaktimin e Termave të Referencës për anëtarët e MSG është krijimi i strukturave të nevojshme përgjegjëse për koordinimin e përpjekjeve kombëtare për të qënë në përputhje me standardet ndërkombëtare EITI në Shqipëri, strategjitë dhe prioritetet kombëtare në sektorin e industrive nxjerrëse.

Kërkesat EITI	0.1 Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 993, datë 9.12.2015 “Për organizimin dhe funksionimin e sekretariatit kombëtar të nismës për transparencë në industrinë nxjerrëse (EITI-Shqipëri), në kuadër të anëtarësimit në organizimin ndërkombëtar EITI-international” 0.2 Urdhër i Kryeministrit nr. 71 datë 21.07.2011 “Për ngritjen dhe funksionimin e grupit ndërinstitucional të punës për ndjekjen e procedurave të anëtarësimit të Shqpiërisaë në Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI)”. 0.3 Urdhër i Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nr 20, datë 20.01.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e MSG për ndjekjen e procedurave të anëtarësimit të Shqipërisë në Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI)” 0.4 Ligji Nr. 119/2015 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile” 0.5 Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” 0.6 Ligji Nr. 146/2014 “për informimin dhe konsultimin publik” 0.7 Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”¹	N- nuk -përputhet P- përputhet pjesërisht F- përputhet plotësisht N/A- nuk aplikohet A- Neni P- Pika
-----------------------------	---	--

¹ Rënditja e akteve ligjore dhe nwnligjore wshtw bwrw bazuar nw rwnwdsinw e qwllimit tw aktit kundrejt kwrkesws EITI pwrkatwse dhe jo bazuar nw hierarkinw e akteve tw vendosura nw tabelw.

Kërkësa EITI:	Ref:	Dispozita e legjislacionit Shqiptar	Niveli i përputhshmërisë	Rekomandime/Komente
Kërkësa EITI 1: Mbikqyrja nga ana e Grupit Shumë-Palësh dhe kushtet				
1.1 Angazhimi i qeverisë (a) Qeveria është e detyruar të lëshojë një deklaratë të qartë publike për qëllimin e saj për të zbatuar EITI. Deklarata duhet të bëhet nga kreu i shtetit ose qeverisë, ose një përfaqësues i qeverisë i deleguar në mënyrë të përshtatshme.	0.1 P 1	EITI-Shqipëri është një institucion qendror, në varësi të ministrisë përgjegjëse për energjinë dhe industrinë, që ushtron funksionet në kuadër të anëtarësimit në organizimin ndërkombëtar "EITI-International".	F	Vendimi për krijimin e EITI Shqipëri dhe rregullimin e rolit dhe funksioneve të tij janë miratuar nga Qeveria Shqiptare (KM).
	0.1 P2	Sekretariati koordinon përpjekjet kombëtare, në zbatim të standardit global EITI.	F	Ministri është përgjegjës për zbatimin e veprimeve që lidhen me misionin dhe detyrat e EITI Shqipëri dhe Kryeministri është i informuar në mënyrë periodike mbi performancën.
(b) Qeveria duhet të emërojë një individ të kategorisë së lartë për të udhëhequr zbatimin e EITI. I emëruari duhet të ketë besimin e të gjitha palëve të interesuara, autoritetin dhe lirinë për të koordinuar veprimet e lidhura me EITI në të gjitha ministrinë dhe agjencitë përkatëse, dhe të jetë në gjendje për të mobilizuar burimet për zbatimin e EITI.	0.1 P.15	Ngarkohet Ministri i Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e kërkesave për përmbushjen e standardeve EITI, kërkesa të cilat janë rregulluar në VKM.	P	Qeveria ka miratuar aktet për të siguruar angazhimin e plotë, aktiv dhe efektiv në procesin EITI.
	0.1 P.7	EITI Shqipëri informon në mënyrë periodike, me shkrim Kryeministrin, për ecurinë e realizimit të programit të veprimeve dhe të raportit vjetor të EITI.	P	
(c) Qeveria duhet të jetë plotësisht e angazhuar në mënyrë aktive dhe efektive në procesin EITI.	0.1 P 2	MSG kryesohet nga zëvendësministri i Ekonomisë.	F	
(d) Qeveria duhet të sigurojë që zyrtarët e lartë të qeverisë të jenë të përfaqësuar në grupin shumë palësh.	0.2 P.2	Niveli i përfaqësimit në këtë grup për institucionet shtetërore do të jetë jo më i ulët se drejtor drejtorie.	F	

1.2 Angazhimi i kompanisë				
(a) Kompanitë duhet të jenë plotësisht të angazhuar në mënyrë aktive dhe efektive në procesin EITI.	0.2 P.2e	MSG, i cili është organ vendimmarrës përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të EITI, është i përbërë nga 16 anëtarë, nga të cilët 5 janë përfaqësues të kompanive të cilat operojnë në sektorin e industrisë nxjerrëse.	F	
(b) Qeveria duhet të sigurojë që ekziston një mjedis i përshtatshëm për pjesëmarrjen e kompanisë në lidhje me ligjet, rregulloret dhe rregullat administrative, si dhe praktikën aktuale në zbatimin e EITI. Të drejtat themelore të përfaqësuesve të kompanisë të angazhuar në mënyrë thelbësore në EITI, duke përfshirë por jo kufizuar në anëtarët e grupit shumë-palësh, duhet të respektohet.	0.1 0.3		P	Pjesëmarrja e kompanive, përveç atyre kompanive që marrin pjesë në MSG, është dhënë në ligjin për konsultimin publik ² .
(c) Qeveria duhet të sigurojë se nuk ka pengesa për pjesëmarrjen e kompanisë në procesin EITI.	0.1 P.4	Vendimmarja bëhet nga MSG, e cila është një platformë tri partite me pjesëmarrës nga kompanitë që operojnë në këtë industri.	F	
	0.6 A.1 P.2	Ligji për informimin dhe konsultimin publik cakton rregullat e procedurës që duhet ndjekur për të siguruar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në politikë dhe proceset vendimmarrëse të autoriteteve publike.	F	
	P.3	Ky ligj ka për qëllim të promovojë transparencën, llogaridhënien dhe integritetin e autoriteteve publike.	F	
	0.5	Rregullat e parashikuara në këtë ligj		

² Ligji Nr. 146/2014 "Pwr informimin dhe konsultimin publik"

	A1 P2	ka për qëllim të garantojë publikun, duke siguruar me informacion, në kuadër të ushtrimit në praktikë të drejtat dhe liritë individuale, si dhe formimin e pikëpamjeve në lidhje me gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë.		
	P3	Ky ligj ka për qëllim të promovojë integritetin, transparencën dhe llogaridhënien e autoriteteve publike.		
1.3 Angazhimi i shoqërisë civile Në përputhje me protokollin e shoqërisë civile:				
a) Shoqëria civile duhet të jetë plotësisht, në mënyrë aktive dhe efektive e angazhuar në procesin e EITI.	0.2 P2ë	MSG, i cili është një organ vendimmarrës përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të EITI, është i përbërë nga 16 anëtarë, nga të cilët 5 janë përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile. Këshilli Kombëtar i Shoqërisë Civile ka për qëllim për të siguruar bashkëpunimin institucional me organizatat e shoqërisë civile në të mirë të konsolidimit të qeverisjes së mirë dhe rritjes së transparencës në vendimmarrje publike përmes pjesëmarrjes më të madhe të shoqërisë civile në këtë proces.	F	
b) Qeveria duhet të sigurojë që ekziston një mjedis i përshtatshëm për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në lidhje me ligjet, rregulloret dhe rregullat administrative, si dhe praktikën aktuale në zbatimin e EITI. Të drejtat themelore të shoqërisë civile të angazhuar në mënyrë thelbësore në EITI, duke përfshirë por jo kufizuar në anëtarët e grupit me shumë palësh, duhet të respektohen.	0.4 A.1		F	
c) Qeveria duhet të sigurojë se nuk ka pengesa për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në procesin EITI.	0.1 P.4	Vendimmarrja realizohet nga MSG, e cila është një platformë tripalëshe me pjesëmarrës nga shoqëria civile. Ligji për informim dhe konsultim publik përcakton rregullat e procedurës që duhet të ndiqen për të	P	Nuk ka asnjë vendim qeverie që ngushton ose kufizon debatin publik, por nuk ka asnjë dispozitë që përmend promovimin e debatit publik në bazë të raporteve EITI për menaxhimin e burimeve natyrore.
	0.6 A.1			

Qeveria duhet të kufizojë veprimet të cilat rezultojnë të limitojnë ose kufizojnë debatin publik në lidhje me zbatimin e EITI. d) Palët e interesuara, duke përfshirë por jo kufizuar në anëtarët e grupit shumë palësh duhet të: i. jenë në gjendje të flasin lirshëm për çështjet e transparencës dhe qeverisjes së burimeve natyrore. ii. jenë të angazhuar kryesisht në hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e procesit EITI, dhe të sigurojnë se ajo kontribuon në debatin publik. iii. kenë të drejtë të komunikojnë dhe të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin. iv. jenë në gjendje të veprojnë lirisht dhe të shprehin opinionet rreth EITI pa kufizim, shtrëngim ose masë ndëshkimore.	P.2	siguruar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në politikë dhe proceset vendimmarrëse të autoriteteve publike.	F	Edhe pse, sipas fjalorit EITI, MSG është përgjegjëse për të siguruar se EITI kontribuon në debatin publik, një detyrë e tillë nuk është parashikuar shprehimisht në asnjë akt.
	P.3	Ky ligj ka për qëllim të promovojë transparencën, llogaridhënien dhe integritetin e autoriteteve publike.		
	0.5 A1 P2	Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim të garantojnë publikun, duke e siguruar atë me informacion, në kuadër të ushtrimit në praktikë të drejtave dhe lirive individuale, si dhe në formimin e pikëpamjeve në lidhje me gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë.	N	
	P3	EITI Albania bashkëpunon dhe bashkërendon veprimtarinë e saj me MSG dhe institucionet e tjera private /publike, grupet e interesit, shoqërinë civile si dhe media lokale dhe/ose ndërkombëtare	P	
1.4 Grupi shumë-palësh	0.2		F	
a) Qeveria duhet të angazhohet të				

punojë me shoqërinë civile dhe kompanitë, dhe të krijojë një grup shumë-palësh për të mbikëqyrur zbatimin e EITI. Në krijimin e grupit shumë-palësh, qeveria duhet: i. Sigurojë se ftesa për të marrë pjesë në grup është i hapur dhe transparent. ii. Të sigurojë që palët e interesuara të jenë të përfaqësuara në mënyrë adekuate. Kjo nuk do të thotë se ata duhet të jenë të përfaqësuara në mënyrë të barabartë në numër. Grupi shumë palësh duhet të angazhojë palët e duhura, duke përfshirë por pa u kufizuar domosdoshmërisht në: sektorin privat; shoqërinë civile, përfshirë grupet e pavarura të shoqërisë civile dhe shoqërisë civile të tjera të tilla si media dhe sindikatat; dhe subjektet përkatëse qeveritare të cilat mund të përfshijnë parlamentarë. Secili grup shumë-palësh duhet të ketë të drejtë të caktojë përfaqësuesit e vet, duke pasur parasysh dëshirën e një përfaqësimi pluralist dhe të ndryshme. Procesi i nominimit duhet të				
---	--	--	--	--

jetë i pavarur dhe i lirë nga çdo sugjerim i detyruar. Grupet e shoqërisë civile të përfshira në EITI, si anëtarë të grupit shumë palësh duhet të jenë operacionale, si dhe në aspektin e politikave, të pavarura nga qeveria dhe / ose kompanitë. iii. Konsiderojë krijimin e bazës ligjore të grupit. b) Grupi shumë palësh duhet të dakordësojë Terma Reference (ToR) të qarta e publike për punën e tij. ToR duhet, minimalisht të përmbajnë dispozita për: Rolin, përgjegjësitë dhe të drejtat e grupit shumë palësh: i. Anëtarët e grupit shumë palësh duhet të kenë kapacitet për të kryer detyrat e tyre. ii. Grupi shumë pakësh duhet të ndërmarrë aktivitete efektive në terren me grupet e shoqërisë civile dhe kompanive, përfshirë komunikime nëpërmjet medias, faqes zyrtare dhe letrave, për të informuar aktorët e qeverisë të angazhuar për të zbatuar EITI, dhe rolin qendror të kompanive dhe shoqërisë civile. Grupi shumë palësh duhet të shpërndajë gjerësisht informacionin publik që	0.3		F	Nuk janë miratuar terma reference për anëtarët e grupit shumëpalësh. Urdhëri i Kryeministrit dhe rregullorja për organizimin dhe funksionimin e MSG duhet të riformulohet në përputhje të plotë me kërkesat e EITI-t 1.
	0.2		P	
	P.1		P	
	0.3			
	A.5			
	0.2	Niveli i përfaqësimit në MSG për institucionet shtetërore duhet të jetë jo më e ulët se drejtor drejtorie. Sekretariati, për të kryer misionin dhe objektivat e tij, bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet me MSG, EITI dhe institucionet e tjera publike dhe/ose private, grupet e interesit, shoqërinë civile, median lokale dhe ose të huaj. Publikimi i raporteve EITI, duke siguruar përfundimin e procesit dhe procedurave të auditimit për miratimin e raportit.	F	
	A2			
	0.3			
	A6.2			
	0.1	Sekretariati, për të kryer misionin dhe objektivat e tij, bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet me MSG, EITI dhe institucionet e tjera publike dhe/ose private, grupet e interesit, shoqërinë civile, median lokale dhe ose të huaj. Publikimi i raporteve EITI, duke siguruar përfundimin e procesit dhe procedurave të auditimit për miratimin e raportit.	F	
	A6			
	0.1	Sekretariati, për të kryer misionin dhe objektivat e tij, bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet me MSG, EITI dhe institucionet e tjera publike dhe/ose private, grupet e interesit, shoqërinë civile, median lokale dhe ose të huaj. Publikimi i raporteve EITI, duke siguruar përfundimin e procesit dhe procedurave të auditimit për miratimin e raportit.	F	
	A5			
	b)			
		Veprimtaria administrative e		Ekziston vetëm një dispozitë e

rezulton nga procesi i EITI, si Raporti i EITI.		sekretariatit mbikëqyret, rregullohet dhe miratohet nga Ministria përgjegjëse për energjinë dhe industrinë dhe institucionet e tjera.		përgjithshme që rregullon miratimin nga Ministri i energjisë dhe industrisë, por nuk ka dispozitë të veçantë që rregullon miratimin e planit vjetor të punës, caktimin e Administratorit të Pavarur dhe Raportin EITI.
iii. Anëtarët e grupit shumë palësh duhet të ndërliidhen me pjesëmarrësit e tyre.	0.1 A 3		P	
Miratimi i planeve të punës, raporteve EITI dhe raportet vjetore të progresit:				
iv. Grupi shumë palësh është i detyruar të miratojë planet vjetore të punës, emërojë Administratorin e Pavarur, Termat e Referencës për Administratorit të Pavarur, Raportet EITI dhe raportet vjetore të progresit.	0.2		N	
v. Grupi shumë palësh duhet të mbikëqyrë procesin e raportimit EITI dhe të angazhohet në procesin e vleftësim.	P.1 0.3 A.5			
Rregullat dhe procedurat e brendshme të qeverisjes:				
vi. EITI kërkon një proces gjithëpërfshirës vendim-marrës gjatë zbatimit, me cdo pjesëmarrës, duke u trajtuar si një partner. Çdo anëtar i grupit shumë palësh ka të drejtë të shtrojë një çështje për diskutim. Grupi shumë palësh duhet të dakordësojë dhe të publikojë procedurat për emërimin dhe ndryshimin e përfaqësuesve të grupeve shumëpalëshe, vendim-marrjen, kohëzgjatjen e mandatit	0.3 A.7 0.3 A11	Protokolli i takimeve të MSG paraqet librin e procesverbaleve të mbledhjeve MSG. Protokolli mbahet nga sekretari i MSG.	P F	

dhe frekuencat e takimeve. Kjo përfshin dhe garantimin e një procesi për ndryshimin e anëtarëve të grupit në përputhje me parimet e përcaktuara në Kërkesa 1.4.a. në rastin kur grupi shumë palësh ndjek një praktikë dietash për të marrë pjesë në mbledhjet EITI ose në lidhje me pagesa të tjera për anëtarët e grupit shumë-palësh, kjo praktikë duhet të jetë transparente dhe nuk duhet të krijojë konflikte interesi. vii. Duhet të jepet një njoftim paraprak në kohët e mjaftueshme për mbajtjen e takimeve dhe qarkullimin në kohë të dokumenteve përpara diskutimeve të tyre dhe miratimit të propozuar. viii. Grupi shumë palësh duhet të mbajë shënime me shkrim të diskutimeve dhe vendimeve të saj.				
1.5 Plani i Punës Grupi shumë palësh duhet të mbajë një plan aktual pune, për të përlogaritur plotësisht dhe në përputhje me raportimin dhe Vleftësimin e afateve të përcaktuara nga Bordi EITI. Plani i punës duhet: a) të vendosë objektiva të zbatimit EITI të cilat janë të lidhura me Parimet EITI dhe të reflektojnë prioritetet kombëtare për industrinë nxjerrëse. Grupet shumë-palëshe	0.2		N	

inkurajohen për të shqyrtuar qasjet inovative për të zgjeruar zbatimin e EITI për të rritur tërësinë e raportimin EITI dhe të kuptuarit publik të të ardhurave dhe të inkurajojnë standardeve të larta të transparencës dhe llogaridhënies në jetën publike, funksionimin e shtetit dhe në biznes. b) Reflektojë rezultatet e konsultimeve me aktorët kryesorë, të cilat miratohen nga grupi shumë palësh. c) Të përfshijë aktivitete të matshme dhe me afate kohore të caktuara për të arritur objektivat e miratuara. Fusha e zbatimit të EITI duhet të përshtatet në mënyrë që të kontribuojë në arritjen e objektivave të dëshiruara të cilat identifikohen gjatë procesit të konsultimit. Plani i punës duhet të: i. drejtojë dhe të përshkruajë planet për të adresuar çdo kufizim të mundshme të kapaciteteve në agjencitë qeveritare, kompanitë dhe shoqërinë civile që mund të jetë një pengesë për zbatimin efektiv të EITI. ii. Adresojë fushën e raportimit EITI, duke përfshirë edhe planet për adresimin e aspekteve teknike të raportimit, të tilla si gjithëpërfshirja (4.1) dhe besueshmëria e të dhënave (4.9).				
---	--	--	--	--

iii. Të identifikojë dhe përshkruajë planet për të adresuar pengesat e mundshme ligjore ose rregullatore për zbatimin e EITI, duke përfshirë, nëse është e zbatueshme, çdo plan për të integruar Kërkesat EITI brenda legjislacionit ose rregulloreve kombëtare. iv. Të përshkruajë planet e grupit shumë-palësh për zbatimin e rekomandimeve nga Vleftësimi dhe raportimi EITI. d) të identifikojë burimet e brendshme dhe të jashtme të financimit dhe asistencës teknike kur është e nevojshme për të siguruar zbatimin në kohë të planit të miratuar të punës. e) Të jetë gjerësisht i disponueshëm për publikun, për shembull, të publikohet në faqen zyrtare kombëtare të internetit të EITI dhe / ose faqe zyrtare të ministrive dhe agjensive të tjera përkatëse, në mediat e shkruara apo në vende që janë lehtësisht të arritshme për publikun. f) Të rishikohet dhe përditësohet çdo vit. Në rishikimin e planit të punës, grupi shumë- palësh duhet të konsiderojë zgjerimin e detajeve dhe qëllimin e raportimit EITI, duke përfshirë adresimin e				
---	--	--	--	--

çështjeve si menaxhimi i të ardhurave dhe shpenzimeve (5.3), pagesat e transportit (4.4), shpenzimeve diskrecionale sociale (6.1.b), transfertat e përkohshme kombëtare (5.2.b), pronësinë përfituese (2.5) dhe kontratat (2.4). Në përputhje me kërkesat 1.4.b (viii), grupi shumë-palësh duhet të dokumentojë diskutimet dhe vendimet e saj. g) të përfshijë një afat kohor të caktuar për zbatim që pëputhet me raportimin dhe afatet e Vleftësimit të përcaktuara nga Bordi EITI (8.1-8.4) dhe që merr parasysh kërkesat administrative të tilla si proceset e prokurimit dhe financimit.				
---	--	--	--	--



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

Nr. ____ Prot

Datë ____ . ____ 2017

VENDIM

PËR

ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GRUPIT SHUMË-PALËSH (MSG)

Në zbatim të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 19 të ligjit nr 9000 datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Të shprehë qëllimin e qartë të qeverisësë Republikës së Shqipërisë në zbatimin e EITI.
2. Të vendosë rregullat për organizimin dhe funksionimin e grupit shumë-palësh (MSG), gjatë procedurave të anëtarësimit të Shqipërisë në Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI).
3. Angazhimi i qeverisë, kompanive që kryejnë veprimtari në sektorët e industrisë nxjerrëse dhe hidroenergjisë dhe organizatave të shoqërisë civile në MSG bazohet në parimet e mëposhtme:
 - *Dialogu gjithë-përfshirës* - të sigurojë një mjedis të përshtatshëm ku të gjithë anëtarët mund të angazhohen dhe të shprehin mendimet e tyre në mënyrë të lirshme, të hapur, pa kufizime apo detyrime si edhe pa vendosur masë ndëshkimore. Përveç kësaj, përfaqësuesit jo-anëtarë të kompanive dhe shoqërisë civile, të angazhuar kryesisht me EITI, mund të kontribuojnë në diskutimin e çështjeve që lidhen me praktikën e zbatimit të EITI dhe të ligjeve përkatëse, rregulloreve dhe rregullave administrative;
 - *Transparenca* - të sigurojë që ftesa për të marrë pjesë në MSG të jetë e hapur dhe transparente;

- *Aksesueshmëria*- të sigurojë që të gjithë anëtarët të gëzojnë qasje në të gjitha informacionet/të dhënat e rëndësishme dhe të verifikueshme, në përputhje me kufizimet e përcaktuar në këtë ligj;
- *Llogaridhënia* - të sigurojë që të gjithë anëtarët të jenë të përkushtuar në më të mirën e njohurive dhe kapaciteteve të tyre për të përmbushur angazhimet, si dhe t'i përmbahen rregullave, standardeve dhe udhëzimeve, të dakordësuara;
- *Qëndrueshmëria* – të sigurojë një kontribut të çmuar në drejtim të miratimit të politikave të qëndrueshme duke promovuar besimin e ndërsjellë;
- *Efektiviteti* - të sigurojë një përfaqësim dhe angazhim të përshtatshëm të tre grupeve kryesore të aktorëve duke përfshirë zyrtarë qeveritarë të nivelit të lartë si edhe përfaqësues të shoqërisë civile apo kompanive që janë kryesisht të angazhuar me planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e procesit të EITI si një garanci që objektivat e tyre në këtë angazhim të arrihen.

4. MSG do të përbëhet nga sa vijon:

4.1. Tetë përfaqësues nga zyrtarë të nivelit të lartë nga institucionet qeveritare, të listuara si më poshtë:

- *Një përfaqësues nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë;*
- *Një përfaqësues nga Ministria e Financave;*
- *Një përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë;*
- *Një përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve*
- *Një përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;*
- *Një përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore*
- *Një përfaqësues nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar*
- *Instituti Shkencor i Hidrokarbureve*

4.2. Pesë përfaqësues të sektorit privat, të cilët do të përzgjidhen nëpërmjet një procesi të nisur nga sektori i biznesit me mbështetjen e Sekretariatit ALBEITI.

4.3. Pesë përfaqësues të Organizatave të Shoqërisë Civile të cilët do të përzgjidhen nëpërmjet një procesi të nisur nga organizatat e shoqërisë civile me mbështetjen e Sekretariatit ALBEITI

5. MSG do të kryesohet nga zv. Ministri i ministrisë përgjegjëse për industrinë nxjerrëse i cili ëhstë njëkohësisht Koordinator kombëtar për Transparencën në Industrinë Nxjerrëse i caktuar nga kryeministri.
6. Anëtarët e MSG do të emërohen për një periudhë fillestare prej 3 vitesh, me të drejtë ri-emërimi. Numri i anëtarëve të MSG mund të ndryshohen dhe mund të emërohen anëtarë shtesë me propozimin dhe konsensusin e anëtarëve të MSG vetëm me kushtin që të ruhet natyra trepalëshe e grupit shumë-palësh. Në rastin kur një prej anëtarëve jep dorëheqjen para mbarimit të afatit, pasardhësi i tij/saj do të emërohet nga MSG me propozimin e palëve përkatëse. Secili prej grupit trepalësh do të caktojë një përfaqësues të përhershëm dhe një përfaqësues alternativ në MSG.

7. Përfaqësuesit alternativ emërohen në përputhje me procedurat e aplikuara si në rastin e përfaqësuesve kryesorë të MSG dhe mund të marrin pjesë në mbledhjet e MSG, por mund të votojnë vetëm në rastin kur mungon përfaqësuesi kryesor.
8. Secila palë, me vendim të anëtarëve të saj dhe nëpërmjet procesit të vet të pavarur mund të zëvendësojë përfaqësuesin e saj në MSG, nëçdo kohë duke ndjekur mekanizmat e saj të qeverisjes.
9. Anëtarët e MSG mund të bien dakord që në takimin e MSG mund të marrin pjesë edhe ekspertë të jashtëm me rol këshillues, të cilat gëzojnë të drejtën e tëshprehurit, por jo të drejtën e votës, si dhe nga vëzhguesit, të cilat mund të ndjekin mbledhjet, por nuk do të gëzojnë të drejtën e të shprehurit dhe as të votimit. Kryetari i MSG duhet të njoftohet paraprakisht në rastin e të pranishmëve shtesë në mbledhjet e MSG dhe në çdo rast jo më vonë se 10 ditë përpara mbajtjes së takimit përkatës.
10. Sekretariati ALBEITI do të shërbejë si sekretariat teknik i MSG për të lehtësuar dhe koordinuar mbledhjet dhe do të jetë në konsultim të ngushtë me Kryetarin dhe anëtarët e MSG.
11. Sekretariati do të jetë në dispozicion të tre aktorëve kryesorë në mënyrë të barabartë dhe do të marrë pjesë në mbledhjet e MSG pa pasur të drejtën e votës. Kryetari mund t'i japë Sekretariatit ALBEITI të drejtën e të shprehurit, vetëm kur kjo është e nevojshme për qëllime të raportimit.
12. Funksionet e Sekretariatit ALBEITI përfshijnë përgatitjen e takimeve, mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes dhe qarkullimin e minutave të takimit tek MSG dhe sigurimin që t'i vendosë ato në dispozicion të publikut sipas marrëveshjes midis anëtarëve.
13. Vendimet e MSG, përfundimet e takimit dhe dokumente të tjera duhet të jenë të aksesueshme elektronikisht nga publiku. Sekretariati i ALBEITI do të ruajë të gjitha dokumentet për MSG në një format që siguron se këto dokumenta mund të aksesohen në mënyrë elektronike në çdo kohë.
14. Kryetari informon anëtarët e MSG në mënyrë periodike në lidhje me çështjet që dalin gjatë ushtrimit të vazhdueshëm të aktiviteteve.
15. Roli dhe funksionimi i MSG rregullohet me urdhër të ministrit përgjegjës për industrinë nxjerrëse.
16. Rregullorja Nr. 20 datë 20.01.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Grupit Shumë-palësh gjatë procedurave të anëtarësimit të Shqipërisë në Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse", shfuqizohet.
17. Ky vendim do të hyjë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi RAMA



REPUBLIKA E SHQIPËISË
MINISTRIA E ENERGJISË DHE INDUSTRIË
MINISTRI

Nr. ____ Prot

Datë ____ . ____ 2017

URDHËR
PËR
MIRATIMIN
E
RREGULLORES

**PËR PËRCAKTIMIN E TERMAVE TË REFERENCËS PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GRUPIT SHUMË-
PALËSH (MSG) TË NISMËS PËR TRANSPARENCË NË INDUSTRIJË NXJERRËSE NË SHQIPËRI**

Në zbatim të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pikës 18 të Vendimit të Këshillit të Ministrave për organizimin dhe funksionimin e Grupit Shumë-palësh (MSG), me propozimin e Drejtorit të Sekretariatit, ministri përgjegjës për energjinë dhe industrinë,

URDHËROI:

1. Miratimin e Rregullores “Për përcaktimin e termave të referencës për organizimin dhe funksionimin e grupit shumë-palësh (MSG) të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse në Shqipëri”

2. Kryetari i Grupit Shumë-palësh ngarkohet të marrë masat e duhura për të siguruar zbatimin e rregullores nga ana e anëtarëve të tjerë MSG.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR
DAMIAN GJIKNURI**

RREGULLORE

PËR

PËRCAKTIMIN E TERMAVE TË REFERENCËS PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GRUPIT SHUMË-PALËSH (MSG) TË NISMËS PËR TRANSPARENCË NË INDUSTRIJË NXJERRËSE NË SHQIPËRI

1. Dispozitë e hapur për qëllimin e EITI

Mirëpresim dhe mbështesim përpjekjet e Qeverisë Shqiptare për të zbatuar nismën për transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI), në mënyrë që të përmbushë objektivat e saj dhe për të siguruar se standardi EITI do të zbatohet plotësisht në Shqipëri dhe qeveria shqiptare paraqet një nivel të lartë të transparencës dhe llogaridhënies përmes një procesi të një dialogu të hapur mes palëve të interesuara.

Grupi shumë palësh bashkon qeverinë, kompanitë/sectorin privat dhe organizatat e shoqërisë civile duke kombinuar perspektiva të ndryshme në sigurimin e udhëheqjes dhe vendosjen e politikave dhe rregullave, ndarjen rreziqesh dhe përgjegjësisë, duke arritur një bashkëpunim efektiv bazuar në qëllimin e përbashkët dhe besimin e ndërsjellë.

2. Përgjegjësitë dhe funksionet e MSG

2.1. Përgjegjësitë e MSG:

1. MSG është organ vendimmarrës në nivel politikash dhe strategjish i përbërë nga përfaqësues nga qeveria, kompanitë dhe shoqëria civile që mbikëqyrin zbatimin e EITI në Shqipëri.
2. MSG do të mbështetet teknikisht nga Sekretariati i EITI.
3. Përgjegjësia kryesore e MSG është të sigurojë që qeveria shqiptare të plotësojë të paktën kërkesat e detyrueshme dhe të arrijë të bëhet vend në përputhje me EITI në kohën e duhur dhe në mënyrë efektive
4. MSG harton dhe miraton planin e punës, raportin EITI dhe siguron që EITI kontribuon në debatin publik rreth sektorit nxjerrës në Shqipëri.(delete)
5. MSG siguron që të gjithë palët e interesuara të trajtohen si partnerë në një proces vendimmarrës e gjithëpërfshirës dhe t'i jepet mundësia për të marrë pjesë në zhvillimin, monitorimin dhe vlerësimin e procesit të zbatimit të EITI në Shqipëri.
6. MSG duhet të konsultohet në mënyrë periodike me anëtarët e grupit trepalësh në mënyrë të qartë dhe gjithëpërfshirëse, me qëllim që të arrihen rezultate transparente dhe të shmangen barrierat.
7. Anëtarët MSG duhet të raportojnë dhe të sigurojnë një informacion të plotë dhe të besueshëm për përfaqësuesit e tyre përkatës.

2.2. Funksionet e MSG:

1. MSG jep rekomandime për hartimin e një plani pune të përlllogaritur e të plotë që përmban objektiva të matshme dhe afatet kohore për zbatimin e tij, në të cilin është integruar dhe vlerësimi i kufizimeve të kapaciteteve;
2. MSG harton dhe zbaton strategjinë e komunikimit;
3. MSG krijon dhe mbështet çdo nën-grup për të shqyrtuar çështje të caktuara, të cilat mund të përfshijnë përgatitjen e formateve të raportimit dhe përgatitjen e informacionit kontekstual për vlerësimin vjetor të përpuethshmërisë me standardet EITI;
4. MSG vlerëson dhe jep rekomandime mbi qëllimin, përmbajtjen dhe formatin e raportimit EITI në Shqipëri;
5. MSG dakordëson për informacionin përkatës që duhet të përfshihet në raportin vjetor;
6. MSG vlerëson nëse raporti EITI është gjithëpërfshirës, i promovuar në mënyrë aktive, lehtësisht i aksesueshëm nga publiku dhe kontribuon në debatin publik;
7. MSG i raporton Qeverisë Shqiptare, ku dhe kur është e përshtatshme dhe e nevojshme.
8. MSG duhet të komunikojë dhe të rrisë ndërgjegjësimin e publikut në lidhje me EITI, qëllimin dhe objektivat e tij, si dhe ecurinë e procesit të zbatimit të EITI në Shqipëri.

3. Sekretariati teknik ALBEITI

1. Sekretariati ALBEITI është themeluar nga Qeveria Shqiptare për të koordinuar punën e MSG dhe është përgjegjëse për administrimin e aktiviteteve në lidhje me zbatimin e EITI në Shqipëri.

2. Funksionet ALB-EITI konsistojnë në:

- Drejtimin e konsultimeve në lidhje me planin e punës, hartimin e planit të punës, raportit EITI dhe siguron që EITI të kontribuojë në debatin publik rreth sektorit nxjerrës në Shqipëri;
- Përcaktimin e qëllimit, përmbajtjes dhe formatit të raportimit EITI në Shqipëri dhe mund të caktojë agjenci përgjegjëse për zbatimin e EITI;
- Asistimin e anëtarëve të MSG me anë të sigurimit të mbështetjes administrative në mbajtjen e takimeve të MSG dhe vazhdimësinë e tyre;
- Koordinimin e aktiviteteve të komunikimit për të inkurajuar përdorimin e të dhënave të EITI, faqen EITI dhe menaxhimin e marrëdhënieve me median;
- Koordinimin e komunikimeve mes anëtarëve të MSG dhe aktorëve të tjerë jo-anëtare;
- Publikimin e Raportit vjetor të aktiviteteve;
- Kërkimin e fondeve dhe shpërndarjen e burimeve për aktivitetet e EITI;
- Angazhimin e një Administratorit të Pavarur dhe / ose asistence teknike, menaxhimin e procesit të rekrutimit si dhe përcaktimin e Termat e Referencës për Administratorin e Pavarur;

4. Kodi i Sjelljes

1. Dispozitat e Kodit të Sjelljes të Shoqatës EITI zbatohen përshtatshmërisht për anëtarët e MSG si dhe për Sekretariatit AL-EITI, përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë Rregullore;
2. Referuar Kodit të Sjelljes të Shoqatës EITI çdo i pranishëm, anëtarë i MSG ose jo-anëtarë, i autorizuar, zëvendësi, vëzhguesi apo ekspertë, duhet të deklarojë me shkrim çdo konflikt interesi, tek Kryetari i MSG, përpara se të marrë pjesë në një takim të MSG dhe / ose procedurë votimi.

5. Caktimi i anëtarëve të MSG dhe i procedurave të takimit

5.1. Caktimi i anëtarëve të MSG

18. MSG do të kryesohet nga zv. Ministri i ministrisë përgjegjëse për industrinë nxjerrëse i cili ëhstë njëkohësisht Koordinator kombëtar për Transparencën në Industrinë Nxjerrëse i caktuar nga kryeministri.
1. MSG përbëhet nga 17 anëtarë kryesorë, me shtatë përfaqësues nga qeveria dhe me nga pesë përfaqësues nga shoqëria civile dhe kompanitë.
2. Anëtarët MSG emërohen nga Qeveria e Shqipërisë për një periudhë fillestare prej 3 vitesh, me të drejtë të ri-emërimi.

3. Numri i anëtarëve të MSG mund të ndryshohet dhe anëtarët e tjerë mund të emërohen me propozimin dhe konsensusin e anëtarëve të MSG dhe vetëm me kusht që të ruhet natyra trepalëshe e grupit të aktorëve.
4. Në rastin kur një prej anëtarëve jep dorëheqjen para mbarimit të afatit, pasardhësi i tij/saj do të emërohet nga MSG me propozimin e aktorëve përkatës.
5. Secili prej grupit trepalësh do të caktojë një përfaqësues të përhershëm dhe një alternativ në MSG.
6. Anëtarët alternativ emërohen në përputhje me procedurat e aplikuara në rastin e anëtarëve kryesorë të MSG dhe mund të marrin pjesë në mbledhjet e MSG, por mund të votojnë vetëm në rastin kur mungon anëtari kryesorë.
7. Anëtarët alternative do të listohen në faqen e internetit të ALB-EITI dhe do të marrin të gjitha mesazhet elektronike të MSG në të njëjtën mënyrë si anëtarë kryesore.
8. Secili aktor, me vendim të anëtarëve të saj dhe nëpërmjet procesit të vet të pavarur mund të zëvendësojë përfaqësuesit e tyre në MSG në çdo kohë duke ndjekur mekanizmat e tyre të qeverisjes.
9. Anëtarët e MSG mund të bien dakord që në takim mund të marrin pjesë edhe ekspertë të jashtëm me kapacitet këshillues, të cilat gëzojnë të drejtën e të shprehurit, por nuk kanë të drejtë të votojnë, si dhe nga vëzhguesit, të cilët mund të ndjekin mbledhjet, por nuk do të gëzojnë të drejtën e të shprehurit apo të votimit. Kryetari i MSG duhet të njoftohet në adnacë për të pranishmit shtesë në mbledhjet e MSG dhe në çdo rast, jo më vonë se 10 ditë përpara takimit përkatës.

5.2. *Procedurat e takimit*

1. MSG do të mbledhen çdo dy muaj ose siç është rënë dakord ndryshe, derisa Shqipëria të bëhet një vend plotësisht në përputhje me standardet EITI.
2. Kryetari i MSG do të vendosë rendin e ditës për mbledhjet. Njoftimi për mbledhje, rendi i ditës dhe çdo informacion tjetër i përgjithshëm do t'i shpërndahen anëtarëve të MSG së paku një javë para datës së mbledhjes;
3. Nëse ka ndonjë çështje të nevojshme apo urgjente që duhet të diskutohet dhe të vendoset, Kryetari mund të thërrasë një mbledhje të jashtëzakonshme.
4. Kryetari dhe anëtarët e tjerë të MSG duhet të mbështeten nga Sekretariati ALBEITI.
5. Vendimet e MSG, përfundimet e takimit dhe dokumentet e tjera në përgjithësi do të jenë të aksesueshme në mënyrë elektronike. Sekretariati i ALBEITI do të ruajë të gjitha dokumentet për MSG në një format që siguron se këto dokumenta mund të aksesohen në mënyrë elektronike në çdo kohë.
6. Minutat e takimeve do të qarkullohen tek MSG dhe do të vendosen në dispozicion të publikut sipas marrëveshjes midis anëtarëve;

7. Kërkesa për një pushim të shkurtër gjatë takimit për qëllime të konsultimit në grup do të jepet në çdo kohë. Kohëzgjatja e pushimit do të vendoset rast pas rasti nga Kryetari.

6. Vendim-marrja/Votimi

MSG merr vendime mbi bazë konsensusi kurdo që të jetë e mundur. Kur konsensusi nuk është i mundur do të aplikohen parimet vendimmarrëse dhe rregullat e votimit.

6.1. Parimet e Vendim-marrjes

1. MSG është e angazhuar për të vepruar në frymën e bashkëpunimit me qëllim arritjen e marrëveshjes së përgjithshme mes të gjithë anëtarëve në të gjitha vendimet.
2. Në rastet kur nuk mund të arrihet marrëveshje e përgjithshme, një votim formal do të merret në diskrecionin e Kryetarit dhe do të aplikohen rregullat e votimit. Megjithëse konsensusi nuk është gjithmonë i mundur, parimet e vendimmarrjes janë përcaktuar për të arritur konsensusin më të madh të mundshëm.
3. Në vendimmarrje do të marë pjesë një kuorum prej 9 anëtarësh kryesorë të MSG ose zëvendësues me një minimum prej 2 përfaqësues nga secili grup të palëve të interesuara.
4. Kryetari do të synojë që vendimet të merren me konsensus duke e bërë votimin të panevojshëm.

6.2. Rregullat e vendimmarrjes

1. Vendimmarrja do të konsistojë në një sistem hierarkik si në vijim:

a) Konsensusi

Kryetari do të kërkojë të arrijë konsensus për të gjitha vendimet. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë do të kërkohet konsensus I modifikuar.

b) Konsensusi I modifikuar

- Përbëhet nga dy të tretat apo një shumicë më e madhe votash dhe përfshin një minimum prej 2 përfaqësuesish nga çdo grup të palëve të interesuara.

Nëse kjo nuk arrihet, do të formohet një nën - grup pune i përbërë nga një përfaqësim i barabartë nga çdo grup i interesuar, për të diskutuar dhe negociuar një rekomandim. Ky proces mund të zhvillohet gjatë mbledhjes ose pas takimit, me qëllim sigurimin e një rekomandimi për mbledhjen e ardhshme të MSG. Pasi nën-grupi i ka dhënë rekomandimin e tij, MSG do të kërkojë të marrë një vendim në bazë të konsensusit apo konsensusit të modifikuar.

2. Në qoftë se një konsensus i modifikuar nuk është e mundur, atëherë konsensusi nuk është i mundur.
3. Një votë do të caktohet për një anëtar, dhe do të shënohen abstenimet.
4. Një kuorum prej 9 anëtarësh të MSG, me një minimum prej 2 përfaqësues nga secili grup të palëve të interesuara do të përfaqësohet për çdo votë. Numri i votave të nevojshme për të kaluar një mocion do të përshtatet në bazë të abstenimeve për të ruajtur dy të tretat.

6.3. Rregullimet për zëvendësuesit

- Një kuorum prej 9 anëtarësh të MSG, me një minimum prej 2 përfaqësues nga secili grup të palëve të interesuara do të llogaritet për çdo mocion.
- Kur një anëtar nuk është në gjendje të jetë i pranishëm në një takim, ai anëtar mund të caktojë ose një anëtar alternativ ose një person tjetër për të vepruar si ndërmjetës në atë takim, dhe duhet që të këshillojë Sekretariatit ta caktojë këtë anëtar para takimit.
- Asnjë anëtar alternativ apo ndërmjetës nuk mund të ketë më shumë se dy vota në një kohë, me përjashtim të Kryetarit.
- Në rrethana të jashtëzakonshme dhe në diskrecionin e kryetarit, kur sekretariatit nuk i kanë këshilluar për një anëtar alternativ ose ndërmjetës, dhe rrjedhimisht një anëtar mungon në takim, vota e zëvendësuesit do t'i atribuohet Kryetarit. Kryetari mund të votojë, abstenojë ose të përdori votën sipas diskrecionit të tij.

6.4. Abstenimi

1. Kur një anëtar qëllimisht abstenon në një process vendimmarrje, vota e tyre nuk do të llogaritet pro ose kundër një vendimi, vota e tyre do të hiqet nga numri i votuesve.
2. Për të siguruar që abstenimi nga një anëtar është i qëllimshëm, një anëtar do të njoftojë Sekretariatit e ALBEITI-i për këtë qëllim, kur është e mundur paraprakisht, dhe të sigurojë që abstenimi të jetë i regjistruar në procesverbalin e mbledhjes, ose në procesverbalin e vendimit.

Përshkrim i Përgjithshëm: Sektori Minerave

Kërkesat EITI	0.1 Ligji Nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar 0.2 Vendimi nr. 320, datë 21.4.2011 “Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese” I Këshillit të Ministrave, I ndryshuar. 0.3 VKM nr.741, date 09.09.2015 “Për miratimin e formës, rasteve të kthimit dhe mënyrës së llogaritjes të garancive financiare për rehabilitimin e mjedisit, për realizimin e programit minimal të punës dhe realizimin e investimit në veprimtarinë minerare”. 0.4 VKM 726, date 02.09.2015 “ Për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar, 2016–2018, për zhvillimin e aktivitetit minerar dhe përcaktimin e zonave minerare të rrezikshme”. 0.5 VKM nr. 942, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave dhe të dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare ne zonat e hapura.” 0.6 VKM nr.442, datë 16.06.2011 “Për miratimin e kushteve, të dokumenteve vërtetuese, të afateve të vlefshmërisë dhe të procedurave të shqyrtimit të kërkesave për autorizimin e tregtimit të mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara”. 0.7 VKM nr.479, datë 29.06.2011 “Për miratimin e strategjisë minerare të Republikës së Shqipërisë”. 0.8 VKM nr.364, datë 04.05.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të vlerës minimale të sipërfaqes së zonës së lejuar minerare dhe të vlerës minimale të investimit e të prodhimit për një leje minerare”. 0.9 VKM nr.362, datë 29.04.2011 “Për miratimin e kriterëve dhe rregullave të transferimit, mënyrës së aplikimit për shtyrjen e afateve dhe shndërrimit të lejeve minerare”.	N- nuk përputhet P- përputhet pjesërisht F- përputhet plotësisht N/A-nuk aplikohet A- Neni P- Pika
---------------	---	--

	0.10 VKM nr.320, datë 21.04.2011 “Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese”. 0.11 VKM nr.233, datë 23.3.2011 “Për miratimin e formës së raporteve, të mënyrës së botimit të të dhënave për pagesat e taksave vendore dhe kombëtare në sektorin minerar të Republikës së Shqipërisë, si dhe të nivelit të konfidencialitetit në kuadër të nismës për transparencë në industrinë nxjerrëse”. 0.12 VKM nr.232, datë 23.3.2011 “Për miratimin e funksioneve të strukturave përgjegjëse në sektorin minerar të Republikës së Shqipërisë”. 0.13 VKM Nr.942, datë 17.11.2010 "Për miratimin e procedurave dhe të dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura", I ndryshuar; 0.14 Urdhër Nr. 202, datë 20.06.2016, “Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore, Përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet”. 0.15 Urdhër Nr. 201, datë 20.06.2016, “Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore,përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit me karrierë përgrupin e mineraleve ndërtimore”. 0.16 Urdhër nr.414, datë 03.06.2011, “Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së planit të menaxhimit dhe informacioneve që mbahen nga zotëruesi i lejes minerare për punimet e kryera, depozitimin, trajtimin e mbetjeve minerare dhe analizimin e tyre”. 0.17 Urdhër nr.388, datë 20.05.2011 “Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së planit të planit të monitorimit post-minerar”. 0.18 Urdhër nr.386, date 20.05.2011 “Per miratimin e rregullave për perdorimin e të dhënave minerare të një leje minerare” 0.19 Urdhër nr.384, datë 20.05.2011, ““Për miratimin e procedurave të regjistrimit dhe dokumentacionit që regjistrohet në kadastrën	
--	--	--

	minerare dhe në regjistrin mineral si dhe forma dhe procedurat e raportimit të këtij dokumentacioni nga ana e zotëruesve të lejeve minerare”; 0.20 Urdhër nr.312, datë 13.04.2011, "Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së informacioneve të detyrueshme që përgatiten nga zotëruesit e lejeve minerare”; 0.21 Urdhër nr.311, datë 13.04.2011, “Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore, përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të kërkimit-zbulimit-shfrytëzimit për grupin e mineraleve të çmuara dhe gjysëm të çmuara”; 0.22 Urdhër nr.306, datë 13.04.2011, “Për procedurat dhe formën e hartimit të planit vjetor mineral”; 0.23 Urdhër nr.304, datë 13.04.2011, “Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së projektit të zhvillimit të veprimtarisë minerare”; 0.24 Urdhër nr.302, datë 12.04.2011, “Për miratimin e parimeve bazë për hartimin e planit të rehabilitimit të mjedisit, të planit të veprimtarive të mbylljes së veprimtarisë minerare, të mënyrës së përcaktimit të zonës së rrezikshme të një të drejte minerare dhe të planit të menaxhimit të mbetjeve minerare”; 0.25 Urdhër Nr.477, datë 27.06.2011 "Për miratimin e formës, përmbajtjes dhe procedurave të hartimit të akteve të miratimit dhe refuzimit për aplikimin për leje minerare”; 0.26 Udhëzim Nr.17, datë 28.01.2015 “Për përcaktimin e kriterëve për miratimin e nënkontraktimit të së drejtës së lejes minerare, për kërkim zbulim, për shfrytëzim apo për kërkim – zbulim – shfrytëzim”; 0.27 Udhëzim nr.718, datë 03.10.2011 “Për mënyrën e vlerësimit të garancive financiare të lejeve minerare”; 0.28 Ligji 9975, date 28.7.2008 "Për taksat kombëtare”; 0.29 Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për taksat lokale” 0.30 Ligji 125/2015 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i	
--	---	--

	ndryshuar; 0.31 Ligji nr.10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë"; 0.32 Ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit”; 0.33 Ligji 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” 0.34 Ligji 9917 dated 19.05. 2008 “për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”. 0.35 Ligji nr. 7926, datë 04.20.1995 "për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në kompani tregtare "; 0.36 Ligji nr. 9723/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” 0.37 Ligji nr 9920 dated 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”i ndryshuar. 0.38 VKM Nr.7, datë 4.1.2012 "Për procedurat dhe dokumentacionin për arkëtimin e taksës së rentës minerare".				
Kërkësa EITI:	Ref:	Dispozita e legjislacionit Shqiptar	Niveli i përputh smërisë	Rekomandime/komente	
Kërkësa EITI 1: Mbikqyrja nga ana a Grupit Shumë-Palësh dhe kushtet					
1.1 Angazhimi i qeverisë (a) Qeveria është e detyruar të lëshojë një deklaratë të qartë publike për qëllimin e saj për të zbatuar EITI. Deklarata duhet të bëhet nga kreu i shtetit ose qeverisë, ose një përfaqësues i qeverisë i deleguar në mënyrë të përshtatshme. (b) Qeveria duhet të emërojë një individ të kategorisë së lartë për të udhëhequr zbatimin e EITI. I emëruari duhet të ketë besimin e të gjitha palëve të interesuara,	0.1		N/A		

autoritetin dhe lirinë për të koordinuar veprimet e lidhura me EITI në të gjitha ministrinë dhe agjencitë përkatëse, dhe të jetë në gjendje për të mobilizuar burimet për zbatimin e EITI. (c) Qeveria duhet të jetë plotësisht e angazhuar në mënyrë aktive dhe efektive në procesin EITI. (d) Qeveria duhet të sigurojë që zyrtarët e lartë të qeverisë të jenë të përfqësuar në grupin shumë palësh.	0.1 A36 P 25 0.1 A 50 A 51	Bazuar në ligjin 10304 datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar", Qeveria është angazhuar në mënyrë aktive në procesin e EITI, duke demonstruar mbështetjen për përmbushjen e disa Standardeve EITI lidhur me aktivitetin e minierave. Lligji nr. 10304, përcakton si më poshtë: Në funksion të aktiviteteve të saj, Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë informacion nga subjektet që mbajnë licencën minierale, administrata tatimore dhe doganore dhe organet e qeverisjes vendore, dhe të publikojnë të dhënat vjetore të raportit lidhur me pagimin e detyrimeve fiskale, të kryera nga subjekte minerare". Neni 50 dhe 51 i ligjit 10304, përcakton detyrimin e raportimit dhe të drejtën e autoriteteve kompetente për të publikuar të dhëna mbi detyrimin fiskal të paguar.	Kjo dispozitë është shumë e përgjithshme, por ka për qëllim të kërkojë mbështetjen e qeverisë në procesin EITI. Rekomandohet që të rishikohen më tej këto çështje: 1. Lloji i të dhënave të raportuara duhet të shtrihen në funksion të Standardeve EITI (jo vetëm nga pikëpamja fiskale). 2. Të dhënat të cilat duhet raportohen nga mbajtësi i lejes minerare duhet të përcaktohen më qartë, në mënyrë që të përfshijnë të dhënat të plota që do të përdoren për qëllime të Raportit EITI (jo vetëm nga pikëpamja fiskale). VKM ekzistuese që rregullon formatet e raportimit të mbajtësit të lejeve minerare dhe institucioneve shtetërore (tatimore dhe zyra doganore) duhet të ndryshohet në mënyrë që të caktohen afate për subjektet që kanë të bëjnë me raportimin dhe të përfshijnë në formatet përkatëse të dhëna shtesë. 3. Strukturat përgjegjëse në Ministri ose AKBN (e cila është një strukturë në varësi të Ministrisë) duhet të verifikojnë periodikisht përmbushjen e detyrimit të raportimit EITI, nga zotëruesi i lejes minerare dhe, në përputhje me nenin 45, duhet të aplikojnë gjopa në drejtim të kompanive të cilat nuk arriten të respektojnë këtë detyrim.
--	---	---	--

1.2 Angazhimi i kompanisë (a) Kompanitë duhet të jenë plotësisht të angazhuar në mënyrë aktive dhe efektive në procesin EITI. (b) Qeveria duhet të sigurojë që ekziston një mjedis i përshtatshëm për pjesëmarrjen e kompanisë në lidhje me ligjet, rregulloret dhe rregullat administrative, si dhe praktikën aktuale në zbatimin e EITI. Të drejtat themelore të përfaqësuesve të kompanisë të angazhuar në mënyrë thelbësore në EITI, duke përfshirë por jo kufizuar në anëtarët e grupit shumë-palësh, duhet të respektohet. (c) Qeveria duhet të sigurojë se nuk ka pengesa për pjesëmarrjen e kompanisë në procesin EITI.	0.1	Ky standard nuk aplikohet në ligjin nr. 10304, date 17.05.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.	N/A	
1.3 Angazhimi i shoqërisë civile Në përputhje me protokollin e shoqërisë civile: e) Shoqëria civile duhet të jetë plotësisht, në mënyrë aktive dhe efektive e angazhuar në procesin e EITI.			N/A	Komentet lidhur me shkronjën (b): Sipas ligjit 10304/2010, neni 4 "<i>Parimet e veprimtarisë minerare</i>" është parashikuar që vendimmarrja në aktivitetin minerar është bërë në mënyrë transparente dhe ky proces paraprihet nga konsultimet me komunitetin lokal dhe mendimin me shkrim të njësisë përkatëse të vetqeverisjes vendore.

f) Qeveria duhet të sigurojë që ekziston një mjedis i përshtatshëm për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në lidhje me ligjet, rregulloret dhe rregullat administrative, si dhe praktikën aktuale në zbatimin e EITI. Të drejtat themelore të shoqërisë civile të angazhuar në mënyrë thelbësore në EITI, duke përfshirë por jo kufizuar në anëtarët e grupit me shumë palësh, duhet të respektohen. g) Qeveria duhet të sigurojë se nuk ka pengesa për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në procesin EITI. Qeveria duhet të kufizojë veprimet të cilat rezultojnë të limitojnë ose kufizojnë debatin publik në lidhje me zbatimin e EITI. h) Palët e interesuara, duke përfshirë por jo kufizuar në anëtarët e grupit shumë palësh duhet të: i. jenë në gjendje të flasin				Konsiderojmë se konsultimi me komunitetet lokale gjatë vendimmarrjes në veprimtarinë minerare, përfshirë vendimet që kanë të bëjnë me zbatimin e standardeve të EITI, përbën një formë të përfshirjes së shoqërisë civile në procesin e miratimit të akteve, rregulloreve etj.
---	--	--	--	---

lirshëm për çështjet e transparencës dhe qeverisjes së burimeve natyrore. ii. jenë të angazhuar kryesisht në hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e procesit EITI, dhe të sigurojnë se ajo kontribuon në debatin publik. iii. kenë të drejtë të komunikojnë dhe të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin. iv. jenë në gjendje të veprojnë lirisht dhe të shprehin opinionet rreth EITI pa kufizim, shtrëngim ose masë ndëshkimore.				
1.4 Grupi shumë-palësh a) Qeveria duhet të angazhohet të punojë me shoqërinë civile dhe kompanitë, dhe të krijojë një grup shumë-palësh për të mbikëqyrur zbatimin e EITI. Në krijimin e grupit shumë-palësh, qeveria duhet: i. Sigurojë se ftesa për të marrë pjesë në grup është i hapur dhe transparent. ii. Të sigurojë që palët e interesuara të jenë të përfaqësuara në mënyrë adekuate. Kjo nuk do të thotë se ata duhet të jenë të përfaqësuara në mënyrë të				

barabartë në numër. Grupi shumë palësh duhet të angazhojë palët e duhura, duke përfshirë por pa u kufizuar domosdoshmërisht në: sektorin privat; shoqërinë civile, përfshirë grupet e pavarura të shoqërisë civile dhe shoqërisë civile të tjera të tilla si media dhe sindikatat; dhe subjektet përkatëse qeveritare të cilat mund të përfshijnë parlamentarë. Secili grup shumë-palësh duhet të ketë të drejtë të caktojë përfaqësuesit e vet, duke pasur parasysh dëshirën e një përfaqësimi pluralist dhe të ndryshme. Procesi i nominimit duhet të jetë i pavarur dhe i lirë nga çdo sugjerim i detyruar. Grupet e shoqërisë civile të përfshira në EITI, si anëtarë të grupit shumë palësh duhet të jenë operacionale, si dhe në aspektin e politikave, të pavarura nga qeveria dhe / ose kompanitë. iii. Konsiderojë krijimin e bazës ligjore të grupit. c) Grupi shumë palësh duhet të				
--	--	--	--	--

dakordësojë Terma Reference (ToR) të qarta e publike për punën e tij. ToR duhet, minimalisht të përmbajné dispozita për: Rolin, përgjegjësitë dhe të drejtat e grupit shumë palësh: i. Anëtarët e grupit shumë palësh duhet të kenë kapacitet për të kryer detyrat e tyre. ii. Grupi shumë palësh duhet të ndërmarrë aktivitete efektive në terren me grupet e shoqërisë civile dhe kompanive, përfshirë komunikime nëpërmjet medias, faqes zyrtare dhe letrave, për të informuar aktorët e qeverisë të angazhuar për të zbatuar EITI, dhe rolin qendror të kompanive dhe shoqërisë civile. Grupi shumë palësh duhet të shpërndajë gjerësisht informacionin publik që rezulton nga procesi i EITI, si Raporti i EITI. iii. Anëtarët e grupit shumë palësh duhet të ndërlidhen me pjesëmarrësit e tyre. Miratimi i planeve të punës, raporteve EITI dhe raportet vjetore të progresit: iv. Grupi shumë palësh është i detyruar të miratojë planet vjetore të punës, emërojë Administratorin				
--	--	--	--	--

e Pavarur, Termat e Referencës për Administratorit të Pavarur, Raportet EITI dhe raportet vjetore të progresit. v. Grupi shumë palësh duhet të mbikëqyrë procesin e raportimit EITI dhe të angazhohet në procesin e vleftësim. Rregullat dhe procedurat e brendshme të qeverisjes: vi. EITI kërkon një proces gjithëpërfshirës vendim-marrës gjatë zbatimit, me cdo pjesëmarrës, duke u trajtuar si një partner. Çdo anëtar i grupit shumë palësh ka të drejtë të shtrojë një çështje për diskutim. Grupi shumë palësh duhet të dakordësojë dhe të publikojë procedurat për emërimin dhe ndryshimin e përfaqësuesve të grupeve shumëpalëshe, vendim-marrjen, kohëzgjatjen e mandatit dhe frekuencat e takimeve. Kjo përfshin dhe garantimin e një procesi për ndryshimin e anëtarëve të grupit në përputhje me parimet e përcaktuara në Kërkesa 1.4.a. në rastin kur grupi shumë palësh ndjek një praktikë dietash për të marrë pjesë në mbledhjet EITI ose në lidhje me pagesa të tjera për anëtarët e grupit shumë-palësh, kjo				
--	--	--	--	--

praktikë duhet të jetë transparente dhe nuk duhet të krijojë konflikte interesi. vii. Duhet të jepet një njoftim paraprak në kohët e mjaftueshme për mbajtjen e takimeve dhe qarkullimin në kohë të dokumenteve përpara diskutimeve të tyre dhe miratimit të propozuar. viii. Grupi shumë palësh duhet të mbajë shënime me shkrim të diskutimeve dhe vendimeve të saj.				
1.5 Plani i Punës Grupi shumë palësh duhet të mbajë një plan aktual pune, për të përlllogaritur plotësisht dhe në përputhje me raportimin dhe Vleftësimin e afateve të përcaktuara nga Bordi EITI. Plani i punës duhet: a) të vendosë objektiva të zbatimit EITI të cilat janë të lidhura me Parimet EITI dhe të reflektojnë prioritetet kombëtare për industrinë nxjerrëse. Grupet shumë-palëshe inkurajohen për të shqyrtuar qasjet inovative për të zgjeruar zbatimin e EITI për të rritur tërësinë e raportimin EITI dhe të kuptuarit publik të të ardhurave dhe të inkurajojnë standarde të larta të transparencës dhe llogaridhënies				

në jetën publike, funksionimin e shtetit dhe në biznes. b) Reflektojë rezultatet e konsultimeve me aktorët kryesorë, të cilat miratohen nga grupi shumë palësh. c) Të përfshijë aktivitete të matshme dhe me afate kohore të caktuara për të arritur objektivat e miratuara. Fusha e zbatimit të EITI duhet të përshtatet në mënyrë që të kontribuojë në arritjen e objektivave të dëshiruara të cilat identifikohen gjatë procesit të konsultimit. Plani i punës duhet të: i. drejtojë dhe të përshkruajë planet për të adresuar çdo kufizim të mundshme të kapaciteteve në agjencitë qeveritare, kompanitë dhe shoqërinë civile që mund të jetë një pengesë për zbatimin efektiv të EITI. ii. Adresojë fushën e raportimit EITI, duke përfshirë edhe planet për adresimin e aspekteve teknike të raportimit, të tilla si gjithëpërfshirja (4.1) dhe besueshmëria e të dhënave (4.9). iii. Të identifikojë dhe përshkruajë planet për të adresuar pengesat e mundshme ligjore ose rregullatore për zbatimin e EITI, duke përfshirë, nëse është e zbatueshme, çdo plan për të				
--	--	--	--	--

integruar Kërkesat EITI brenda legjislacionit ose rregulloreve kombëtare. iv. Të përshkruajë planet e grupit shumë-palësh për zbatimin e rekomandimeve nga Vleftësimi dhe raportimi EITI. d) të identifikojë burimet e brendshme dhe të jashtme të financimit dhe asistencës teknike kur është e nevojshme për të siguruar zbatimin në kohë të planit të miratuar të punës. e) Të jetë gjerësisht i disponueshëm për publikun, për shembull, të publikohet në faqen zyrtare kombëtare të internetit të EITI dhe / ose faqe zyrtare të ministrive dhe agjensive të tjera përkatëse, në mediat e shkruara apo në vende që janë lehtësisht të arritshme për publikun. f) Të rishikohet dhe përditësohet çdo vit. Në rishikimin e planit të punës, grupi shumë- palësh duhet të konsiderojë zgjerimin e detajeve dhe qëllimin e raportimit EITI, duke përfshirë adresimin e çështjeve si menaxhimi i të ardhurave dhe shpenzimeve (5.3), pagesat e transportit (4.4), shpenzimeve diskrecionale sociale (6.1.b),				
---	--	--	--	--

transfertat e përkohshme kombëtare (5.2.b), pronësinë përfituese (2.5) dhe kontratat (2.4). Në përputhje me kërkesat 1.4.b (viii), grupi shumë-palësh duhet të dokumentojë diskutimet dhe vendimet e saj. g) të përfshijë një afat kohor të caktuar për zbatim që pëputhet me raportimin dhe afatet e Vleftësimit të përcaktuara nga Bordi EITI (8.1-8.4) dhe që merr parasysh kërkesat administrative të tilla si proceset e prokurimit dhe financimit.				
Kërkesa EITI 2: Kuadri ligjor dhe institucional, përfshirë alokimin e kontratave dhe licencave				
2.1 Kuadri ligjor dhe regjimi fiskal (a) Vendet zbatuese duhet të deklarojnë një përshkrim të kuadrit ligjor dhe të regjimit fiskal që rregullon industrinë nxjerrëse. Ky informacion duhet të përmbajë një përshkrim përmbledhës të regjimit fiskal, përfshirë nivelin e decentralizimit fiskal, një pasqyrë të ligjeve dhe rregulloreve përkatëse, si dhe informacion mbi rolet dhe përgjegjësitë e agjencive qeveritare përkatëse. (b) Kur qeveria ndërmerr reforma, grupi shumë-palësh inkurajohet të garantojë që ato janë të dokumentuara.	0.1 A40	Ligji nr. 10304 datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar Ligji nr. 9975, datë 2008/07/28 "Për taksat kombëtare", Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për taksat vendore", Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar . Një nga detyrimet fiskale të përcaktuara në ligjin në 10304, datë 17.05.2010, është taksë e rentës minerare. Në bazë të nenit	P	Komente: Kuadri ligjor i lidhur ngushtë me fushën e përgjegjësisë së çdo ministrie (strukturat vartëse) është publikuar në faqet e tyre zyrtare. Kuadri ligjor, nënligjor dhe kuadri rregullator në lidhje me industrinë nxjerrëse është publikuar në faqen e internetit të ministrisë përgjegjëse për aktivitetin minerar www.energija.gov.al dhe kuadri ligjor fiskal është publikuar në ministrinë përgjegjëse për financat dhe në faqen e internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Nuk ka asnjë publikim/deklarim të asnjë përshkrimi në lidhje me kuadrin ligjor, regjimi fiskal duke përfshirë informacione

		40 të ligjit 10304 datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, taksa e rentës minerare përbëjnë detyrim të zotëruesve të lejeve minerare, të llogaritura si një përqindje e vlerës së shitjes së mineraleve të papërpunuara të prodhuara dhe alokohen në buxhetin e shtetit dhe në buxhetin e njërive përkatëse të qeverisjes vendore. Në bazë të ligjit 9975, date 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", janë përcaktuar kriteret kryesore që lidhen me llogaritjen e rentës minerale (përqindja, afati i pagesës etj). Sipas nenit 4, paragrafi 4 i ligjit 9975, datë 28.07.2008, 5% e taksës së rentës minerare i alokohen autoriteteve lokale. Në këtë drejtim, 95% e taksës së rentës minerale alokohen në buxhetin kombëtar dhe 5% në buxhetin e autoriteteve lokale. Në bazë të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Për taksat vendore", autoritetet lokale kanë të drejtë të vendosin taksa vendore ashtu siç është përcaktuar në nenin 9 të këtij ligji, si tatimi mbi pasurinë e paluajtshme, taksën e tabelës së reklamave, taksën e pastrimit etj.		mbi përgjegjësitë dhe interferencat mes agjencive shtetërore në industrinë nxjerrëse. Rekomandim: Ne rekomandojmë që Sekretariati EITI të përgatisë një format standard për të përfshirë informacionin duke e përditësuar me ndryshimet e mundshme që lidhen me kuadrin ligjor dhe regjimin fiskal, përfshirë dhe sektorin e hidrokarbureve. Ky format nuk ka nevojë të miratohet në një akt ligjor dhe nënligjor, thjesht nevojitet të publikohet në faqen zyrtare të EITI.
	0.28 A 4 P 4			
	0.29 A 9			

		Mbajtësi i lejes minerare paguan dhe taksa të tjera, si dhe kompani të tjera e tjera që kryejë veprimtari në sektorë të ndryshëm, si tatimi mbi fitimin, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, taksat vendore etj.		
2.2 Alokimet e licencës a) Vendet zbatuese duhet të deklarojnë informacionin e mëposhtëm lidhur me dhënien ose transferimin e licencave që kanë të bëjnë me kompanitë e përfshira në Raportin EITI gjatë periudhës fiskale të mbuluar nga Raporti EITI: i. një përshkrim të procesit për transferimin ose dhënien e licencës; ii. kriteret teknike dhe financiare të përdorura; iii. informacion në lidhje me marrësin (t) e licencës që është transferuar ose dhënë, duke përfshirë anëtarët e konsorciumit, nëse aplikohet; dhe iv. çfarëdo shmangie jo-e parëndësishme nga dispozitat e zbatueshme të kuadrit ligjor dhe rregullator që udhëheqin transfertat e licencave dhe shpërblimet. Është e nevojshme që informacioni i paraqitur më sipër të publikohet për të gjitha shpërblimet dhe transfertat e	0.1 0.30 0.31 0.2 0.5 0.9	1. Ligji Nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar Ligji 125/2015 "Për koncensionet dhe partneritetin publik privat", i ndryshuar; Ligji nr.10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë"; VKM nr.320, datë 21.04.2011 "Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese". VKM Nr.942, datë 17.11.2010 "Për miratimin e procedurave dhe të dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura", I ndryshuar; VKM nr.362, datë 29.04.2011 "Për miratimin e kriterëve dhe rregullave të transferimit, mënyrës	P	Komente: Bazuar në kuadrin ligjor për industrinë minerare, është vlerësuar se kërkesat thelbësore të këtij standardi janë plotësuar pjesërisht. 1. Lejet minerare për zonat e hapura të cilat janë dhënë në bazë të parimit "i pari në kohë, i pari në të drejta", janë dhënë në bazë të kriterëve teknike, ligjore dhe financiare të përcaktuara në Vendimin nr 942, datë 17.11.2010. Duke marrë parasysh specifikën e procedurës së ndjekur për dhënien e këtyre lejeve minerare, Ministria nuk ndjek me procedurë paraprake që të vendosë kushtet që duhet të plotësohen nga aplikuesi për zonën minerare. Aplikanti duhet të plotësojë kriteret dhe të ndjekë procedurën e përcaktuar në Vendimin nr 942. Në këtë kuptim, nuk ka publikim të të dhënave përse i përket kriterëve teknike dhe financiare me lidhje me procesin e dhënies së lejes. Megjithatë, aplikuesi dorëzon aplikimin e tij në sportelet e QKL dhe aplikimin për të marrë një licencë për të hapur fusha, të

dëshirojë që të përfshijë informacion shtesë në alokimin e licencave në Raportin EITI, duke përfshirë shpjegime mbi efikasitetin dhe efektivitetin e procedurave të licencimit.	A41	lejohe bazuar nëkëto kushte: Lejet minerare, të dhëna sipas procedurave konkurruese, dhe ato, për të cilat është përfunduar një marrëveshje lehtësuese, nuk janë të transferueshme. 2. Lejet minerare, për të cilat veprimtaria minerare, sipas përcaktimeve të këtij ligji, nuk ka filluar, janë të patransferueshme. 3. Lejet e tjera minerare, të dhëna sipas procedurave të këtij ligji, janë të transferueshme vetëm pas miratimit paraprak nga ministri. Çdo transferim i kryer pa miratimin paraprak është i pavlefshëm.	Megjithatë duke pasur parasysh faktin se disa nga kontratat koncesionare më të rëndësishme (të lidhura në periudhën e hershme), janë miratuar nga Parlamenti (në bazë të kërkesave ligjore në fuqi në këto periudhë), dhe rezulton se shumica e tyre janë publikuar tashmë. Në këtë drejtim, rezulton se është botuar një nga kontratat më të rëndësishme e cila u miratua nga Ligji no.8791, datë 2001/10/05 "Për miratimin e" formës së marrëveshja se koncesionit" "ROT", Fabrika e pasurimit me krom në Bulqize etj. Pas kontratës së koncesionit kontraktori duhet të jetë i pajisur me lejen minerare. Të dhënat lidhur me mbajtësin e lejes minerare dhe lejes do të regjistrohet në Regjistrin Kombëtar të licencave autorizimeve dhe lejeve, dhe publikohen në QKL www.qkl.gov.al/Registries.aspx. 3. Lejet minerare jepen në bazë të procedurave konkurruese, procedurat e ndjekura, afatet dhe kushtet që duhet të plotësohen nga aplikuesi, janë dhënë në ligjin nr 10304 dhe VKM. 320, datë 21.04.2011. Ministria përgjegjëse, Autoriteti Kontraktues, njoftojnë në fillim të vitit të gjitha zonat e planifikuara të minierave të planifikuara për të kaluar procedurën konkurruese. Këto zona minerare janë të publikuara në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse
	0.1 A30	Kriteret dhe rregullat për transferimin miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 320, datë 21.04.2011.	
	0.1 A41	Sipas dispozitës së nenit 30 të ligjit 10304, vendimi përfundimtar për miratimin e lejeve për kerkim dhe/ose shfrytezim hyn në fuqi pas publikimit në Regjistrin Kombëtar për Licencat dhe Lejet http://www.qkl.gov.al/Registries.aspx. (përveç lejeve të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe / ose me ligj të Kuvendit).	

	0.2 A7.2 A7.3 A7.4 Sipas nenit 41, transferimi i lejeve minerare, duhet të regjistrohet edhe në Regjistrin Kombëtar për licencat dhe Lejet http://www.qkl.gov.al/Registries.aspx. 7.1 Sipas VKM 320, datë 21.04.2011, nenet 7.2, 7.3 and 7.4, autoriteti kontraktues ka detyrimin të përgatisë dhe të mbajë regjistrin e konkurrimit publik, i cili përmban, të paktën: a) emërtimin e autoritetit kontraktues; b) adresën e autoritetit kontraktues; c) objektin e konkurrimit të paraqitur në hartë me shkallë 1:2500, sipas koordinatave shtetërore në planin horizontal dhe të dhënave gjeologo-minerare për objektin në konkurrim; ç) vlerën minimale të investimit që kërkohet të realizohet për objektin në konkurrim; d) emrat e anëtarëve të grupit të hartimit të dokumenteve të konkurrimit publik; dh) emrat e anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave; e) emrat dhe adresat e ofertuesve; ë) një përmbledhje të vlerësimit dhe të krahasimit të ofertave; f) një përmbledhje të të gjitha	http://www.energija.gov.al/al/sherbime/lejet-per-koncesionet-EEB Bazuar në zonat e planifikuara të minierave, autoriteti kontraktues vazhdon me hapjen e procedurës konkurruese për secilën nga zonat e minierave. Në këtë drejtim, autoriteti kontraktues do të publikojë në faqen zyrtare të institucionit (http://www.energija.gov.al/al/sherbime/lejet-per-koncesionet) ofertën për tender për një zonë specifike minerare. Oferta për tender do të publikohet në Buletinin Publik të menaxhuar nga Agjencia e Prokurimit Publik. Oferta për tender përmban të dhëna për dokumentet e tenderit, duke përfshirë informacion mbi procedurën që duhet ndjekur për dhënien e lejeve, kriteret e përdorura, kushtet që duhen plotësuar nga aplikantët, të dhënave teknike të zonave minerare (koordinatat, etj). Pas paraqitjes dhe shqyrtimit të ofertave, komisioni përzgjedh ofertën fituese. Informacioni në lidhje me aplikantit fitues është pasqyruar në njoftimin fitues publikohet në Buletinin Publik menaxhuar nga APP, http://www.app.gov.al Detajet në lidhje me aplikantët që kanë marrë pjesë në procedurën konkurruese, kushtet dhe kriteret e përdorura për përzgjedhjen e fituesit etj janë të përfshira në regjistrin e konkursit publik, i cili duhet të administrohet për një periudhë 1 vjeçare. Ky regjistër nuk është publikuar në faqen zyrtare, por është kusht që duhet ti
--	--	--

		kërkesave për sqarim për dokumentet e garës dhe përgjigjen e tyre; g) një përmbledhje të ankesave të bëra dhe për zgjidhjen e tyre. Përmbajtja e regjistrit të konkurrimit publik për zonat konkurruese minerare apo pjesë e tij i vihet në dispozicion çdo personi të interesuar me kërkesë të tij, në përputhje me ligjin 119/2014 "Për të drejtën e informimit".	dorëzohet çdo palë të interesuar me kërkesën e tyre paraprake në përputhje me kërkesat e pikës 7.4 të VKM. 320, datë 21.04.2011. Transferimi i lejeve të minierave bëhet në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në Vendimin 362, datë 29.04.2011. Subjektet të cilëve lejet të minierave janë transferuar duhet të plotësojnë të gjitha kushtet e specifikuar në paragrafin 3 dhe 4 të Vendimit 362, datë 29.04.2011. Detajet e subjektit të cilit i është transferuar leja minerare duhet të jenë të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të licencave / autorizimeve dhe lejeve, të publikuar në QKL www.qkl.gov.al/Registries.aspx Procedura e ndjekur në lidhje me transferimin e lejes të minierave (procesi i vlerësimit të përmbushjes së kushteve të përcaktuara në VKM 362, datë 29.04.2011), nuk publikohet. Megjithatë, ne konsiderojmë se kërkesat e këtij standardi janë përmbushur në përgjithësi për shkak se: - Procedurat e transferimit, kriteret që duhet të përmbushen nga aplikuesi për transferimin, janë përcaktuar në mënyrë të qartë në Vendimin 362, datë 29.04.2011, i cili është publikuar në fletoren zyrtare dhe faqen zyrtare të ministrisë http://www.energija.gov.al. - Çdo palë e interesuar ka të drejtë të
--	--	---	---

				kërkojë informacion mbi procesin e transferimit të lejes të minierave të veçantë, në përputhje me dispozitat e Ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit". - Detajet përkatëse në lidhje me kompaninë, që i është transferuar licenca, përfshirë miratimin e transferimit nga ministria përgjegjëse, pasqyrohet në Regjistrin Kombëtar të licencave / autorizimeve dhe lejeve, e cila është botuar. Rekomandime: 1. Regjistri i konkursit publik, i përgatitur dhe administruar në përputhje me paragrafin 7.2, 7.3 dhe 7.4 të Vendimit 320, datë 21.04.2011, duhet të ruhet dhe administrohet për një periudhë më të gjatë kohore (për të njëjtën periudhë me dokumentet e ruajtura nga aplikantët) dhe duhet të publikohet në faqen zyrtare të ministrisë, pas përfundimit të procedurës konkurruese dhe dhënien e lejes. Prandaj ne propozojmë që të rishikohen pikat 7.2, dhe 7.4 të Vendimit 320, datë 21.04.2011. 2. Për lejet minerare të dhëna sipas parimit "I pari në kohë, i pari në të drejtë", ministria përgjegjëse duhet të përgatisë një raport përmbledhës i cili përmban informacion për subjektin që ka aplikuar dhe procedurën e ndjekur etj Ky raport duhet të publikohet nga ministrisë në faqen zyrtare. Për këtë qëllim disa ndryshime janë të nevojshme në Vendimin 942, datë 17.11.2010, që të përfshijnë detyrimin e ministrisë përgjegjëse për të hartuar dhe
--	--	--	--	---

				publikuar në faqen zyrtare regjistrin me procedurat e ndjekura për "zonat e hapura". 3. Për lejet minerare të dhëna në bazë të një kontrate koncesioni, duhet të përfshihen disa dispozita ligjore lidhur me detyrimin për botimin e këtyre kontratave.
2.3 Regjistri i Licencave a) Termi licence, në këtë kontekst i referohet çdo licence, qiraje, titulli, leje, kontratë apo koncesioni të cilën qeveria ja jep një kompanie/ve ose të drejtave individit/ëve për të kërkuar ose shfrytëzuar naftën, gazin dhe/ose burimet minerare. b) Vendet zbatuese duhet të mbajnë një regjister në dispozicion të publikut ose të sistemit kadastral me informacionin e duhur dhe të plotë si në vijim në lidhje me secilin nga licencat kanë të bëjnë me kompanitë e përfshira në Raportin EITI: i. Mbajtësin/t e licencës. ii. në rastin kur mbledhen, koordinatat e zonës së licencës. Ku koordinatat nuk janë mbledhur, qeveria duhet të sigurohet që madhësia dhe vendndodhja e zonës së licencës të jetë publikuar në regjistrin e licencës dhe se koordinatat janë vënë në dispozicion të publikut	0.1 0.31 0.19 0.1 A2 P33 A44	1. Ligji Nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar Ligji nr.10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë"; Urdhër nr.384, datë 20.05.2011, ""Për miratimin e procedurave të regjistrimit dhe dokumentacionit që regjistrohet në kadastrën minerare dhe në regjistrin minerar si dhe forma dhe procedurat e raportimit të këtij dokumentacioni nga ana e zotëruesve të lejeve minerare"; Strukturat përgjegjëse duhet të administrojnë regjistrin minerar, i cili përfshin të gjitha të dhënat për regjimin juridik të sipërfaqeve të zonave minerare dhe të sipërfaqeve fqinje, pronësinë, situatën topografike të zonave minerare e të punimeve mbështetëse të veprimtarisë minerare, për rezervat dhe për	P	Komente: Ministria përgjegjëse publikon një informacion të përgjithshëm lidhur me licencat e dhëna të cilat përfshijnë të dhëna mbi numrin e referencës së lejes, të dhëna të mbajtësit të lejes, datën e miratimit të lejes, natyrën e mineralit, shtrirjen e zonës, adresën e zonës dhe llojin e lejes (kërkim / shfrytëzim ose të kombinuar) Ky informacion paraqitet në një tabelë/regjister dhe botohet në linkun:http://www.energija.gov.al/files/userfiles/minierat2/2016/RREGJL_LEJEVE_SHKURT_2016_Aktive.pdf. Ky informacion i publikuar nga Ministria nuk përmban informacion në lidhje me koordinatat e zonës së licencës, datën e aplikimit, kohëzgjatjen e licencës dhe produktin që do të prodhohet (në leje shfrytëzimi). Ndërkohë të dhënat kryesore në Regjistrin Minierar, të administruara nga QKL publikohet për publikun. QKL publikon Regjistrin Kombëtar për licencat dhe Lejet http://www.qkl.gov.al/Registries.aspx ku përfshihen të dhëna për lejet minerare,

nga agjencia përkatëse qeveritare, pa tarifat dhe kufizime të paarsyeshme. Raporti EITI duhet të përfshijë udhëzime se si të aksekohen koordinatat dhe shpenzimet, nëse ekzistojnë, aksesimi i të dhënave. Raporti EITI duhet të dokumentojë planet dhe afatet kohore për vendosur këtë informacion në dispozicion lirisht dhe në mënyrë elektronike përmes regjistrit licencës. iii. Datën e aplikimit, datën e dhënies dhe kohëzgjatja e licencës. iv. Në rastin e licencave të prodhimit, produktin që prodhohet. Pritet që regjistri i licencave apo kadastra të përfshijë informacion në lidhje me licencat e mbajtura nga të gjitha subjektet, duke përfshirë kompanitë dhe individët apo grupet që nuk janë të përfshira në raportin EITI, dmth ku pagesat e tyre bien nën pragun e materialitetit të rënë dakord. Çdo pengesë e rëndësishme ligjore ose praktike që pengojnë një publikim gjithëpërfshirës duhet të dokumentohet dhe shpjegohet në raportin EITI, duke përfshirë një vlerësim të planeve të qeverisë për të kapërcyer këto pengesa dhe afatet kohore të parashikuar për arritjen e tyre.	0.19	prodhimin mineral, si dhe të dhënat për zotëruesin e lejeve minerare. Të dhënat e detajuara e dokumentet përkatëse, që regjistrohen në kadastrën minerare e në regjistrin mineral, procedurat e raportimit nga zotëruesi i lejes minerare dhe rregullat për mbajtjen e regjistrimit e të dhënave përcaktohen me urdhrin e ministrit nr. 384, datë 20.05.2011 . Të dhënat të cilat do të përfshihen në Regjistrin Minierar, në përputhje me dispozitat e Urdhrit nr. 384, datë 20.05.2011 janë shumë të detajuara dhe të kategorizohen si më poshtë: 1. të dhëna për regjimin juridik të sipërfaqeve të zonave minerare dhe të sipërfaqeve fqinje. 2. të dhëna për pronësinë e tokës të sipërfaqeve të zonave minerare dhe të sipërfaqeve fqinje. 3. të dhëna për situatën topografike të zonave minerare etj. 4. të dhëna për rezerva dhe për prodhimin mineral sipas projektit të zhvillimit të	koordinata, hartat, numrin e referencës së lejes, emrin e mbajtësit të lejes, datën e miratimit të lejes, statusin e lejes etj. Rekomandim: 1. Të dhënat e publikuara nga Ministria, duhet të zgjerohen, duke përfshirë të dhëna që kanë në lidhje me mineralin e prodhuar nga mbajtësi i lejes. Në bazë të VKM nr. 232, datë 23.03.2011 "Për miratimin e funksioneve të strukturave përgjegjëse në sektorin mineral të Republikës së Shqipërisë", pika 2, shkronja h dhe i, AKBN, e cila është një strukturë në varësi të Ministrisë, është përgjegjëse për të përgatitur një raport tremujor, që përfshin të dhëna që lidhen me prodhimin, investimin etj. Ky informacion i jepet Ministrisë. Në këtë drejtim Ministria, në mënyrë periodike (të paktën çdo vit), duhet të azhurnojë regjistrin e lejes minerare, duke përfshirë të dhënat që kanë të bëjnë me prodhimin.
--	-------------	---	--

c) Kur informacioni i përcaktuar në 2.3.b është vënë në dispozicion të publikut, mjafton që të përfshihet referenca ose linku në Raportin EITI. Nëse këto regjistra apo kadastra nuk ekzistojnë ose nuk janë të plota, Raporti EITI duhet të publikojë cdo mangësi në informacionin që vihet në dispozicion të publikut dhe të dokumentojë përpjekjet për të forcuar këto sisteme. Ndërkohë, vetë Raporti EITI duhet të përfshijë informacionin e përcaktuar në 2.3.b më sipër.		veprimtarisë minerare etj. 5. Të dhëna për zotëruesin e lejeve minerare etj. 6. Të dhëna për kundravajtjet administrative të mbajtësit, statusin e lejes minerare, pezullimi dhe revokimi i lejes. Bazuar në pikën 8 të Urdhrit të Ministrit, Regjistri Minierar mbahet nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), në kuadrin e Regjistrit të Licencave, autorizimet dhe lejeve, krijuar dhe administruar sipas dispozitave të nenit 14 të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 "për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", Strukturat përgjegjëse të cilat janë të përfshira në procesin e verifikimit dhe miratimit të lejes minerare, kanë të drejtë të kenë akses në këto të dhëna gjatë punës së tyre. Të dhënat kryesore të rëndësishme të përfshira në lejen minerare janë të arritshme nga publiku, sepse publikohen në sistemin e QKL.		
2.4 Kontratat a) Vendet zbatuese inkurajohen të bëjnë publike të gjitha kontratat dhe licencat që ofrojnë kushtet	0.1 0.30 0.31	1.Ligji Nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minierar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar		Komente: lejet minerare janë publikau për publikun, përveç të dhënave në lidhje projektet, të cilat konsiderohen si konfidenciale.

që lidhen me shfrytëzimin e naftës, gazit dhe mineraleve.	0.32	Ligji 125/2015 “Për koncensionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar;	Kontrata, e lidhur në nenin 16 të Ligjit 10304, miratohet nga Parlamenti. Në këtë drejtim, bazuar në dispozitat e legjislacionit të brendshëm, ligji do të miratojë kontratën dhe kontrata duhet të botohet në fletore Zyrtare
b) Është një kërkesë që Raporti EITI të dokumentojë politikën e qeverisë për dhënien e kontratave dhe licencave që udhëheqin kërkimin dhe shfrytëzimin e naftës, gazit dhe mineraleve. Kjo duhet të përfshijë dispozitat përkatëse ligjore, praktikat aktuale për dhënien e informacionit dhe çdo reformë të planifikuar apo që është në zbatim. Nëse aplikohet, Raporti EITI duhet të ofrojë një pasqyrë të kontratave dhe licencave që janë vënë në dispozicion të publikut, dhe të përfshijnë një referencë ose link në vendin ku këto janë botuar.	0.33 0.1 A 5	Ligji nr.10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë"; Ligji 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” Ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit”; Sipas interpretimit të gjerë të nenit 5 të ligjit no.10304 "Për sektorin minierar në Republikën e Shqipërisë", lejet minerare rrjedh nga këto procedura kryesore:	http //www.qbz.gov.al/ , me përjashtim të dispozitës që trajtohet si konfidencial nga palët, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
c) Termi kontratë në 2.4 (a) nënkupton:	0.1 A 5 P 3	1. Lejet e dhëna në bazë të procedurës konkurruese, ose në bazë të parimit "i pari në kohë i pari në të drejta". Titulli për realizimin e të drejtave minerare, përfaqësohet nga Lejet Minerare të dhëna në bazë të procedurës konkurruese, ose në bazë të procedurës për zonat e hapura (parimi i parë në kohë, i pari në të drejta).	Kushtet kryesore të kontratës së koncesionit nga e cila dalin lejet minerare duhet të pasqyrohet në regjistrin e koncesioneve të administruara nga Agjencia e Koncesioneve. Kushtet e lidhura me përgatitjen dhe administrimin e këtij regjistri duhet të miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave. Në informacionin tonë, ky regjistër nuk është krijuar akoma.
i. Tekstin e plotë të çdo kontrate, koncesioni, marrëveshje prodhim-shpërndarje ose marrëveshje tjetër të dhënë ose të lidhur nga qeveria e cila siguron kushtet në lidhje me shfrytëzimin e gazit të naftës dhe burimeve minerale.	P 4 P 5		Megjithatë, në bazë të ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ministria detyrohet të vendosë kontratën dhe lejet në dispozicion të çdo pale të interesuar me kërkesë të tyre paraprake, duke përjashtuar informacionin konfidencial. Kjo bazë ligjore, në fakt është shumë e interpretuese, dhe në raste të ndryshme, autoritetet publike mund të interpretojnë ngushtë këtë dispozitë për të shmangur këtë detyrim.
ii. Teksti i plotë i çdo aneksi, shtojcë ose konkluzioni i cili përcakton detajet përkatëse për të drejtat e shfrytëzimit të përshkruara në		Me kërkesë të subjektit kërkues apo të zotëruesit të lejes së shfrytëzimit, për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, dhe nëse paraqitet një plan investimesh,	Rekomandim Publikimi i lejeve dhe kontratatave dhe

2.4 (c) (i) ose zbatimin e tij. iii. Teksti i plotë i çdo ndryshimi ose përmirësimi në dokumentet e përshkruara në 2.4 (c) (i) dhe 2.4 (c) (ii). d) Termi Licencë në 2.4 (a) nënkupton: i. Tekstin e plotë të çdo licencë, qiraje, titulli apo leje me të cilat qeveria i jep të drejta kompanisë(ve) ose individëve(t) për të shfrytëzuar naftën, gazin dhe/ose burimet minerare. ii. Teksti i plotë i çdo aneksi, shtojce ose konkluzioni i cili përcakton detajet përkatëse për të drejtat e shfrytëzimit të përshkruara në 2.4 (d) (i) ose zbatimin e tij. iii. Teksti i plotë i çdo ndryshimi ose përmirësimi në dokumentet e përshkruara në 2.4 (d) (i) dhe 2.4 (d) (ii).	0.1 A 51 P 2 P 4 0.30 A 18 0.33	zbatimi i të cilit vlerësohet në interesin ekonomik apo shoqëror për komunitetin e zonës përkatëse, leja mund të jepet apo, përkatësisht, të zgjatet për një periudhë vlefshmërie deri në 99 vjet. Në këto raste, ministri mund të negociojë një kontratë me kushte lehtësuese me kërkuesin apo zotëruesin e lejes minerare. Kontrata dhe shtyrja e afatit paraqiten për miratim në Kuvend. Kontrata dhe leja, përfaqëson titujt bazuar në të cilën ushtrohen të drejtat minerare. 2. Disa të drejta minerare, leje, janë dhënë në bazë të kuadritligjore koncesionar, i cili i referohet një procedure konkurruese. Në këtë drejtim lejet lëshohen në bazë të titullit, i cili përfaqësohet nga kontra e koncesionit e lidhur ndërmjet autoritetit përgjegjës shtetëror dhe investitorit (kjo mënyrë e dhënies së lejes nuk është e zakonshme në praktikë). Struktura përgjegjëse dhe autoritetet e tjera shtetërore, që kryejnë funksione shtetërore në fushën minerare, në zbatim të këtij ligji apo të legjislationit minerar në fuqi, janë të detyruara		çdo lloj dokumenti i lidhur me to, anekset, shtojcat e veçanta në industrinë e minierave dhe në përgjithësi në industrinë nxjerrëse, duhet të analizohet në mënyrë paralele me dispozitat e tjera ligjore të konfidencialitetit dhe duhet të trajtohen paralelisht me çështjet e pronësisë përfituese. Rekomandimi lidhet me adresimin e detyrimit për publikimin e kontratave dhe lejeve në dispozita të veçanta të ligjit. Në çdo rast publikimi i të dhënave që konsiderohen si sekret tregtar, duhet të përjashtohen nga detyrimi i publikimit.
---	---	--	--	---

	A 14 0.33 A 15	të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave, të marra nga zotëruesi i lejes minerare apo të të dhënave, për të cilat kanë marrë dijeni gjatë ushtrimit të funksionit të tyre e që përbëjnë sekret tregtar, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Shkelja e këtij detyrimi ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi. Të dhënat teknike dhe provat studimore, që zotëruesi i lejes minerare i dorëzon në strukturën përgjegjëse, janë konfidenciale. Ndërkohë të dhëna të tjera, si akte miratimi, të dhëna për zonën minerare, koordinatat, mbajtësit e minierave, miratimi i akteve etj janë publikuar në Regjistrin Minierar të administruar nga QKL. Në bazë të nenit 18 të ligjit 9901/200 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare ndryshuar, sekreti tregtar është një dhënë e vlerësuar nga shoqëria si informacion i brendshëm, i cili, nëse publikohet me persona të paautorizuar, do të shkaktonte dëm të konsiderueshme të interesave të kompanisë. Në bazë të nenit 14 të Ligjit 125/201 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", i ndryshuar, të dhën lidhura me kontratat koncesionare		
--	-------------------------------------	---	--	--

		janë pasqyruar në regjistrin e koncesioneve të administruara nga agjencia e koncesioneve. Në bazë të Nenit 15 të Ligjit 125/20 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat" parashikohet që dispozitat e ligjit të prokurimit publ në lidhje me konfidencialitetin janë koncesione të zbatueshme ose partneritete publike- private sipas k ligji. Në bazë të nenit 25 të ligjit nr 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar "Fshehtësia e procesit", parashikohet: "Pa cenuar dispozitat e këtij ligji mbi detyrimin për botimin e kontratave të prokuri dhe informacion për kandidatët dhe ofertuesit sipas neneve 21 dhe 57 të këtij ligji, autoriteti kontraktues nuk do të publikojë informacionin e mar nga operatorët ekonomikë, të të etiketuara si konfidenciale. Ky informacion përfshin në vecanti aspekte teknike, sekrete tregtare dh informacione konfidenciale të ofertave.		
2.5 Pronësia përfituese a) Rekomandohet që vendet zbatuese të mbajnë një regjistër në dispozicion të publikut për pronarët përfitues të subjekteve korporata që tenderojnë,	0.1 0.19	1. Ligji Nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar Urdhër nr.384, datë 20.05.2011, "Për miratimin e	P	Komente: Siç kemi përmendur më sipër, të dhënat mbi Regjistrin Minierar, krijuar dhe administruar në bazë të ligjit no.10304 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë "dhe të ligjit nr.10 081, datë

veprojnë ose investojnë në aktive nxjerrëse, duke përfshirë identitetin(tet) e pronarit(ëve) të tyre përfitues, nivelin e pronësisë dhe detajet se si është ushtruar pronësia ose kontrolli. Kur është e mundur, informacioni pronësisë përfituese duhet të përfshihet në dosjet ekzistuese nga kompanitë për rregullatorët e korporatave, bursat apo agjenci që rregullojnë licencimin e industrisë nxjerrëse. Kur ky informacion vihet në dispozicion të publikut, Raporti EITI duhet të përfshijë udhëzime se si aksesohet informacion. b) Nevojitet që: i. Raporti EITI të dokumentojë politikën e qeverisë dhe diskutimin e grupit shumë-palësh në publikimin e pronësisë përfituese. Kjo duhet të përfshijë detaje të dispozitave ligjore përkatëse, praktikat aktuale të publikimit dhe çdo reformë që janë planifikuar ose që zbatohen në lidhje me publikimin e pronësisë përfituese. ii. Nga 1 Janar 2017, grupi shumë-palësh publikon një plan për dhënien e informacioneve shpjeguese të pronësisë përfituese në përputhje me	0.25 0.31 0.34 0.33 0.1 A 44 A 46 0.33	procedurave të regjistrimit dhe dokumentacionit që regjistrohet në kadastrën minerare dhe në regjistrin minerar si dhe forma dhe procedurat e raportimit të këtij dokumentacioni nga ana e zotëruesve të lejeve minerare”; Urdhër Nr.477, datë 27.06.2011 "Për miratimin e formës, përmbajtjes dhe procedurave të hartimit të akteve të miratimit dhe refuzimit për aplikimin për leje minerare”; Ligji nr.10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”; Ligji 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” Ligji 9917 dated 19.05. 2008 “për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”. 1. Në bazë të Ligjit no.10304 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë" (neni 44 dhe 46) dhe Urdhërit nr. 384, datë 20.05.2011 i Ministrit, strukturat përgjegjëse duhet të administrojnë Regjistrin Minierar, i cili përfshin informacion në lidhje lejet minerare, dhe në mënyrë eksplicite të dhëna për mbajtësit e lejeve minerare, duke përfshirë	23.2.2009" Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë ", janë publikuar për shkak se QKL ka publikuar regjistrin e licencave, lejeve dhe autorizimin në faqen e saj. Në këtë kontekst, të dhëna për pronarët përfitues janë të përfshira në përmbajtjen e lejeve (akti i miratimit). Në disa raste, të dhënat për pronarët përfitues nuk i referohen personave fizikë të cilët janë pronarët e vërtetë përfitues, por subjektet juridike që mbajnë lejen minierare. Në të vërtetë, janë evidentuar disa raste, ku të dhënat në lidhje pronarin përfitues janë konfuzuar me të dhënat për përfaqësuesit ligjorë të kompanisë, mbajtësit e lejeve minerare. Regjistri Tregtar dhe ekstrakti i siguruar nga ky Regjistër i krijuar në bazë të dispozitave të ligjit 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, i ndryshuar; dhe Ligji nr. 9723/2007 "Për qendrën kombëtare të regjistrimit", (neni 28, 29 dhe 32), jep të dhëna për themeluesit e çdo kompanie apo tregtarëve individual, por në rastet kur themeluesit e kompanisë janë kompani të tjera, pronari përfitues nuk është publikuar/identifikuar. Në lidhje me ligjin nr.9917, datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", vërejmë dy çështje kryesore:
---	--	---	--

klauzolat (c) - (f) më poshtë. Grupi shumë-palësh do të përcaktojë të gjitha piketat dhe afatet në planin udhëzues, dhe grupi shumë-palësh do të vlerësojë zbatimin e planit udhëzues, si pjesë e raportit vjetor të grupit shumë -palësh të raportit të progresit.	0.34	të dhënat për pronarët dhe aksionet e tyre në kompani.	- Edhe pse ky ligj përmban përkufizimet e "pronësisë përfituese" dhe të "personit të ekspozuar politikisht", të cilat janë përshtatur kryesisht me normat ndërkombëtare (në veçanti, Udhëzuesi FATF), ky ligj përmbledh këto koncepte në lidhje të ngushtë me parandalimin dhe mbikëqyrjen e operacioneve financiare me të cilat është realizuar pastrimi i parave. Kështu dispozitat e këtij ligji mund të rregullojnë çështjet specifike që kanë të bëjnë me pastrimin e parave, që vijnë nga veprimtari të paligjshme. Ndërkohë këto koncepte janë shumë të gjera dhe kanë të bëjnë me identifikimin e pronarit faktik të fundit, edhe në qoftë se aktiviteti i kompanisë është në fakt juridik.
c) Që nga 1 janari 2020, do të kërkohej që vendet zbatuese të kërkojnë, dhe kompanitë publikojnë, informacione të pronësisë përfiruese për tu përfshirë në Raportin EITI. Kjo aplikohet për entitet e korporatave (ve) që tenderojnë, veprojnë ose investojnë në pasurinë nxjerrëse dhe duhet të përfshijnë identitetin (tet) e pronarit (ëve) të tyre përfitues, nivelin e pronësisë dhe detaje se si ushtrohet pronësia ose kontrolli.	A 1	Ligji Nr 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, i ndryshuar; dhe Ligji nr. 9723/2007 "Për qendrën kombëtare të regjistrimit", (neni 28, 29 dhe 32), i ndryshuar, parashikon detyrimin e themeluesve të kompanive (të cilat supozohet të jenë pronarët përfitues), duke përfshirë edhe kompanitë që tenderojnë, veprojnë ose investojnë në industrinë nxjerrëse, për të paraqitur të dhëna për identifikimin e pronarit të tyre përfitues, nivelin e pronësisë dhe të dhëna se si ushtrohet pronësia apo kontrolli.	- Së dyti, kategoritë e bizneseve për të cilat zbatohen dispozitat e këtij ligji, shfaqen në një listë gjithëpërfshirëse (që përfshin p.sh. bankat tregtare, shoqërinë e kursimit dhe kreditit, avokatët, noterët, zyrat e regjistrimit të pronës, etj) dhe kjo mund të krijojë mundësi për kategori të caktuara të subjekteve që veprojnë në industrinë nxjerrëse që të bëjnë përpjekje që të mos jenë subjekt i zbatimit të dispozitave të këtij ligji.
Çdo mangësi apo dobësi në raportimin e informacionit të pronësisë përfituese duhet të publikohet në Raportin EITI, përfshirë emërtimin e çdo entiteti që nuk arriti të paraqesë të gjithë ose pjesë të informacionit të pronësisë	0.34 A 3	Bazuar në ligjin nr.9917, datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", është trajtuar ngushtë konceptin e PP, pronarit përfitues. Në fakt, ligji e trajton shumë ngushtë këtë çështje, por është një pikë e mirë referimi për iniciativa të mëtejshme në këtë drejtim. "Pronar përfitues" është personi	Rekomandim: Ne konsiderojmë se hartimi, miratimi dhe zbatimi i një kuadri ligjor që lidhet me PP, duhet të jetë më e zgjeruar në krahasim me

përfituese. Kur një vend përballat me pengesa kushtetuese ose të rëndësishme praktike për zbatimin e kësaj kërkesë nga 1 Janari 2020 vendi mund të kërkojë zbatimin e përshtatur në përputhje me kërkesën 8.1. d) <u>Informacion në lidhje me identitetin e pronarit përfitues duhet të përfshijë emrin e pronarit përfitues, kombësinë dhe vendbanimin, si dhe identifikimin e personave të ekspozuar politikisht. Gjithashtu, rekomandohet që numri kombëtar i identitetit, datëlindja, adresa e banimit apo e shërbimit, si dhe mjetet e kontaktit të publikohen.</u> e) Grupi i shumë-palësh duhet të dakordësojnë një qasje për kompanitë pjesëmarrëse që të sigurojnë saktësinë e informatave të pronësisë përfituese që ato paraqesin. Kjo mund të konsistojë që ti kërkohej kompanive që të dëshmojnë formë e deklaratës së pronësisë përfituese nëpërmjet nënshkrimit nga një anëtar i ekipit të menaxhmentit të lartë apo këshilltarit të lartë ligjor, ose të dorëzojë dokumentacionin mbështetës.	fizik ose juridik, që zotëron ose kontrollon i fundit një klient dhe/ose personi, për llogari të të cilit kryhet një transaksion. Këtu përfshihen edhe ata persona, të cilët ushtrojnë kontrollin e fundit efektiv ndaj një personi juridik. Kontroll i fundit efektiv është marrëdhënia, në të cilën një person: a) zotëron në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë shumicën e aksioneve ose të votave të një personi juridik; b) i vetëm zotëron shumicën e votave të një personi juridik në bazë të një marrëveshjeje me ortakët ose me aksionarët e tjerë; c) përcakton de facto vendimet e marra nga personi juridik; ç) kontrollon në çdo lloj mënyre zgjedhjen, emërimin dhe largimin e shumicës së administratorëve të personit juridik. Subjekte të këtij ligji janë: a) subjektet bankare, si dhe çdo subjekt tjetër që licencohet apo mbikëqyret nga Banka e Shqipërisë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në subjektet e parashikuara në shkronjat “b”, “c” e “ç” të këtij neni; b) subjektet	ligjin nr.9917, datë 19.5.2008, në mënyrë që të vendosë për të gjitha kompanitë që veprojnë në industrinë nxjerrëse. Gjithashtu duhet të theksohet se regjistrat e kompanisë kombëtare duhet të përfshijnë (dhe të bëjë të arritshme për publikun) informacione të caktuara të lidhura me PP dhe për këtë arsye duhet të përfshihet një kërkesë në ligjin kombëtar shqiptar që të detyrojë kompanitë të mbajnë një regjistër publik që përmban informacionin e duhur mbi PP / PEP, të përditësuar në baza vjetore dhe/ose sa herë që të bëhet ndonjë ndryshim. Gjithashtu, duhet të merret parasysh mënyra se si do të zbatohet vendosja e detyrimeve dhe mekanizmave që do të përdoren për të siguruar zbatimin efektiv, duke pasur parasysh se mekanizmi i monitorimit dhe masat që do të zbatohen në rast të dështimit për të përmbushur këtë detyrim janë vendimtare për zbatimin e ligjit me sukses. Në këtë kuptim, hartimi, miratimi dhe zbatimi i një kuadri ligjor në lidhje me PP, kërkon një analizë të thellë dhe ndërveprim me kuadrin aktual ligjor, në mënyrë të veçantë me ligjet e mëposhtme: - Ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"; - Ligji nr. 9723/2007 "Për qendrën kombëtare të regjistrimit". - Ligji nr. 9917, datë 19.5.2008 "Për
--	---	---

f) Përkufizimi i pronësisë përfituese: i. Një pronari përfitues në lidhje me një kompani nënkupton personin (at) fizik të cilët direkt ose indirekt përfundimisht zotëron ose kontrollon subjektin e korporatave. ii. Grupi shumë-palësh duhet të dakordësojë një përkufizim të përshtatshëm të pronarit përfitues. Përkufizimi duhet të jetë në një linjë me (f) (i) si më sipër dhe të mbajë në vëmendje normat ndërkombëtare dhe ligjet përkatëse kombëtare, si dhe të përfshijë pragun(gjet) e pronësisë. Përkufizimi duhet të përcaktojë detyrimet për raportim për personat e ekspozuar politikisht. iii. Kompanitë e listuara publikisht, duke përfshirë degët plotësisht në pronësi, nevojiten të publikojnë emrin e bursës dhe të përfshijë një link në dosjet e bursës, ku ata janë të listuara. iv. Në rastin e ndërmarrjeve të përbashkëta, secili entitet në kuadër të ndërmarrjes duhet të publikojë informacione shpjeguese për pronarin e saj përfitues, përveç rasteve ku janë listuar publikisht ose është një degë tërësisht në pronësi të një	financiare jobanka; c) zyrat e këmbimeve valutore; ç) shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre; d) shërbimet postare që kryejnë shërbime pagesash; dh) shfuqizuar e) bursat dhe çdo subjekt tjetër (agjent, broker, shtëpi brokerimi etj.), që ushtron veprimtari për emetimin, këshillimin, ndërmjetësimin, financimin dhe çdo shërbim tjetër që ka lidhje me tregtimin e titujve; ë) shoqëritë që merren me sigurimin e jetës ose risigurimin, agentët apo ndërmjetësit e tyre, si dhe fondet e pensionit; f) Autoriteti Shtetëror Përgjegjës për Administrimin dhe Shitjen e Pronës Publike dhe çdo person tjetër juridik publik që kryen veprime juridike lidhur me tjetërsimin dhe dhënien në përdorim të pronës shtetërore, ose që kryen evidentimin, transferimin apo tjetërsimin e pronës shtetërore; g) lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet, të çfarëdo forme; gj) avokatët, noterët dhe përfaqësues të tjerë ligjorë, profesionet e rregulluara, që ofrojnë shërbimet e konsulencës financiare kur përgatisin ose kryejnë transaksione për klientët e	parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit"; - Ligji Nr 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike"; - Ligji nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve të zyrtarëve publikë të zgjedhur dhe caktuar"; - Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë; - Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative".
--	---	--

kompanie të listuara publikisht. Çdo entitet është përgjegjës për saktësinë e informacionit të dhënë. g) <u>Raporti EITI duhet gjithashtu të publikojë pronarët ligjorë dhe pjesën e pronësisë të kompanive të tilla.</u>	tyre për veprimtaritë e mëposhtme: i) kalimin e pronësisë së pasurive të paluajtshme, administrimin e parave, të letrave me vlerë ose të aseteve të tjera; ii) administrimin e llogarive bankare; iii) administrimin e pjesëve të kapitalit që do të përdoren për themelimin, funksionimin ose administrimin e shoqërive tregtare; iv) krijimin, funksionimin ose administrimin e personave juridikë; v) marrëveshjet ligjore, shitblerjen e aksioneve ose të pjesëve të kapitalit të shoqërive aksionare dhe transferimin e veprimtarive tregtare; h) agjentët e pasurive të paluajtshme, sipas kuptimit të përcaktuar në legjislacionin shqiptar për këtë kategori, kur përfshihen në transaksione për klientët e tyre, që lidhen me blerje ose shitje të pasurive të paluajtshme; i) ekspertët kontabël të autorizuar të pavarur, kontabilistët e miratuar të pavarur dhe zyrat e konsulencës financiare; j) Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale; k)	
---	--	--

		çdo person fizik ose juridik, përveç atyre të specifikuar më sipër, të cilët merren me: i) administrimin e aseteve të të tretëve/drejtimin e veprimtarive të lidhura me to; ii) shfuqizuar iii) ndërtimet; iv) biznesin e metaleve dhe të gurëve të çmuar; v) shfuqizuar vi) marrëveshjet dhe garancitë financiare; vii) shitblerjen e veprave të artit apo shitblerjen me ankand të sendeve me vlerë 1 500 000 lekë ose më shumë; viii) sigurimin dhe administrimin e parasë fizike ose të letrave me vlerë lehtësisht të konvertueshme, në emër të personave të tretë; ix) shfuqizuar x) tregtimin e mjeteve motorike; xi) veprimtaritë e speditimit dhe të transportit; xii) agjencitë e udhëtimit.		
2.6 Pjesëmarrja e shtetit Në rastin kur pjesëmarrja e shtetit në industrinë nxjerrëse i jep shkas pagesave të rëndësishme e të ardhurave, vendet zbatuese duhet të publikojnë informacion shpjegues: a) Një shpjegim i rregullave dhe praktikave mbizotëruese në	0.33 0.35 0.36	Ligji 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” Ligji nr. 7926, datë 04.20.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në kompani tregtare "; Ligji nr. 9723/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” Bazuar në dispozitat e ligjit nr. 9901/2008 dhe ligjit nr. 7926, datë 04.20.1995, ndërmarrjet shtetërore		Komente: Në informacionin tonë, nuk ka asnjë NKSH (ndërmarrje shtetërore), që vepron në sektorin e minierave. Ka disa kompani, aksionet e të cilëve janë në pronësi 100% të shtetit, si kompania Albaker sh.a, e cila është një kompani nën procedurën e likuidimit dhe

aksionet e tyre të barabarta, përfshirë nivelin e tyre të përgjegjësisë për të mbuluar shpenzimet në faza të ndryshme të ciklit të projektit, p.sh., të kapitalit plotëisht të paguar, barazisë së lirë, interesit të mbartur. Kur ka pasur ndryshime në nivelin e qeverisë dhe pronësisë së NKSH gjatë periudhës raportuese EITI, qeveria dhe NKSH pritet të publikojnë kushtet e transaksionit, duke përfshirë detaje në lidhje me vlerësimin e të ardhurave. Kur qeveria dhe NKSH kanë dhënë kredi apo garanci për hua për kompanitë e minierave, naftës dhe gazit që operojnë brenda vendit, duhet të publikohen detaje mbi këto transaksione.	0.33 A 123	Në bazë të ligjit nr. 9723/2007 "Për qendrën kombëtare të regjistrimit", NKSH janë të regjistruar në regjistrin tregtar dhe të gjitha të dhënat e lidhura me kompaninë janë publikuar në të njëjtën mënyrë si kompanitë private. Bazuar në ligjin 9901/2008, janë përshkruar marrëdhëniet financiare ndërmjet shtetit (aksionarëve) dhe një NKSH. Marrëdhënia juridike ndërmjet Aksionarit (shteti) dhe kompanitë (NKSH) janë të përcaktuara në nenin 123 dhe në vazhdim të ligjit 9901/2008. Në bazë të nenit 123, Aksionarët do të paguajë çmimin nominal ose më të lartë të aksioneve të tyre në llogarinë e kompanisë, dhe transferojnë kontributet e tyre në natyrë tek kompania në një mënyrë që varet nga karakteri i kontributeve në natyrë, ose siç parashikohet në statut. NKSH detyrohet të paguajë dividendin në përputhje me dispozitat e neneve 127, 128.		
Kërkesa EITI 3: Kërkim dhe prodhim				
3.1 Kërkimi	0.1	Ligji Nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për	F	komente: Ne e konsiderojmë këtë

Implementing countries <u>should disclose an overview of the extractive industries, including any significant exploration activities.</u> Vendet zbatuese duhet të publikojnë një përmbledhje të industrive nxjerrëse, duke përfshirë çdo aktivitet të rëndësishëm të kërkimit.	0.19 0.25 0.7 0.4 0.31 0.1 A 6,7,8	sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar Urdhër nr.384, datë 20.05.2011, ““Për miratimin e procedurave të regjistrimit dhe dokumentacionit që regjistrohet në kadastrën minerare dhe në regjistrin mineral si dhe forma dhe procedurat e raportimit të këtij dokumentacioni nga ana e zotëruesve të lejeve minerare”; Urdhër Nr.477, datë 27.06.2011 "Për miratimin e formës, përmbajtjes dhe procedurave të hartimit të akteve të miratimit dhe refuzimit për aplikimin për leje minerare”; VKM nr.479, datë 29.06.2011 “Për miratimin e strategjisë minerare të Republikës së Shqipërisë”. VKM 726, date 02.09.2015 “ Për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar, 2016–2018, për zhvillimin e aktivitetit mineral dhe përcaktimin e zonave minerare të rrezikshme”. Ligji nr.10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në republikëne Shqipërisë” Bazuar në nenet 6, 7 dhe 8 të Ligjit 10304, aktivitetet minerare zhvillohen bazuar në: 1.Strategjinë Minerare është dokumenti themelor, që përcakton politikat, përparësitë e zhvillimit, programet e veprimit dhe të administrimit të burimeve minerare për një periudhë 15-vjeçare, në	standard si në përputhje të plotë për shkak se Ministria tashmë ka publikuar informacion të përgjithshëm lidhur me industrinë minerare, përfshirë aktivitetet e kërkimit. Në këtë drejtim, janë publikuar të dhëna të lidhura me strategjinë e minierave, programin e minierave, si dhe planin vjetor të minierave. Të dhënat në lidhje me lejet e dhëna janë publikuar, duke pasur parasysh faktin se, në përputhje me dispozitat e ligjit 10304 dhe ligjit 10081, të dhënat e përfshira në Regjistrin e Minierave janë bërë publike
--	--	--	---

		përputhje me objektivat e strategjisë kombëtare të zhvillimit. 2. Strategjia minerare propozohet nga ministri, miratohet nga Këshilli i Ministrave. 1. Programi i veprimit për zbatimin e strategjisë minerare është dokumenti afatmesëm i planifikimit mineral, që hartohet në bazë të strategjisë minerare dhe është i vlefshëm për një periudhë 3-vjeçare. 2. Programi i veprimit për zbatimin e strategjisë minerare përmban: 5334 a) drejtimet për zhvillimin e sektorit mineral; b) promovimin e zonave minerare, për të cilat do të jepen lejet minerare, përmes procesit të konkurrimit apo procedurave të hapura; c) promovimin e zonave minerare, mbështetur në hartën minerare dixhitale, e cila hartohet brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji dhe përditësohet vazhdimisht; ç) programimin e veprimtarive të kërkimeve themelore gjeologjike; d) parashikimin e përgjithshëm të produktit vjetor në sektorin mineral; dh) nevojat për zhvillimin e burimeve njerëzore, profesionale në veprimtaritë minerare; e) rregullat për zbatimin e masave për sigurinë në punë dhe sigurinë e punonjësve;		
--	--	---	--	--

		ë) rregullat për mbrojtjen e mjedisit, peizazhit dhe rehabilitimin e tij; f) zonat e rrezikshme, ku veprimtaria minerare është e ndaluar dhe ku ndalohet dhënia e të drejtave minerare; g) tabelën me vlerat minimale të sipërfaqes së zonës së lejuar të lejeve minerare, vlerën minimale të investimit për lejet minerare të kërkim-zbulimit, si dhe vlerat minimale të prodhimit të mineralit për lejet e shfrytëzimit, për zonat konkurruese dhe zonat e hapura, sipas grupeve të mineraleve. 3. plani vjetor minerar, i cili përmban zonat minerare, për të cilat do të jepen të drejtat minerare, në vitin përkatës, zonat minerare, të drejtat minerare të të cilave përfitohen në bazë të një konkurrimi publik, në vijim zona konkurruese, dhe zonat e hapura, të drejtat minerare të të cilave përfitohen nga subjektet e interesuara, që plotësojnë kushtet e lejimit, në vijim zona të hapura. Strategjia minerare është miratuar me VKM nr. 479, datë 29.06.2011 "Për miratimin e strategjisë minerare të Republikës së Shqipërisë", botuar në Fletoren Zyrtare no.109 / 2011 Programi i veprimit është miratuar me VKM nr. 726, datë 02. 09. 2015 "Për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar, nga viti 2016 në 2018, për		
--	--	---	--	--

		zhvillimin e veprimtarive minerare dhe përcaktimin e zonave të rrezikshme minerare", e cila është botuar në Fletoren Zyrtare Nr.157 / 2015 Plani vjetor minerar është publikuar në faqen e internetit të Ministrisë http://www.energija.gov.al/al/sherbime/lejet-per-koncesionet-minerare/planifikimi-minerar dhe në Fletoren Zyrtare dhe pasqyrohet në hartën dixhitale minerare.		
	0.1 A.30	Bazuar në parashikimet e nenit 30 të ligjit 10304, Për lejet e kërkim-zbulimit, vendimi përfundimtar i miratimit të lejes njoftohet dhe hyn në fuqi në datën e publikimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve http://www.qkl.gov.al/Registries.aspx		
	0.1 A 41	(përveç rasteve kur, sipas këtij ligji, parashikohet miratimi nga Këshilli i Ministrave ose nga Kuvendi). Sipas nenit 41, transferimi i lejeve minerare gjithashtu duhet të regjistrohet në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve http://www.qkl.gov.al/Registries.aspx.		
	0.2 A 7.2, 7.3 7.4	Sipas VKM 320, datë 21.04.2011, nenet 7.2, 7.3 and 7.4, Autoriteti kontraktues ka detyrimin për të përgatitur dhe administruar regjistrin e procedurës konkurruese publike të cilat përfshijnë informata të përgjithshme në lidhje		

	0.1 A 2 P 33 A 44 0.19	procedurën konkurruese: - Ky informacion i regjistrit të procedurës konkurruese publike duhet t'i dorëzohet cdo pale të interesuar me kërkesë paraprake të tyre, në përputhje me ligjin 119/2014 "Për të drejtën e informimit". Bazuar në nenin 2 pika 33, dhe nenin 44 të ligjit 10304, datë 15.07.2010 , strukturat përgjegjëse duhet të administrojnë Regjistrin minerar që përfshin të gjitha të dhënat për regjimin juridik të sipërfaqeve të zonave minerare dhe të sipërfaqeve fqinje, pronësinë, situatën topografike të zonave minerare e të punimeve mbështetëse të veprimtarisë minerare, për rezervat dhe për prodhimin minerar, si dhe të dhënat për zotëruesin e lejeve minerare. Të dhënat e detajuara të cilat duhet të pasqyrohen në Regjistrin Minierave dhe procedurën e administratës janë pasqyruar në Urdhrin nr. 384, datë 20.05.2011 të Ministrit. Të dhënat të cilat do të përfshihen në Regjistrin Minierar, në përputhje me dispozitat e Urdhrit nr. 384, datë 20.05.2011 janë shumë të detajuara dhe të kategorizohen si më poshtë: 1.të dhëna për regjimin juridik të sipërfaqeve të zonave minerare dhe të sipërfaqeve fqinje.		
--	--	--	--	--

	0.31	2. të dhëna për pronësinë e tokës të sipërfaqeve të zonave minerare dhe të sipërfaqeve fqinje. 3. të dhëna për situatën topografike të zonave minerare etj. 4. të dhëna për rezerva dhe për prodhimin minierar sipas projektit të zhvillimit të veprimtarisë minerare etj. 5. Të dhëna për zotëruesin e lejeve minerare etj. 6. Të dhëna për kundravajtjet administrative të mbajtësit, statusin e lejes minerare, pezullimi dhe revokimi i lejes. Bazuar në pikën 8 të Urdhrit të Ministrit, Regjistri Minierar mbahet nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), në kuadrin e Regjistrimit të Licencave, autorizimet dhe lejeve, krijuar dhe administruar sipas dispozitave të nenit 14 të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 "për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", Strukturat përgjegjëse të cilat janë të përfshira në procesin e verifikimit dhe miratimit të lejes minerare, kanë të drejtë të kenë akses në këto të dhëna gjatë punës së tyre. Të dhënat kryesore të rëndësishme të përfshira në lejen minerare janë të arritshme nga publiku, sepse publikohen në sistemin e QKL. Ministria ka publikuar në faqen e saj një		
--	------	--	--	--

		informacion të përgjithshëm në lidhje me kërkimin dhe shfrytëzimin e lejeve të cilat janë aktive dhe lejet që janë revokuar. Këto të dhëna gjenden në këtë link: http://www.energja.gov.al/al/sherbime/lejet-per-koncesionet-minerare/planifikimi-minerarr		
shoqërisë civile: a) Shoqëria civile duhet të jetë plotësisht, në mënyrë aktive dhe efektive e angazhuar në procesin e EITI. b) Qeveria duhet të sigurojë që ekziston një mjedis i përshtatshëm për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në lidhje me ligjet, rregulloret dhe rregullat administrative, si dhe praktikën aktuale në zbatimin e EITI. Të drejtat themelore të shoqërisë civile të angazhuar në mënyrë thelbësore në EITI, duke përfshirë por jo kufizuar në anëtarët e grupit me shumë aktorë, duhet të respektohen. c) Qeveria duhet të sigurojë se nuk ka pengesa për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në procesin EITI. Qeveria duhet të kufizojë veprimet të cilat rezultojnë të limitojnë ose kufizojnë debatin publik në lidhje me zbatimin e EITI. d) Palët e interesuara, duke përfshirë por jo kufizuar në anëtarët e grupit shumë palësh duhet të: i. jenë në gjendje të flasin lirshëm për çështjet e transparencës dhe qeverisjes së burimeve natyrore. ii. jenë të angazhuar kryesisht në hartimin, zbatimin, monitorimin dhe	0.14	organizimin e Grupit Shumë-palësh për përfshirjen e Shqipërisë në Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI). Paragrafi 2 (ë) Pese perfaqesues nga shoqeria civile, te perzgjedhur nga Rrjeti Kombetar per Shoqerine Civile per EITI - ne. Paragraf 3 Me ftese te kryetarit, ne mbledhjet e ketij grupi mund te marrin pjese perfaqesues nga institucione te tjera Ligji Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Neni 6 "Detyrimi për njoftimin dhe konsultimin publik’ Paragrafi 1 Organet publike janë të detyruara të marrin të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë që të krijojnë mundësi për pjesëmarrjen e publikut dhe të të gjitha palëve të interesuara në procesin e njoftimit e të konsultimit publik. Vendimi nr. 993, datë 09.12.2015 i Këshillit të Ministrive “Për organizimin dhe funksionimin e Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (Sekretariati Shqiptar EITI), në mbështetje të	kërkesë EITI qëndron në afatin e dhënë me Vendimin e Kryeministrit Nr. 71/2011, e cila lejon vetëm 5 anëtare të Rrjetit Kombëtar të Industrisë Nxjerrëse për të marrë pjesë në procesin e pajtueshmërisë me EITI. Sipas paragrafit 3 të Vendimit të Kryeministrit nr. 71, 2011, pjesëmarrja e anëtarëve nga institucione të tjera (për shembull, kompanitë e tjera të interesuara) kontrollohet nga Kryetari i Grupit Shumë-palësh. Vendimi, bie ndesh me dispozitën e e përgjithshme të ligjit nr. 146/2014, i cili rregullon procesin e njoftimit të publikut në hartimin e punës legislative dhe dokumentet e tjera strategjike kombëtare dhe lokale. Pra, ky ligj parashikon të drejtën për pjesëmarrje në procesin e konsultimit për të gjitha palët e interesuara.
--	-------------	--	---

vlerësimin e procesit EITI, dhe të sigurojnë se ajo kontribuon në debatin publik. iii. kenë të drejtë të komunikojnë dhe të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin. iv. jenë në gjendje të veprojnë lirisht dhe të shprehin opinionet rreth EITI pa kufizim, shtrëngim ose masë ndëshkimore.	anëtarësimit në Organizatën Ndërkombëtare EITI” Paragrafi 4, 6 4. Sekretariati (EITI-Shqipëri) ushtron veprimtarinë në marrëdhënie me të gjitha subjektet e përfshira në sektorin e industrive nxjerrëse. Vendimmarrja në sekretariat realizohet në përputhje me standardin global EITI, nëpërmjet grupit ndërinstytucional të punës, i cili ngrihet me urdhër të Kryeministrit dhe funksionon si një platformë trepalëshe, me përfaqësues nga shoqëria civile, institucionet shtetërore përkatëse dhe shoqëritë që ushtrojnë aktivitetin në industri. 6. Sekretariati, për të realizuar misionin dhe objektivat e tij, bashkëpunon dhe bashkërendon veprimtarinë e tij me grupin ndërinstytucional të punës të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI) dhe me institucione të tjera, publike dhe/ose private, me grupet e interesit, shoqërinë civile, median vendase dhe/ose të huaj. Përveç stafit teknik të përhershëm, sekretariati, kur e sheh të arsyeshme, për të realizuar misionin dhe objektivat e tij, mund të kontraktojë shërbime këshillimi nga ekspertë		
---	--	--	--

		të jashtëm, sipas legjislacionit në fuqi.		
1.4 Grupi shumë-palësh a) Qeveria duhet të angazhohet të punojë me shoqërinë civile dhe kompanitë, dhe të krijojë një grup shumë-palësh për të mbikëqyrur zbatimin e EITI. Në krijimin e grupit shumë-palësh, qeveria duhet: i. Sigurojë se ftesa për të marrë pjesë në grup është i hapur dhe transparent. ii. Të sigurojë që palët e interesuara të jenë të përfaqësuara në mënyrë adekuate. Kjo nuk do të thotë se ata duhet të jenë të përfaqësuara në mënyrë të barabartë në numër. Grupi shumë palësh duhet të angazhojë palët e duhura, duke përfshirë por pa u kufizuar domosdoshmërisht në: sektorin privat; shoqërinë civile, përfshirë grupet e pavarura të shoqërisë civile dhe shoqërisë civile të tjera të tilla si media dhe sindikatat; dhe subjektet përkatëse qeveritare të cilat mund të përfshijnë parlamentarë. Secili grup shumë-palësh duhet të ketë të drejtë të caktojë përfaqësuesit e vet, duke pasur parasysh dëshirën e përfaqësimit pluraliste dhe të ndryshme. Procesi i nominimit duhet të jetë i pavarur dhe i lirë nga çdo sugjerim i	0.14 0.14	Vendimi nr. 993, datë 09.12.2015 i Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (Sekretariati Shqiptar EITI), në mbështetje të anëtarësimit në Organizatën Ndërkombëtare EITI” Paragraph 4 . Sekretariati (EITI-Shqipëri) ushtron veprimtarinë në marrëdhënie me të gjitha subjektet e përfshira në sektorin e industrive nxjerrëse. Vendimmarrja në sekretariat realizohet në përputhje me standardin global EITI, nëpërmjet grupit ndërinstitutional të punës, i cili ngrihet me urdhër të Kryeministrit dhe funksionon si një platformë trepalëshe, me përfaqësues nga shoqëria civile, institucionet shtetërore përkatëse dhe shoqëritë që ushtrojnë aktivitetin në industri. Vendimi nr. 71, datë 21.07.2011 I Kryeministrit “Për krijimin dhe organizimin e Grupit Shumë-palësh për përfshirjen e Shqipërisë në Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI). Paragrafi 1	P	Sipas paragrafit 3 të Vendimit të Kryeministrit nr. 71, 2011, pjesëmarrja e anëtarëve nga institucionet e tjera (për shembull, media apo shoqata të tjera) kontrollohet nga ftesa e Kryetarit të Grupit Shumë-palësh. Pra, pjesëmarrja në grup nuk është i hapur, por i kufizuar.

detyruar. Grupet e shoqërisë civile të përfshira në EITI, si anëtarë të grupit shumë palësh duhet të jenë operacionale, si dhe në aspektin e politikave, të pavarura nga qeveria dhe / ose kompanitë. iii. Konsiderojë krijimin e bazës ligjore të grupit. d) Grupi shumë palësh duhet të dakordësojë Terma Reference (ToR) të qarta e publike për punën e tij. ToR duhet, minimalisht të përmbajné dispozita për: Rolin, përgjegjësitë dhe të drejtat e grupit shumë palësh: i. Anëtarët e grupit shumë palësh duhet të kenë kapacitet për të kryer detyrat e tyre. ii. Grupi shumë palësh duhet të ndërmarrë aktivitete efektive në terren me grupet e shoqërisë civile dhe kompanive, përfshirë komunikime nëpërmjet medias, ëbsite dhe letra, për të informuar aktorët e qeverisë të angazhuar për të zbatuar EITI, dhe rolin qendror të kompanive dhe shoqërisë civile. Grupi shumë palësh duhet të shpërndajë gjerësisht informacionin publik që rezulton nga procesi i EITI si Raporti i EITI. iii. Anëtarët e grupit shumë palësh duhet të ndërliidhen me pjesëmarrësit e tyre.	Organet publike janë të detyruara të marrin të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë që të krijojnë mundësi për pjesëmarrjen e publikut dhe të të gjitha palëve të interesuara në procesin e njoftimit e të konsultimit publik. Paragrafi 2 Grupi i punes te kryesohet nga zevendesministri i Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes dhe ne perberje te kete keta anetare: a) Nje perfaqesues nga Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes; b) Nje perfaqesues nga Ministria e Financave; c) Nje perfaqesues nga Ministria e Drejtesise; 9) Nje perfaqesues nga Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve; d) Nje perfaqesues nga Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore; dh) Nje perfaqesues nga Sherbimi Gjeologjik Shqiptar; e) Pese perfaqesues nga biznesi, te perzgjedhur nga Rrjeti Kombetar i Industrise Nxjerrese; ë) Pese perfaqesues nga shoqeria civile, te perzgjedhur nga Rrjeti Kombetar per Shoqerine Civile per EITI - ne. Niveli i përfaqësimit në këtë grup	
--	--	--

Miratimi i planeve të punës, raporteve EITI dhe raportet vjetore të progresit: iv. Grupi shumë palësh është i detyruar të miratojë planet vjetore të punës, emërojë Administratorin e Pavarur, Termat e Referencës për Administratorit të Pavarur, Raportet EITI dhe raportet vjetore të progresit. v. Grupi shumë palësh duhet të mbikëqyrë procesin e raportimit EITI dhe të angazhohet në Validim. Rregullat dhe procedurat e brendshme të qeverisjes: vi. EITI kërkon një proces gjithëpërfshirës vendim-marrës gjatë zbatimit, me cdo pjesëmarrës, duke u trajtuar si një partner. Çdo anëtar i grupit shumë palësh ka të drejtë të shtrojë një çështje për diskutim. Grupi shumë palësh duhet të bie dakord dhe të publikojë procedurat për emërimin dhe ndryshimin e përfaqësuesve të grupeve shumëpalësh, vendim-marrjen, kohëzgjatja e mandatit dhe frekuencat e takimeve. Kjo përfshin dhe sigurimin për një proces për ndryshimin e anëtarëve të grupit që respekton parimet e përcaktuara në Kërkesa 1.4.a. Ku grupi shumë palësh ka një praktikë të dietave për të marrë pjesë në mbledhjet EITI ose në lidhje me pagesa të tjera për anëtarët e grupit shumë-palësh, kjo praktikë		për subjektet publike do të jetë drejtor drejtorie ose më sipër. Paragrafi 3 Me ftese të kryetarit, në mbledhjet e këtij grupi mund të marrin pjesë përfaqësues nga institucione të tjera		
--	--	--	--	--

duhet të jetë transparente dhe nuk duhet të krijojë konflikte interesi. vii. Duhet të ketë një njoftim paraprak mjaftueshëm për mbajtjen e takimeve dhe qarkullimin në kohë të dokumenteve përpara diskutimeve të tyre dhe miratimit të propozuar. viii. Grupi shumë palësh duhet të mbajë shënime me shkrim të diskutimeve dhe vendimeve të saj.				
1.5 Plani i Punës Grupi shumë palësh duhet të mbajë një plan aktual pune, për të përlogaritur plotësisht dhe në përputhje me raportimin dhe Vleftësimin e afateve të përcaktuara nga Bordi EITI. Plani i punës duhet: a) të vendosë objektiva të zbatimit EITI të cilat janë të lidhura me Parimet EITI dhe të reflektojnë prioritetet kombëtare për industrinë nxjerrëse. Grupet shumë-palëshe inkurajohen për të shqyrtuar qasjet inovative për të zgjeruar zbatimin e EITI për të rritur tërësinë e raportimin EITI dhe të kuptuarit publik të të ardhurave dhe të inkurajojnë standardeve të larta të transparencës dhe llogaridhënies në jetën publike, funksionimin e shtetit dhe në biznes. b) Reflektojë rezultatet e konsultimeve me aktorët kryesorë, dhe të miratohen nga grupi shumë palësh. c) Të përfshijë aktivitete të matshme dhe me afate kohore të caktuara për të	0.15	Vendimi nr. 993, datë 09.12.2015 i Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (Sekretariati Shqiptar EITI), në mbështetje të anëtarësimit në Organizatën Ndërkombëtare EITI” Paragrafi 2, 5 2. Misioni i sekretariatit është përmbushja e prioritetëve dhe strategjive kombëtare për transparencë në industrinë nxjerrëse. Sekretariati koordinon përpjekjet kombëtare, në zbatim të standardit global EITI, që rrjedhin si detyrim nga anëtarësimi, për të siguruar transparencë të plotë të të gjitha taksave dhe pagesave që kryhen nga industrinë e naftës, gazit, minierave dhe burimeve të tjera natyrore, me kontribut material në buxhetin e shtetit, proceseve respektive, si dhe përgatitjen e	F	

arritur objektivat e miratuara. Fusha e zbatimit të EITI duhet të përshtatët në mënyrë që të kontribuojë në arritjen e objektiveve të dëshiruara të cilat identifikohen gjatë procesit të konsultimit. Plani i punës duhet: i. adresojë dhe të përshkruajë planet për të adresuar çdo kufizim të mundshme të kapaciteteve në agjencitë qeveritare, kompanitë dhe shoqërinë civile që mund të jetë një pengesë për zbatimin efektiv të EITI. ii. Adresojë fushën e raportimit EITI, duke përfshirë edhe planet për adresimin e aspekteve teknike të raportimit, të tilla si gjithëpërfshirja (4.1) dhe besueshmëria e të dhënave (4.9). iii. Të identifikojë dhe përshkruajë planet për të adresuar pengesat e mundshme ligjore ose rregullatore për zbatimin e EITI, duke përfshirë, nëse është e zbatueshme, çdo plan për të përfshirë Kërkesat EITI brenda legjislacionit ose rregullore kombëtare. iv. Të përshkruajë planet e grupit shumë-palësh për zbatimin e rekomandimeve nga Vleftësimi dhe raportimi EITI. d) Identifikimi i burimeve të brendshme dhe të jashtme të financimit dhe asistencës teknike kur është e nevojshme për të siguruar zbatimin në kohë të planit të miratuar të punës.	menaxhimit të projekteve, në lidhje me këto fusha. 5. . Detyrat dhe objektivat e sekretariatit, në zbatim të kërkesave të standardeve EITI, janë: a) Ngritja e strukturës së nevojshme, në mbështetje të programit të veprimeve të miratuara për EITI-Shqipëri; b) Publikimi i raporteve EITI, garantimi i procesit të auditimit dhe plotësimi i procedurave për hartimin e raportit të miratimit; c) Përcaktimi, në bashkëpunim me grupin ndërinstitucional të punës dhe ministrinë e linjës, i objektiveve kombëtare të zbatimit të EITI-t; ç) Rishikimi i bazës ligjore, për të reflektuar në legjislacionin përkatës kërkesat e standardit EITI, si dhe për të evidentuar pengesat e ndryshme për zbatimin e tij; d) Identifikimi i burimeve të qëndrueshme të financimit, për zbatimin e planit kombëtar për EITI-n, si dhe monitorimi i tyre; dh) Publikimi dhe shpërndarja e raporteve; e) Ndjekja e një strategjie komunikimi dhe informimi, referuar standardit global EITI dhe strategjisë kombëtare për transparencë, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar; ë) Ngritja e kapaciteteve/trajnimi	
---	---	--

e) Të jetë gjerësisht i disponueshëm për publikun, për shembull, të publikohet në faqen zyrtare kombëtare të internetit të EITI dhe / ose faqe zyrtatë të ministrive dhe agjensive të tjera përkatëse, në mediat e shkruara apo në vende që janë lehtësisht të arritshme për publikun. f) Të rishikohet dhe përditësohet çdo vit. Në rishikimin e planit të punës, grupi shumë- palësh duhet të konsiderojë zgjerimin e detajeve dhe qëllimin e raportimit EITI, duke përfshirë adresimin e çështjeve si menaxhimi i të ardhurave dhe shpenzimeve (5.3), pagesat e transportit (4.4), shpenzimeve diskrecionale sociale (6.1.b), transfertat e përkohshme kombëtare (5.2.b), pronësinë përfituese (2.5) dhe kontratat (2.4). Në përputhje me kërkesat 1.4.b (viii), grupi shumë- palësh duhet të dokumentojër diskutimet dhe vendimet e saj. g) Përfshijnë një afat kohor të caktuar për zbatim që pëputhet me raportimin dhe afatet e Vleftësimit të përcaktuara nga Bordi EITI (8.1-8.4) dhe që merr parasysh kërkesat administrative të tilla si proceset e prokurimit dhe financimit.		i punonjësve shtetërorë, i shoqërisë civile, ku përfshihet edhe media, si dhe grupeve të interesit, të lidhura me EITI-n. f) Trajnimi i nëpunësve të EITI-t, në përputhje me programin e zbatimit kombëtar për EITI-Shqipëri. g) Raportimi, para grupit ndërinstitucional të punës, në mënyrë periodike, për ecurinë e realizimit të veprimtarive të programit dhe të hapave të anëtarësimit. gj) Zgjerimi i fushës së veprimit të EITI-t edhe në fusha të tjera të burimeve natyrore. h) Evidentimi dhe realizimi i projekteve të ndryshme, në lidhje me transparencën dhe antikorrupsionin në industrinë nxjerrëse dhe atë hidroenergjetike.		
Kërkesa EITI 2: Kuadri ligjor dhe institucional, përfshirë alokimin e kontratave dhe licencave				

2.1 Kuadri ligjor dhe regjimi fiskal (a) Vendet zbatuese duhet të deklarojnë një përshkrim të kuadrit ligjor dhe të regjimit fiskal që rregullon industrinë nxjerrëse. Ky informacion duhet të përmbajë një përshkrim përmbledhës të regjimit fiskal, përfshirë nivelin e decentralizimit fiskal, një pasqyrë të ligjeve dhe rregulloreve përkatëse, si dhe informacion mbi rolet dhe përgjegjësitë e agjencive qeveritare përkatëse. (b) Kur qeveria ndërmerr reforma, grupi shumë-palësh inkurajohet për të siguruar që ato janë të dokumentuara.	0.1	Ligji nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për hidrokarburet” (kërkimi dhe prodhimi), i ndryshuar, në nenin 9, paragrafi 3, parashikon detyrimin e të licencuarve për të raportuar të dhëna dhe informacion në përputhje me Standardin EITI. Ky nen përcakton detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Administratës doganore shqiptare dhe institucioneve publike qendrore dhe lokale mbledhjen e të ardhurave nga sektori për të raportuar në përputhje me rrethanat.	P	Nuk ka detyrime dhe procedura ligjore që rregullojnë transparencën mbi regjimin fiskal që udhëheq industrinë nxjerrëse në lidhje me hidrokarburet, edhe pse informacioni selektiv është bërë publik në baza të përkohshme, por ky publikim nuk rrjedh nga një detyrim i qartë ligjor. Ligji nr. 7811, datë 12.04.1994 "Për miratimin e ndryshime në dekretin nr. 782, datë 22.02.1994" Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve (kërkim- prodhim) i ndryshuar, duhet të ndryshohet në mënyrë që të përfshijë informacionin e kërkuar. Një shembull mund të jetë, rregullimi i nenit 36, paragrafi 25 i Ligjit nr 10304/2010 “Për sektorin minierar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
2.2 Alokimet e licencës a) Vendet zbatuese duhet të deklarojnë informacionin e mëposhtëm lidhur me dhënien ose transferimin e licencave që kanë të bëjnë me kompanitë e përfshira në Raportin EITI gjatë periudhës fiskale të mbuluar nga Raporti EITI: i. një përshkrim të procesit për transferimin ose dhënien e licencës; ii. kriteret teknike dhe financiare të përdorura; iii. informacion në lidhje me marrësin (t) e licencës që është transferuar ose dhënë, duke përfshirë anëtarët e	0.13	Urdhri i Ministrit 121/2015 (MEI) "Për disa ndryshime në Rregulloren për miratimin e procedurave të marrëveshjeve të Hidrokarbureve dhe marrëveshjeve të Licencimit si dhe afatit përkatës", e cila rregullon hapat dhe procedurat për dhënien e marrëveshjes hidrokarbure dhe licencave përkatëse. Udhëzimi i Ministrit 132/2015 (MEI) “Mbi procedurat për marrëveshjen hidrokarbure”,	P	Informacioni i dhënë është i një natyre të përgjithshme dhe nuk mbulon listën e aplikantëve dhe kriteret e tenderit, si dhe faqja zyrtare e AKBN (si autoritet kompetent), nuk është përditësuar me këtë informacion (deri më sot). Është me rëndësi të përmendim dy akte normative si më poshtë: 1. Rregullore “Per procedurat e miratimit të Marrëveshjeve Hidrokarbure dhe te Licence

konsorciumit, nëse aplikohet; dhe iv. çfarëdo shmangie jo-e parëndësishme nga dispozitat e zbatueshme të kuadrit ligjor dhe rregullator që udhëheqin transfertat e licencave dhe shpërblimet. Është e nevojshme që informacioni i paraqitur më sipër të publikohet për të gjitha shpërblimet dhe transfertat e licencave që ndodhin gjatë vitit fiskal të mbuluar nga Raportin EITI, duke përfshirë alokimet e licencës kanë të bëjnë me kompanitë që nuk janë të përfshira në raportin EITI, dmth ku pagesat e tyre bien nën pragun e dakordësuar. Çdo pengesë e rëndësishme ligjore ose praktike që pengon këtë publikim gjithëpërfshirës duhet të dokumentohet dhe shpjegohet në raportin EITI, duke përfshirë një llogari të planeve të qeverisë për të kërkuar kalimin e këtyre pengesave dhe afatin kohor të parashikuar për arritjen e tyre. b) Ku kompanitë e përfshira në Raportin EITI mbajnë licencat të cilat janë alokuar para periudhës fiskale të Raportit EITI, vendet zbatuese inkurajohen, nëse është e mundur, të deklarojnë informacionin e përcaktuar në pikën 2.2 (a) për këto licenca. c) Kur licencat jepen përmes një procesi të tenderimit gjatë periudhës fiskale të mbuluar nga Raporti EITI, qeveria duhet të publikojë listën e aplikantëve	i cili parashikon detyrimin e AKBN për të publikuar dhe deklaruar informacionin në lidhje me hartën e Blloqeve të Lira të Kërimit për hidrokarburet.	Marreveshjeve si dhe afatet përkatëse”, miratuar nga Ministri. 2. Urdhëri i Ministrit nr. 121/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregullore “Per procedurat e miratimit të Marrëveshjeve Hidrokarbure dhe te Licence Marreveshjeve si dhe afatet përkatëse” Aktet normative të përmendura më lart, përmbajnë një informacion të detajuar, lidhur me procedurën për miratimin e Marrëveshjes së Hidrokarbureve dhe Licencë Marrëveshjeve. Kjo Rregullore gjithashtu, përcakton afatet për shqyrtimin e dokumentit dhe zbatimin e palës së interesuar nga subjektet përgjegjëse (Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe Albpetrol sh.a).
--	---	---

dhe kriteret e tenderit. d) Kur informacioni i nevojshëm i përcaktuar në 2.2 (A-C) është vënë në dispozicion të publikut, mjafton që të përfshihet referenca ose linku përkatës në Raportin EITI. e) Grupi i shumë palësh mund të dëshirojë që të përfshijë informacion shtesë në alokimin e licencave në Raportin EITI, duke përfshirë shpjegime mbi efikasitetin dhe efektivitetin e procedurave të licencimit.				
2.3 Regjistri i Licencave a) Termi licence, në këtë kontekst i referohet çdo licence, qiraje, titulli, leje, kontratë apo koncesion të cilën qeveria ja jep një kompanie/ve ose të drejtave individit/ëve për të kërkuar ose shfrytëzuar naftën, gazin dhe/ose burimet minerare. b) Vendet zbatuese duhet të mbajnë një regjistër në dispozicion të publikut ose të sistemit kadastral (s) me informacionin e duhur dhe të plotë si në vijim në lidhje me secilin nga licencat kanë të bëjnë me kompanitë e përfshira në Raportin EITI: i. Mbajtësi/t e licencës. ii. në rastin kur mblidhen, koordinatat e zonës së licencës. Ku koordinatat nuk janë mbledhur, qeveria duhet të sigurohet që madhësia dhe vendndodhja e zonës së licencës është publikuar në regjistrin e licencës dhe se koordinatat janë vënë në		Ligji Nr. 146/2014 “për njoftimin dhe konsultimin publik”. Neni 7 “Regjistri elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike”; Paragrafi 1 Çdo projektakt publikohet në regjistrin elektronik për njoftimin dhe konsultimin publik. Ky regjistër është një faqe zyrtare interneti, e cila shërben si një pikë qendrore konsultimi, dhe nëpërmjet këtij regjistri sigurohet akses dhe ofrohet mundësia e komunikimit të të gjitha palëve të interesuara me organin publik. Kjo formë siguron dhe forcon barazinë për sa i përket aksesit në informacion dhe shërbim, duke pasur në vëmendje dhe nevoja specifike për persona apo grupime	P	AKBN, mban një regjistër për marrëveshjet hidrokarbure dhe licencë marrëveshjet e faqen e saj zyrtare, por detyrimi për të krijuar dhe administruar një regjistër të tillë nuk është i rregulluar me ndonjë akt ligjor apo administrativ (mesa jemi informuar), nëse ky është rasti, ekzistenca e tij mbetet plotësisht nën subjektivitetin e autoritetit dhe informacioni specifik mund ose nuk mund të paraqiten në të. Informacionet kryesore që nuk paraqiten në Regjistër janë: • Koordinatat e zonës së licencës; • Kohëzgjatja e licencës; • fazat (kërkimi ose nxjerrja).

dispozicion të publikut nga agjencia përkatëse qeveritare, pa tarifat dhe kufizime të paarsyeshme. Raporti EITI duhet të përfshijë udhëzime se si të aksekohen koordinatat dhe shpenzimet, nëse ka, aksesimi i të dhënave. Raporti EITI duhet të dokumentojnë planet dhe afatet kohore për vendosur këtë informacion në dispozicion lirisht dhe në mënyrë elektronike përmes regjistrit licencës. iii. Data e aplikimit, datën e dhënies dhe kohëzgjatja e licencës. iv. Në rastin e licencave të prodhimit, produktin që prodhohet. Pritet që regjistri i licencave apo kadastra të përfshijë informacion në lidhje me licencat e mbajtura nga të gjitha subjektet, duke përfshirë kompanitë dhe individët apo grupet që nuk janë të përfshira në raportin EITI, dmth ku pagesat e tyre bien nën pragun e materialitetit të rënë dakord. Çdo pengesë e rëndësishme ligjore ose praktike që pengojnë një publikim gjithëpërfshirës duhet të dokumentohet dhe shpjegohet në raportin EITI, duke përfshirë një vlerësim të planeve të qeverisë për të kapërcyer këto pengesa dhe afatet kohore të parashikuar për arritjen e tyre. c) Kur informacioni i përcaktuar në 2.3.b është vënë në dispozicion të publikut, mjafton që të përfshihet referenca ose linku në Raportin EITI. Nëse këto	të caktuara. Ligji nr. 7746, datë 28.07.1993 "Për hidrokarburet" (kërkimi dhe prodhimi), i ndryshuar. Neni 4 "Operacione Hidrokarburesh" Në përputhje me nenin 12.(2) dhe përveç rasteve të operacioneve të vlerësimit të objektit të kryera nën dhe në përputhje me një leje për vlerësim objekti të lëshuar në përputhje me nenin 8, asnjë person nuk do të kërkojë, zhvillojë apo prodhojë hidrokarbure në Shqipëri pa qenë i autorizuar nga Ministria për ta bërë këtë sipas termave dhe kushteve të një Marrëveshjeje Hidrokarburesh. Kërkimi, zbulimi, shfrytëzimi i hidrokarbureve dhe operacione të tjera, të përcaktuara në këtë ligj, bëhen vetëm nga subjektet, me të cilat lidhen marrëveshje hidrokarbure, që përfshihen në kategorinë IV.1, të shtojcës së ligjit për licencat. Këto marrëveshje lidhen, në përputhje me dispozitat në vijim, të këtij ligji. Miratimi në heshtje nuk zbatohet në rastin e këtyre marrëveshjeve.		
---	--	--	--

regjistra apo kadastra nuk ekzistojnë ose nuk janë të plota, Raporti EITI duhet të publikojë cdo mangësi në informacionin që vihet në dispozicion të publikut dhe të dokumentojë përpjekjet për të forcuar këto sisteme. Ndërkohë, vetë Raporti EITI duhet të përfshijë informacionin e përcaktuar në 2.3.b më sipër.				
2.4 Kontratat a) Vendet zbatuese inkurajohen të bëjnë publike të gjitha kontratat dhe licencat që ofrojnë kushtet që lidhen me shfrytëzimin e naftës, gazit dhe mineraleve. b) Është një kërkesë që Raporti EITI të dokumentojë politikën e qeverisë për dhënien e kontratave dhe licencave që udhëheqin kërkimin dhe shfrytëzimin e naftës, gazit dhe mineraleve. Kjo duhet të përfshijë dispozitat përkatëse ligjore, praktikat aktuale për dhënien e informacionit dhe çdo reformë të planifikuar apo që është në zbatim. Nëse aplikohet, Raporti EITI duhet të ofrojë një pasqyrë të kontratave dhe licencave që janë vënë në dispozicion të publikut, dhe të përfshijnë një referencë ose link në vendin ku këto janë botuar. c) Termi kontratë në 2.4 (a) nënkupton: i. Tekstin e plotë të çdo kontrate,	0.1	Ligji nr. 7746, datë 28.07.1993 "Për hidrokarburet" (kërkimi dhe prodhimi), i ndryshuar, sic përcaktohet në nenin 9.	P	Marrëveshjet hidrokarbure janë miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM), e cila, si një detyrim të përgjithshëm, hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare (www.qbz.gov.al). Ky detyrim nuk respektohet gjithmonë, si psh: VKM nr. 90, datë 27.01.2009 "Marrëveshja e Hidrokarbureve për fushë-naftën Visoka ...", e cila është publikuar pa kontratën përkatëse bashkangjitur.

koncesioni, marrëveshje prodhim-shpërnarje ose marrëveshje tjetër të dhënë ose të lidhur nga qeveria e cila siguron kushtet në lidhje me shfrytëzimin e gazit të naftës dhe burimeve minerale. ii. Teksti i plotë i çdo aneksi, shtojcë ose konkluzioni i cili përcakton detajet përkatëse për të drejtat e shfrytëzimit të përshkruara në 2.4 (c) (i) ose zbatimin e tij. iii. Teksti i plotë i çdo ndryshimi ose përmirësimi në dokumentet e përshkruara në 2.4 (c) (i) dhe 2.4 (c) (ii). d) Termi Licencë në 2.4 (a) nënkupton: i. Tekstin e plotë të çdo licencë, qiraje, titulli apo leje me të cilat qeveria i jep të drejta kompanisë(ve) ose individëve(t) për të shfrytëzuar naftën, gazin dhe/ose burimet minerare. ii. Teksti i plotë i çdo aneksi, shtojcë ose konkluzioni i cili përcakton detajet përkatëse për të drejtat e shfrytëzimit të përshkruara në 2.4 (d) (i) ose zbatimin e tij. iii. Teksti i plotë i çdo ndryshimi ose përmirësimi në dokumentet e përshkruara në 2.4 (d) (i) dhe 2.4 (d) (ii).				
---	--	--	--	--

2.5 Pronësia përfituese a) Rekomandohet që vendet zbatuese të mbajnë një regjistër në dispozicion të publikut për pronarët përfitues të subjekteve korporata që tenderojnë, veprojnë ose investojnë në aktive nxjerrëse, duke përfshirë identitetin(tet) e pronarit(ëve) të tyre përfitues, nivelin e pronësisë dhe detajet se si është ushtruar pronësia ose kontrolli. Kur është e mundur, informacioni pronësisë përfituese duhet të përfshihet në dosjet ekzistuese nga kompanitë për rregullatorët e korporatave, bursat apo agjenci që rregullojnë licencimin e industrisë nxjerrëse. Kur ky informacion vihet në dispozicion të publikut, Raporti EITI duhet të përfshijë udhëzime se si aksesohet informacion. b) Nevojitet që: i. Raporti EITI të dokumentojë politikën e qeverisë dhe diskutimin e grupit shumë-palësh në publikimin e pronësisë përfituese. Kjo duhet të përfshijë detaje të dispozitave ligjore përkatëse, praktikat aktuale të publikimit dhe çdo reformë që janë planifikuar ose që zbatohen në lidhje me publikimin e pronësisë përfituese. ii. Nga 1 Janar 2017, grupi shumë-palësh publikon një plan për dhënien e	Ligji Nr. 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, i ndryshuar; dhe Ligji nr. 9723/2007 "Për qendrën kombëtare të regjistrimit", (neni 28, 29 dhe 32), i ndryshuar, parashikon detyrimin e përfituesve që tenderojnë, veprojnë ose investojnë në aktive nxjerrëse, përfshirë identitetin (et) e pronarit (ëve)të tyre përfitues, nivelin i pronësisë dhe detajet se si ushtrohet pronësia apo kontrolli. Regjistri Tregtar, si rregull, jep të dhëna për themeluesit e çdo kompanie apo individët tregtarë, por në rastet kur themeluesit e kompanisë janë kompani të tjera, pronari përfitues nuk është deklaruar / identifikuar.	P	Çështja identifikuar në lidhje me deklarinimin/identifikimin e pronarit përfitues, mund të zgjidhet nëpërmjet ndryshimit të Ligjit nr. 9723/2007 "Për qendrën kombëtare të regjistrimit", ose Ligjit nr. 7746, datë 28.07.1993 "Për hidrokarburet".
--	--	----------	--

informacioneve shpjeguese të pronësisë përfituese në përputhje me klauzolat (c) - (f) më poshtë. Grupi shumë-palësh do të përcaktojë të gjitha piketat dhe afatet në planin udhëzues, dhe grupi shumë-palësh do të vlerësojë zbatimin e planit udhëzues, si pjesë e raportit vjetor të grupit shumë -palësh të raportit të progresit. g) Që nga 1 janari 2020, do të kërkohet që vendet zbatuese të kërkojnë, dhe kompanitë publikojnë, informacione të pronësisë përfiruese për tu përfshirë në Raportin EITI. Kjo aplikohet për entitet e korporatave (ve) që tenderojnë, veprojnë ose investojnë në pasurinë nxjerrëse dhe duhet të përfshijnë identitetin (tet) e pronarit (ëve) të tyre përfitues, nivelin e pronësisë dhe detaje se si ushtrohet pronësia ose kontrolli. Çdo mangësi apo dobësi në raportimin e informacionit të pronësisë përfituese duhet të publikohet në Raportin EITI, përfshirë emërtimin e çdo entiteti që nuk arriti të paraqesë të gjithë ose pjesë të informacionit të pronësisë përfituese. Kur një vend përballet me pengesa kushtetuese ose të rëndësishme praktike për zbatimin e				
--	--	--	--	--

kësaj kërkesë nga 1 Janari 2020 vendi mund të kërkojë zbatimin e përshtatur në përputhje me kërkesën 8.1. h) <u>Informacion në lidhje me identitetin e pronarit përfitues duhet të përfshijë emrin e pronarit përfitues, kombësinë dhe vendbanimin, si dhe identifikimin e personave të ekspozuar politikisht. Gjithashtu, rekomandohet që numri kombëtar i identitetit, datëlindja, adresa e banimit apo e shërbimit, si dhe mjetet e kontaktit të publikohen.</u> i) Grupi i shumë-palësh duhet të dakordësojnë një qasje për kompanitë pjesëmarrëse që të sigurojnë saktësinë e informatave të pronësisë përfituese që ato paraqesin. Kjo mund të konsistojë që ti kërkohej kompanive që të dëshmojnë formë e deklaratës së pronësisë përfituese nëpërmjet nënshkrimit nga një anëtar i ekipit të menaxhmentit të lartë apo këshilltarit të lartë ligjor, ose të dorëzojë dokumentacionin mbështetës. j) Përkufizimi i pronësisë përfituese: i. Një pronari përfitues në lidhje me një kompani nënkupton personin (at) fizik të cilët direkt ose indirekt përfundimisht zotëron ose kontrollon subjektin e korporatave.				
---	--	--	--	--

ii. Grupi shumë-palësh duhet të dakordësojë një përkufizim të përshtatshëm të pronarit përfitues. Përkufizimi duhet të jetë në një linjë me (f) (i) si më sipër dhe të mbajë në vëmendje normat ndërkombëtare dhe ligjet përkatëse kombëtare, si dhe të përfshijë pragun(gjet) e pronësisë. Përkufizimi duhet të përcaktojë detyrimet për raportim për personat e ekspozuar politikisht. iii. Kompanitë e listuara publikisht, duke përfshirë degët plotësisht në pronësi, nevojiten të publikojnë emrin e bursës dhe të përfshijë një link në dosjet e bursës, ku ata janë të listuara. iv. Në rastin e ndërmarrjeve të përbashkëta, secili entitet në kuadër të ndërmarrjes duhet të publikojë informacione shpjeguese për pronarin e saj përfitues, përveç rasteve ku janë listuar publikisht ose është një degë tërësisht në pronësi të një kompanie të listuara publikisht. Çdo entitet është përgjegjës për saktësinë e informacionit të dhënë. g) <u>Raporti EITI duhet gjithashtu të publikojë pronarët ligjorë dhe pjesën e pronësisë të kompanive të tilla.</u>				
2.6 Pjesëmarrja e shtetit Në rastin kur pjesëmarrja e shtetit në industrinë nxjerrëse i jep shkas		Informacioni i dhënë në këtë raport, rrjedh nga kërkesa për anëtarësim në EITI dhe	F	I gjithë informacioni në lidhje me kërkesat e paragrafit 2.6 "Pjesëmarrja e Shtetit", që është relevant për

detaje në lidhje me kushtet lidhur me aksionet e tyre të barabarta, përfshirë nivelin e tyre të përgjegjësisë për të mbuluar shpenzimet në faza të ndryshme të ciklit të projektit, p.sh., të kapitalit plotësisht të paguar, barazisë së lirë, interesit të mbartur. Kur ka pasur ndryshime në nivelin e qeverisë dhe pronësisë së NKSH gjatë periudhës raportuese EITI, qeveria dhe NKSH pritet të publikojnë kushtet e transaksionit, duke përfshirë detaje në lidhje me vlerësimin e të ardhurave. Kur qeveria dhe NKSH kanë dhënë kredi apo garanci për hua për kompanitë e minierave, naftës dhe gazit që operojnë brenda vendit, duhet të publikohen detaje mbi këto transaksione.				
Kërkesa EITI 3: Kërkim dhe prodhim				
3.1 Kërkimi Implementing countries <u>should disclose an overview of the extractive industries, including any significant exploration activities.</u> Vendet zbatuese duhet të publikojnë një përmbledhje të industrive nxjerrëse, duke përfshirë çdo aktivitet të rëndësishëm të kërkimit.	0.1	Ligji nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për hidrokarburet” (kërkimi dhe prodhimi), i ndryshuar, në nenin 9, paragrafi 3, parashikon detyrimin e të licencuarve për të raportuar të dhëna dhe informacion në përputhje me Standardin EITI. Ky nen përcakton detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Administratës doganore shqiptare dhe institucioneve publike qendrore dhe lokale mbledhjen e të ardhurave nga sektori për të	P	Informacioni i dhënë është i një natyre të përgjithshme dhe nuk mbulon listën e aplikantëve dhe kriteret e tenderit, si dhe faqja zyrtare e AKBN (si autoritet kompetent), nuk është përditësuar me këtë informacion (deri më sot). Mangësia kryesore në publikimin e këtij informacioni rrjedh nga mungesa e procedurave të brendshme administrative dhe instrumenteve për shkëmbimin e informacionit ndërmjet organeve publike dhe palëve të interesuara.

		raportuar në përputhje me rrethanat. Sipas Nenit 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 547/2006 (i ndryshuar), AKBN detyrohet të mbledhë informacione në lidhje me të dhënat për prodhimin e hidrokarbureve, prodhimi potencial dhe aktual, të bëjë matjet për vëllimet e prodhimit dhe vlerën e prodhimit. Udhëzimi i Ministrit 132/2015 (MEI) "Mbi procedurat e marrëveshjes hidrokarbure", i cili parashikon detyrimin e AKBN për të publikuar dhe të deklaruar informacione në lidhje me hartën e Blloqeve të Kërkimit të Lirë për hidrokarburet.		
3.2 Prodhimi Vendet zbatuese duhet të zbulojnë të dhënat e prodhimit për vitin fiskal të mbuluar nga Raporti EITI, duke përfshirë vëllimet totale të prodhimit dhe vlerën e prodhimit për produkt, dhe, kur është e përshtatshme, nga shteti / rajonin. Kjo mund të përfshijë burime të të dhënave të prodhimit dhe informacion se si janë llogaritur vëllimet e prodhimit dhe vlerat e paraqitura në Raportin EITI.	0.1	Ligji nr. 7746, datë 28.07.1993 "Për hidrokarburet" (kërkimi dhe prodhimi), i ndryshuar, në nenin 9, paragrafi 3 parashikon detyrimin e të licencuarve për të raportuar të dhëna dhe informacion në përputhje me Standardin EITI. Ky nen përcakton detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Administratës doganore shqiptare dhe institucioneve publike qendrore dhe lokale mbledhjen e të	P	Arsyetimi, se kërkesat e raportimit EITI për institucionet qeveritare, aktualisht bien bdesht me detyrën statutore të subjekteve publike që përpunojnë këtë informacion , për të ruajtur konfidencialitetin mbi informacionin e marrë në aspektin e detyrave të tyre rregullatore, siç përmendet në ligjet e aplikueshme të tatimit dhe procedurat doganore në Shqipëri, nuk qëndron, pasi, detyrimi që rrjedh nga një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë (anëtarësim në EITI) zëvendëson detyrimin që rrjedh nga këto akte statutore.

		ardhurave nga sektori për të raportuar në përputhje me rrethanat. Urdhër nr. 389, datë 25.11.2014 "Për informacionin dhe të dhënat të cilat duhet të dorëzohen nga persona juridikë, që veprojnë në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës dhe derivateve të saj." Sipas Nenit 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 547/2006 (i ndryshuar), AKBN detyrohet të mbledhë informacione në lidhje me të dhënat për prodhimin e hidrokarbureve, prodhimi potencial dhe aktual, të bëjë matjet për vëllimet e prodhimit dhe vlerën e prodhimit.		Mangësia kryesore në publikimin e këtij informacioni rrjedh nga mungesa e procedurave të brendshme administrative dhe instrumenteve për shkëmbimin e informacionit ndërmjet organeve publike dhe palëve të interesuara.
3.3 eksportet Vendet zbatuese duhet të publikojnë të dhënat e eksportit për vitin fiskal të mbuluar nga Raporti EITI, duke përfshirë vëllimet totale të eksportit dhe vlerës së eksporteve për produkt, dhe, kur është relevante, shtetin/ rajonin e origjinës. Kjo mund të përfshijë burime të të dhënave të eksportit dhe informacion se si janë llogaritur vëllimet e eksportit dhe vlerat e paraqitura në Raportin EITI	0.1	Ligji nr. 7746, datë 28.07.1993 "Për hidrokarburet" (kërkimi dhe prodhimi), i ndryshuar, në nenin 9, paragrafi 3 parashikon detyrimin e të licencuarve për të raportuar të dhëna dhe informacion në përputhje me Standardin EITI. Ky nen përcakton detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Administratës doganore shqiptare dhe institucioneve publike qendrore dhe lokale mbledhjen e të ardhurave nga sektori për të	P	Arsyetimi, se kërkesat e raportimit EITI për institucionet qeveritare, aktualisht bien bdesht me detyrën statutore të subjekteve publike që përpunojnë këtë informacion , për të ruajtur konfidencialitetin mbi informacionin e marrë në aspektin e detyrave të tyre rregullatore, siç përmendet në ligjet e aplikueshme të tatimit dhe procedurat doganore në Shqipëri, nuk qëndron, pasi, detyrimi që rrjedh nga një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë (anëtarësim në EITI) zëvendëson detyrimin që rrjedh nga këto akte statutore.

		raportuar në përputhje me rrethanat. Urdhër nr. 389, datë 25.11.2014 "Për informacionin dhe të dhënat të cilat duhet të dorëzohen nga persona juridikë, që veprojnë në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës dhe derivateve të saj." VKM Nr.411 datë 13.05.2015 "Për procedurat dhe kushtet për dhënien e përsëritjen e licencës së koncesionit të naftës-jellësve për importimin, eksportimin dhe transportimin e naftës bruto", në paragrafin 4 siguron detyrimin e operatorit/ëve për të respektuar detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, pra detyrimin për të raportuar rast pas rasti Sekretariatit EITI.		Mangësia kryesore në publikimin e këtij informacioni rrjedh nga mungesa e procedurave të brendshme administrative dhe instrumenteve për shkëmbimin e informacionit ndërmjet organeve publike dhe palëve të interesuara.
--	--	--	--	--

Kërkesa EITI 4: Mbledhja e të ardhurave

4. Publikimi i plotë i tatimeve dhe të ardhurave a) Në prag të procesit të raportimit, grupi shumë-palësh duhet të dakordësojë se cilat pagesa dhe të ardhura janë të rëndësishme dhe për këtë arsye duhet të publikohen, përfshirë përkufizimet e duhura dhe pragjet. Pagesat dhe të ardhurat konsiderohen të rëndësishme nëse mungesa e tyre apo gabimet mund të ndikojnë dukshëm në tërësinë e Raportit EITI. Një përshkrim i të ardhurave, përkufizimet që lidhen me to dhe pragjet duhet të publikohen. Në përcaktimin e rëndësisë së përkufizimeve dhe pragjeve, grupi shumë-palësh duhet të marrë në konsideratë sasinë e të ardhurave në raport me totalin e të ardhurave. Grupi shumë-palësh duhet të dokumentojë opsionet e konsideruara dhe arsyetimin për caktimin e përkufizimeve dhe pragjeve. b) Të ardhurat në vijim duhet të përfshihen: i. E drejta e prodhimit e qeverisë pritëse ii. drejta e prodhimit e kompania me kapital shtetëror iii. fitimet nga taksat iv. honoraret(royalties)	0.1	Ligji nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për hidrokarburet” (kërkimi dhe prodhimi), i ndryshuar, në nenin 9, paragrafi 3 parashikon detyrimin e të licencuarve për të raportuar të dhëna dhe informacion në përputhje me Standardin EITI. Ky nen përcakton detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Administratës doganore shqiptare dhe institucioneve publike qendrore dhe lokale mbledhjen e të ardhurave nga sektori për të raportuar në përputhje me rrethanat. Udhëzimi i përbashkët i Ministrave nr 3492/2015, paragrafi 6/2 i detyron institucionet përkatëse për të shkëmbyer informacion mbi regjimin fiskal dhe shkelje të tjera për qëllim të kontrollit zyrtar, i cili nuk përputhet me detyrimin e transparencës siç parashikohet nga EITI.	P	Nuk ka detyrime dhe procedura ligjore që rregullojnë transparencën mbi regjimin fiskal që udhëheq industrinë nxjerrëse në lidhje me hidrokarburet, edhe pse informacioni selektiv është bërë publik në baza të përkohshme, por ky publikim nuk rrjedh nga një detyrim i qartë ligjor. Ligji nr. 7811, datë 12.04.1994 "Për miratimin e ndryshime në dekretin nr. 782, datë 22.02.1994" Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve (kërkim-prodhim) i ndryshuar, duhet të ndryshohet në mënyrë që të përfshijë informacionin e kërkuar. Arsyetimi, se kërkesat e raportimit EITI për institucionet qeveritare, aktualisht bien besh me detyrën statutoire të subjekteve publike që përpunojnë këtë informacion , për të ruajtur konfidencialitetin mbi informacionin e marrë në aspektin e detyrave të tyre rregullatore, siç përmendet në ligjet e aplikueshme të tatimit dhe procedurat doganore në Shqipëri, nuk qëndron, pasi, detyrimi që rrjedh nga një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë (anëtarësim në EITI) zëvendëson detyrimin që rrjedh nga këto akte statutoire.
---	------------	---	----------	---

v. Dividendët vi. Bonuset, të tilla si nënshkrim, zbulimi dhe shpërblimet e prodhimit vii. tarifatat për licenca, tarifatat me qira, tarifatat e hyrjes dhe konsiderata të tjera për licenca dhe / ose koncesione viii. Çdo pagesë tjetër e rëndësishme dhe përfitim i rëndësishëm për qeverinë Të ardhurat ose përfitimet duhet të përjashtohen vetëm kur ato nuk janë të zbatueshme, ose ku grupi shumë palësh bie dakord se mosveprimi i tyre nuk do të ndikojë materialisht në tërësinë e Raportit EITI. c) Vendet zbatuese duhet të sigurojnë një rakordim të plotë të ardhurave të qeverisë dhe pagesat e kompanisë, duke përfshirë pagesat për dhe nga ndërmarrjet shtetërore, në përputhje me qëllimin e rënë dakord. Të gjitha kompanitë që bëjnë pagesa materiale për qeverinë duhet të publikojnë plotësisht këto pagesa në përputhje me qëllimin e rënë dakord. Një subjekt duhet të përjashtohet nga raportimi vetëm nëse mund të demonstron se pagesat dhe të ardhurat e saj nuk janë materiale. Të gjitha subjektet qeveritare që marrin të ardhura materiale duhet të publikojnë plotësisht këto të hyra në përputhje me qëllimin e rënë dakord.				
--	--	--	--	--

d) vetëm nëse ekzistojnë pengesa të rëndësishme praktike, qeverisë i kërkohet gjithashtu të sigurojë informacione të përgjithshme në lidhje me sasinë e të ardhurave totale të marra nga secili prej flukseve të përfitimit të dakorduara në kuadër të Raportit EITI, duke përfshirë të ardhurat që bien nën pragun e materialitetit të dakordësuar. Kur këto të dhëna nuk janë të disponueshme, Administratori i Pavarur duhet të nxjerrë të dhënat përkatëse dhe vlerësimet nga burime të tjera për të siguruar një vlerësim gjithëpërfshirës të të ardhurave totale të qeverisë.				
4.2 Shitja e pjesës shtetërore të prodhimit ose të ardhura të tjera të mbledhura në natyrë Ku shitja e pjesës shtetërore të prodhimit ose të ardhura të tjera të mbledhura në natyrë është materiale, qeveria, duke përfshirë edhe ndërmarrjet shtetërore, duhet të publikojnë vëllime të shitjeve dhe të ardhurat e marra. Të dhënat e publikuara duhet të ndahen nga blerjet individuale të kompanisë dhe në nivele proporcionale me raportimin e pagesave të tjera dhe të ardhurave (4.7). Raportimi mund të përfshijë dhënien e informacioneve shpjeguese sipas llojit të produktit, çmimit, tregut dhe vëllimit të shitjes. Ku është praktikisht e	0.1	Ligji nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për hidrokarburet” (kërkimi dhe prodhimi), i ndryshuar, në nenin 9, paragrafi 3 parashikon detyrimin e të licencuarve për të raportuar të dhëna dhe informacion në përputhje me Standardin EITI. Ky nen përcakton detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Administratës doganore shqiptare dhe institucioneve publike qendrore dhe lokale mbledhjen e të ardhurave nga sektori për të raportuar në përputhje me rrethanat.	F	

realizueshme, grupi shumë-palësh inkurajohet ti caktojë Administratorit të Pavarur detyrën e harmonizimit të vëllimeve të shitura dhe të ardhurave të fituara duke përfshirë kompanitë blerëse në procesin e raportimit.		Urdhër nr. 389, datë 25.11.2014 "Për informacionin dhe të dhënat të cilat duhet të dorëzohen nga persona juridikë, që veprojnë në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës dhe derivateve të saj." Sipas Nenit 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 547/2006 (i ndryshuar), AKBN detyrohet të mbledhë informacione në lidhje me të dhënat për prodhimin e hidrokarbureve, prodhimi potencial dhe aktual, të bëjë matjet për vëllimet e prodhimit dhe vlerën e prodhimit.		
4.3 Dispozitat e infrastrukturës dhe marrëveshjet e shkëmbimit Grupi shumë-palësh dhe Administratori i Pavarur duhet të marrin në konsideratë nëse ka ndonjë marrëveshje, apo grupe marrëveshjesh që përfshijnë ofrimin e mallrave dhe shërbimeve (duke përfshirë kredi, grante dhe veprat e infrastrukturës), në këmbim të plotë ose të pjesshëm për kërkimin dhe prodhimin e naftës, gazit ose minierave apo koncesionet e prodhimit ose ofrimit fizik të këtyre produkteve. Për të qenë në gjendje për ta bërë këtë, grupi shumë-palësh dhe Administratori i Pavarur duhet të kenë një kuptim të plotë të:	0.15	Vendimi nr. 71, datë 21.07.2011 i Kryeministrit "Për krijimin dhe organizimin e Grupit Shumë-palësh për përfshirjen e Shqipërisë në Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI). Vendimi nr. 993, datë 09.12.2015 i Këshillit të Ministrave "Për organizimin dhe funksionimin e Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (Sekretariati Shqiptar EITI), në mbështetje të anëtarësimit në Organizatën Ndërkombëtare EITI";	F	

kushteve të marrëveshjeve përkatëse dhe kontratave, palët e përfshira, burimet të cilat zotërihen nga shteti, vlera e përfitimeve të balancuara (p.sh. punët infrastrukturore), dhe natyra e këtyre marrëveshjeve në raport me kontratat konvencionale. Ku grupi shumë-palësh arrin në përfundimin se këto marrëveshje janë materiale, ai dhe Administratori i Pavarur duhet të sigurojnë se Raporti EITI adreson këto marrëveshje, duke siguruar një nivel të detajeve dhe transparencës në përpjesëtim me zbulimin dhe barazimin e pagesave të tjera dhe të ardhurave. Kur bashkërendimi i transaksioneve kryesore nuk është i realizueshëm, grupi shumëpalësh duhet të dakordësojë një qasje për zbulimin e njëanshme nga ana e palëve të marrëveshjes që do të përfshihet në Raportin EITI.				
4.4 Të ardhurat e transportit Ku të hyrat nga transportimin e naftës, gazit dhe mineraleve janë materiale, qeveria dhe ndërmarrjet shtetërore (NSH) duhet të publikojnë të ardhurat e marra. Të dhënat e publikuara duhet të ndahen në nivele proporcionale me raportimin e pagesave të tjera dhe të ardhurave (4.7). Vendet zbatuese mund të japë informacion shpjegues: a) Një përshkrim të marrëveshjeve të transportit, duke përfshirë: produktit;	0.1	Ligji nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për hidrokarburet” (kërkimi dhe prodhimi), i ndryshuar, në nenin 9, paragrafi 3 parashikon detyrimin e të licencuarve për të raportuar të dhëna dhe informacion në përputhje me Standardin EITI. Ky nen përcakton detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Administratës doganore shqiptare dhe institucioneve publike qendrore dhe lokale mbledhjen e të ardhurave nga sektori për të	F	

rruga e transportit; dhe kompanitë përkatëse dhe subjektet qeveritare, duke përfshirë NSH, të përfshirë në transportin. b) Përkufizimet e taksave përkatëse të transportit, tarifat ose pagesat e tjera përkatëse, si dhe metodologjitë e përdorur për llogaritjen e tyre. c) Zbulimi i tarifave dhe vëllimit të mallrave të transportuara. d) Zbulimi i të ardhurave të marra nga subjektet qeveritare dhe NSH, në lidhje me transportin e naftës, gazit dhe mineraleve. e) Kur është e mundur, grupi shumë palësh inkurajohet ti caktojë detyrë Administratorit të Pavarur harmonizimin e pagesave materiale dhe të ardhurat që lidhen me transportin e naftës, gazit dhe mineraleve.		raportuar në përputhje me rrethanat. Urdhër nr. 389, datë 25.11.2014 "Për informacionin dhe të dhënat të cilat duhet të dorëzohen nga persona juridikë, që veprojnë në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës dhe derivateve të saj." VKM Nr.411 datë 13.05.2015 "Për procedurat dhe kushtet për dhënien e përsëritjen e licencës së koncesionit të naftës-jellësve për importimin, eksportimin dhe transportimin e naftës bruto", në paragrafin 4 siguron detyrimin e operatorit/ëve për të respektuar detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, pra detyrimin për të raportuar rast pas rasti Sekretariatit EITI.		
4.5 Transaksionet që lidhen me ndërmarrjet shtetërore. Grupi shumë palësh duhet të sigurojë që procesi i raportimit trajton plotësisht rolin e ndërmarrjeve shtetërore (NSH), duke përfshirë edhe pagesat materiale të NSH-ve nga kompanitë e naftës, gazit dhe minierave, dhe	0.1	Ligji nr. 7746, datë 28.07.1993 "Për hidrokarburet" (kërkimi dhe prodhimi), i ndryshuar, në nenin 9, paragrafi 3 parashikon detyrimin e të licencuarve për të raportuar të dhëna dhe informacion në përputhje me Standardin EITI. Ky nen përcakton detyrimin e	F	

transferimet midis NSH-ve dhe agjencive të tjera qeveritare.		Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Administratës doganore shqiptare dhe institucioneve publike qendrore dhe lokale mbledhjen e të ardhurave nga sektori për të raportuar në përputhje me rrethanat. Vendimi nr. 71, datë 21.07.2011 I Kryeministrit “Për krijimin dhe organizimin e Grupit Shumë-palësh për përfshirjen e Shqipërisë në Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI). Vendimi nr. 993, datë 09.12.2015 i Këshillit të Ministrive “Për organizimin dhe funksionimin e Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (Sekretariati Shqiptar EITI), në mbështetje të anëtarësimit në Organizatën Ndërkombëtare EITI”;		
4.6 Pagesat nën-kombëtare. Është e nevojshme që grupi shumë palësh të përcaktojë nëse pagesat e drejtpërdrejta, në kuadër të rrjedhave të përfitimit të miratuara, nga kompanitë për subjektet qeveritare nën kombëtare janë materiale. Nëse janë materiale, grupi shumë-palësh duhet të sigurojë që pagesat e kompanisë për subjektet qeveritare nënkombëtare dhe marrja e këtyre pagesave janë publikuar dhe			N/A	

rakordohen në Raportin EITI.				
4.7 Niveli i ndarjes. Grupi shumëpalësh nevojitet të dakordësojë nivelin e ndarjes për publikimin e të dhënave. Është e nevojshme që të dhënat EITI të paraqiten nga kompania, entitet qeveritare dhe rrjedha e të ardhurave. Raportimi në nivel projekti është e nevojshme, me kusht që të jetë përputhje me rregullat e Letrave me Vlerë të Shteteve të Bashkuara dhe Shkëmbimi i rregullave të Komisionit dhe kërkesat e ardhshme të Bashkimit Evropian..			N/A	
4.8 Afatet kohore të të dhënave a) Vendet zbatuese duhet të hartojnë Raportin e tyre të parë EITI brenda 18 muajve pasi janë pranuar si një vend kandidat EITI. Pas kësaj, vendet zbatuese pritët të prodhojnë Raportet EITI në baza vjetore. b) Vendet zbatuese duhet të publikojnë të dhëna jo më të vjetra se sa dy vitë të plota fiskale, psh Raportin EITI i publikuar në vitin kalendarik /financiar 2016 duhet të bazohet në të dhënat jo më vonë se viti kalendarik/financiar 2014. Grupet Shumë-palëshe inkurajohen për të eksploruar mundësi që të publikojnë	0.15	Vendimi nr. 71, datë 21.07.2011 i Kryeministrit “Për krijimin dhe organizimin e Grupit Shumë-palësh për përfshirjen e Shqipërisë në Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI). Vendimi nr. 993, datë 09.12.2015 i Këshillit të Ministrive “Për organizimin dhe funksionimin e Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (Sekretariati Shqiptar EITI), në mbështetje të anëtarësimit në Organizatën Ndërkombëtare EITI”;	F	

të dhëna sa më parë që të jetë e mundur praktikisht, për shembull me anë të dhënies së informacioneve shpjeguese të vazhdueshme online ose, kur është e mundur, duke publikuar të dhëna EITI të azhurnuara shtesë, kontekstuale se sa të dhënat e të ardhurave EITI të mbuluar nga periudha fiskale. Në rast se raportimi EITI është vonuar në mënyrë të konsiderueshme, grupi shumë-palësh duhet të ndërmarrë hapa për të siguruar që Raportet EITI janë hartuar për periudhat raportuese ndërhyrëse në mënyrë që çdo vit të jetë subjekt i raportimit. c) Grupi shumë-palësh duhet të bien dakord për përcaktimin e periudhës fiskale të mbuluar nga Raportin EITI.				
4.9 Cilësia e të dhënave dhe të sigurimit. a) EITI kërkon një vlerësim nëse pagesat dhe të ardhurat janë subjekt i besueshëm, auditimi të pavarur, duke aplikuar standardet ndërkombëtare të auditimit. b) Është një kërkesë që pagesat dhe të ardhurat të jenë rakorduar nga një, Administrator i Pavarur, i besueshëm duke aplikuar standardet ndërkombëtare të auditimit, si dhe me publikimin e mendimin e administratorit në lidhje me atë rakordim përfshirë mospërputhje, nëse identifikohen.			F	Administratori i Pavarur caktohet "Deloitte" Albania Auditimit

i. Rakordimi i pagesave të kompanive dhe të ardhurave të qeverisë duhet të ndërmerret nga një administrator i pavarur duke aplikuar standardet ndërkombëtare profesionale. ii. Administratori i Pavarur duhet të perceptohet nga grupi shumë palësh që të jetë i besueshëm, i sigurt dhe teknikisht kompetent. Grupi shumë-palësh duhet të miratojë emërimin e Administratorit të Pavarur. iii. Grupi shumë-palësh dhe Administratori i Pavarur duhet të dakordësojnë për termat e referencës të raportit EITI bazuar në standardin e Termave të Referencës dhe e 'të rënë dakord sipas procedurës për EITI Report' miratuar nga Bordi EITI. Nëse grupi shumë-palësh ka dëshirë të përshtatet ose të devijojë nga këto të rëna dakord sipas procedurave, miratimi nga Bordi EITI duhet të kërkohet paraprakisht (Kërkesa 8.1).				
Kërkesa EITI 5: Alokimet e të ardhurave				

5.1 Shpërndarja e të ardhurave të industrisë nxjerrëse. Vendet zbatuese duhet të deklarojnë një përshkrim të shpërndarjes së të ardhurave nga industritë nxjerrëse. a) Vendet zbatuese duhet të tregojnë se cilat të ardhura të industrisë nxjerrëse, qoftë në të holla ose në natyrë, janë regjistruar në buxhetin kombëtar. Nëse të ardhurat nuk janë regjistruar në buxhetin e shtetit, alokimi i këtyre të ardhurave duhet të shpjegohet, me link të vendosura në raportet përkatëse financiare sipas rastit, për shembull, të pasurisë sovrane dhe fondeve të zhvillimit, qeveritë rajonale, ndërmarrjet shtetërore, dhe të tjera subjekte ekstra-buxhetore.		Ligji nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për hidrokarburet” (kërkimi dhe prodhimi), i ndryshuar, në nenin 9, paragrafi 3 parashikon detyrimin e të licencuarve për të raportuar të dhëna dhe informacion në përputhje me Standardin EITI. Ky nen përcakton detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Administratës doganore shqiptare dhe institucioneve publike qendrore dhe lokale mbledhjen e të ardhurave nga sektori për të raportuar në përputhje me rrethanat. Vendimi nr. 71, datë 21.07.2011 I Kryeministrit “Për krijimin dhe organizimin e Grupit Shumë-palësh për përfshirjen e Shqipërisë në Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI). Vendimi nr. 993, datë 09.12.2015 i Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (Sekretariati Shqiptar EITI), në mbështetje të anëtarësimit në Organizatën Ndërkombëtare EITI”;	F	
5.2 Transfertat rajonale. a) Kur transferimet ndërmjet subjekteve qeveritare kombëtare dhe rajonale janë të lidhura me të ardhurat e gjeneruara nga industritë nxjerrëse dhe janë mandatuar nga një			N/A	

kushtetutë kombëtare, statut apo mekanizëm tjetër për alokimin e të ardhurave, grupi shumë-palësh duhet të sigurojë që transfertat e rëndësishme janë publikuar. Vendet zbatuese duhet të publikojnë formulën për ndarjen e të ardhurave, nëse ka, si dhe çdo mospërputhje në midis shumës së llogaritur të transferimit në përputhje me formulën përkatëse për ndarjen e të ardhurave dhe shumës aktuale që u transferua midis pushtetit qendror dhe çdo subjekti përkatës rajonal.				
---	--	--	--	--

FORMATI I PLANIT UDHËZUES TË PRONËSISË PËRFITUESE

REKOMANDIME TË PLANIT UDHËZUES	OBJEKTIVAT	AKTIVITETET(NEVOJAT PËR RRIJJEKAPACITETESH, ASISTENCË TEKNIKE)	AUTORITETI PËRGJEGJËS	AFATET	ASISTENCË FINANCIARE (KOSTO DHE FINANCIM)
1. Konsideroni lidhjet midis PP dhe prioriteteve të reformave kombëtare	Mbështetja e rritjen së transparencës dhe luftës kundër korrupsionit, e cila është një kërkesë e rëndësishme për anëtarësimin e Shqipërisë në BE.				
2. Konsideroni kornizën institucionale për publikimin e PP	Krijimi i mënyrës më të mirë /efektive për të publikuar PP(psh nëse duke përfshirë përkufizimin dhe detyrimin për publikimin e PP në legjislacionin ekzistues ose e kundërta)	Rishikimi dhe / ose ndryshimi i kërkesave ekzistuese të dorëzimit të kompanisë pas regjistrimit të kompanive për të përfshirë informacion mbi pronësinë përfituese, dhe të konsiderojë që të shtojë kërkesat për deklarim në lidhje me publikim e pronësisë përfituese në proceset e tenderimit dhe regjistrat e licencës për projekte nxjerrëse.	EITI Shqipëri		
3.Përkufizimi i Pronësisë	MSG duhet të dakordësojë mbi një përkufizim të PP	Shqyrtimi nëse ligjet kombëtare përfshijnë një		Nga Jan 2017	

REKOMANDIME TË PLANIT UDHËZUES	OBJEKTIVAT	AKTIVITETET(NEVOJAT PËR RRITJEKAPACITETESH, ASISTENCË TEKNIKE)	AUTORITETI PËRGJEGJËS	AFATET	ASISTENCË FINANCIARE (KOSTO DHE FINANCIM)
Përfituese	për tu zbatuar në kontekstin kombëtar legjislativ dhe të plotësojë Standardin EITI për PP si dhe normat e tjera ndërkombëtare përkatëse. MSG duhet të dakordësojë mbi pragjet e zbatueshme.	përkufizim të pronarëve përfitues, duke eksploruar definicionet ndërkombëtare dhe kombëtare ekzistuese, si dhe dakordësimi i një përkufizimi të duhur për pronësinë përfituese dhe për pragjet në mënyrë që të vendosë në zbatim raportimin e pronësisë përfituese Angazhimi i juristëve kombëtarë dhe lokal për të këshilluar në përkufizimin dhe zbatimin PP/ MSG për t'u takuar, diskutuar dhe të bien dakord për përcaktimin e OB.		Nga Jan 2017	
4. rRaportimi i detyrimeve për Personat e ekspozuar politikisht	MSG duhet të dakordësojë për raportimin e detyrimeve për PEP dhe përkufizimet e aplikueshme / pragjet për të përmbushur standardet EITI dhe normat përkatëse ndërkombëtare.	Identifikimi i përkufizimeve ekzistuese kombëtare dhe ndërkombëtare dhe kërkesave të raportimit për PEP me qëllim të identifikimit të objektivave të politikës kombëtare mbi këtë temë dhe përafrimin e përkufizimit për pronësinë përfituese në përputhje me rrethanat.		Në progres	
5.niveli i detajeve që duhet të publikohen		Konsultimi me qeverinë, shoqërinë civile dhe kompanitë në lidhje me nivelin			

REKOMANDIME TË PLANIT UDHËZUES	OBJEKTIVAT	AKTIVITETET(NEVOJAT PËR RRITJEKAPACITETESH, ASISTENCË TEKNIKE)	AUTORITETI PËRGJEGJËS	AFATET	ASISTENCË FINANCIARE (KOSTO DHE FINANCIM)
		e detajeve shitesë të informacioneve shpjeguese të pronësisë përfituese, duke përfshirë mundësitë dhe sfidat për publikim e rekomanduar të informacioneve të tilla si data e lindjes dhe mjetet të kontaktit. Plani udhëzues gjithashtu mund të specifikojë nëse MSG synon të përdorë modelin e formularit të deklarimit të pronësisë përfituese të EITI, ndoshta me disa përshtatje lokale, apo nëse NSG ka për qëllim të hartojë formën e vet të deklarimit. Organizimi i seminarit me kompanitë përkatëse të lejuara për të shpjeguar kuptimin rreth publikimit të PP dhe çfarë duhet të shpalosen në praktikë.			
6.Mbledhja e të dhënave	MSG duhet të marrë në konsideratë mënyrat më efikase për të mbledhur të dhëna për PP/PEP dhe cdo pengesë, duke përfshirë shqyrtimin dhe përcaktimin e modelit të deklaratës për PP që do të përdoret nga kompanitë përkatëse.	Identifikimi i kompanive që do të duhet të marrin pjesë në raportimin e pronësisë përfituese. Plani udhëzues mund të përfshijë edhe aktivitete konsultative që synojnë identifikimin e qasjes më efikase dhe të qëndrueshme të mbledhjes së të dhënave.			

REKOMANDIME TË PLANIT UDHËZUES	OBJEKTIVAT	AKTIVITETET(NEVOJAT PËR RRITJEKAPACITETESH, ASISTENCË TEKNIKE)	AUTORITETI PËRGJEGJËS	AFATET	ASISTENCË FINANCIARE (KOSTO DHE FINANCIM)
		Organizimi i seminareve në lidhje me PP dhe përkufizimit të tij si dhe kërkesat për deklarim nga juristë dhe ftesa në seminar e përfaqësuesve të lartë të kompanive përgjegjëse të industrisë nxjerrëse. Hartimi i formularit të deklarimit të PP në seminar dhe të ofrojë udhëzime të qarta se si të plotësohen këto në procesin e dorëzimit të tyre.			
7.Sigurimi i saktësisë së të dhënave					
8.Afatet e të dhëbave					
9. Aksesueshmëria e të dhënave					



**KUVENDI
PROJEKTLIGJ**

Nr. _____, datë _____ 2017

**PËR TRANSPARENCËN E VEPRIMTARIVE TË INDUSTRIVE NXJERRËSE DHE SHFRYTËZIMIT TË BURIMEVE
NATYRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në zbatim të neneve 78 dhe 83, paragrafi 1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Qëllimi i Ligjit

1. Qëllimi i këtij ligji është të nxisë dhe sigurojë rritjen e transparencës në veprimtaritë e industrive nxjerrëse në veçanti dhe shfrytëzimit të burimeve natyrore në përgjithësi, përmes zbatimit të standardeve ndërkombëtare të raportimit të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse, këtu e në vijim referuar në këtë ligj si “EITI”.
2. Zbatimi i Standardit EITI synon të rrisë përgjegjshmërinë në mbledhjen dhe administrimin e të ardhurave nga veprimtaritë e industrive nxjerrëse dhe ato të shfrytëzimit të burimeve natyrore me qëllim përdorimin e tyre në dobi të zhvillimit ekonomik e social dhe përmirësimit të klimës së investimeve në Shqipëri.
3. Ky ligj synon të përmirësojë cilësinë e informacionit për veprimtaritë e industrisë nxjerrëse dhe shfrytëzimit të burimeve natyrore.

Neni 2

Objekti i ligjit

1. Objekti i këtij ligji është të përcaktojë rregullat bazë për institucionet dhe/ose agjencitë përgjegjëse shtetërore si edhe për subjektet juridike private apo publike të kontrolluara nga shteti, që operojnë në sektorët e industrive nxjerrëse dhe shfrytëzimit të burimeve natyrore në lidhje me detyrimin e tyre për të mbledhur, administruar e raportuar në mënyrë periodike të dhënat, sipas kërkesave dhe afateve të parashikuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore të tij.

2. Ky ligj gjithashtu përcakton masat administrative që zbatohen në rast të mospërmbushjes së detyrimit për të paraqitur të dhënat e kërkuara në mënyrë të saktë, të plotë dhe brenda afatit kohor të caktuar.

Neni 3

Fusha e veprimtarisë së ligjit

1. Ky ligj zbatohet për subjektet e përcaktuaranë pikën 2 të këtij neni, përsa i përket detyrimit të tyre për të raportuar dhe për të krahasuar të dhënat mbi prodhimin dhe proceset përkatëse, pagesat fiskale dhe pagesat e tjera të kryera në kuadër të veprimtarive në industritë nxjerrëse dhe sektorin e hidroenergjisë.

2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për:

a) personat juridikë publikë dhe privatë, vendas ose të huaj, që kryejnë aktivitete për kërkim dhe shfrytëzim në sektorin e hidrokarbureve dhe minierave si edhe ato që operojnë në sektorin e hidroenergjisë në Republikën e Shqipërisë;

b) institucionet shtetërore dhe/ose personat juridik publik, të cilat sipas legjislacionit përkatës në fuqi, lidhin dhe mbikëqyrin kontratat dhe/ose lëshojnë dhe monitorojnë lejet, licencat dhe autorizimet për të operuar në sektorin e industrive nxjerrëse dhe sektorin e hidroenergjisë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

c) administrata doganore dhe tatimore, në nivel qendror, dhe njësitë e qeverisjes vendore;

d) Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse në Shqipëri, këtu e në vijim referuar si “EITI Shqipëri”;

e) çdo institucion tjetër shtetëror dhe/ose person juridik publik që, bazuar në detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, mbledh dhe/ose administron dhe /ose publikon të dhënat që lidhen me aktivitetet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, duke përfshirë ministritë e linjës, njësitë e tyre në varësi si edhe Institutin e Statistikave.

Neni 4

Përkufizime

1. Për qëllim të këtij ligji, termat e përzgjedhur si më poshtë kanë këto kuptime:

- a. “Standardi EITI” nënkupton standardin ndërkombëtar për transparencë, i përbërë nga kërkesa specifike, në drejtim të përmirësimit të qeverisjes së burimeve natyrore;
 - b. “Raporti EITI” nënkupton raportin vjetor të hartuar nga Shqipëria, si një vend zbatues i EITI, që përmban informacion për sektorin e industrive nxjerrëse dhe sektorin e hidroenergjisë, i përbërë nga informacioni përshkrues dhe të dhëna sasiore, me qëllim arritjen e transparencës në mbledhjen dhe administrimin e të ardhurave që realizohen nga shfrytëzimi i këtyre sektorëve;
 - c. “Industritë nxjerrëse” përfshijnë industritë nxjerrëse të naftës, gazit dhe mineraleve.
 - d. “Burime natyrore” nënkupton për qëllim të raportit EITI vetëm sektorët e përcaktuara në shkronjën (c) të këtij neni dhe sektorin e hidroenergjisë, të cilët konsiderohen më strategjikë dhe për të cilët Shqipëria ka marrë angazhimin për përmbushjen e kërkesave të EITI.
 - e. “Raportim vjetor” nënkupton vitin kalendarik që fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor.
 - f. “Plani i punës” nënkupton një dokument të hartuar dhe miratuar nga grupi shumë-palësh, që përfshin objektivat dhe prioritetet për zbatimin e EITI si dhe aktivitetet e lidhura me to, të cilat duhet të jenë të matshme, në afate kohore të përcaktuara, të kostuara në mënyrë të plotë dhe në përputhje me afatet e raportimit dhe validimit.
 - g. “Pronar përfitues” nënkupton çdo person fizik (individë) i cili përfundimisht zotëron ose kontrollon klientin ose personat fizikë (individët) për llogari të të cilëve është kryer një aktivitet ose transaksion.
 - h. “Sekretariati për Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI Shqipëri) është institucion qendror, person juridik, në varësi të ministrisë përgjegjëse për energjinë dhe industrinë, që ushtron funksionet në kuadër të anëtarësimit në organizmin ndërkombëtar “EITI-Ndërkombëtar”.
2. Për termat e tjerë të përdorur në këtë ligj, duhet të bëhet referim tek ligji që rregullon kryesisht çështjen përkatëse si dhe tek fjalori i EITI.

Neni 5

Raporti EITI

1. Raporti EITI ka për qëllim që të rrisë transparencën dhe llogaridhënien në administrimin e të ardhurave nga veprimtaritë e shfrytëzimit të industrinë nxjerrëse dhe burimeve të hidroenergjisë.
2. Raporti EITI lehtëson angazhimin e të gjithë aktorëve të përfshirë në procesin EITI dhe palëve të tjera të interesuara për të marrë informacion në lidhje me administrimin sektorëve të industrive nxjerrëse dhe sektorit të hidroenergjisë në një format që mundëson të kuptuarin, analizimin dhe llogaridhënien në mënyrë të drejtë në këta sektorë.

3. Në përputhje me parashikimet ligjore dhe kërkesat e Standardit EITI, raporti EITI do të zgjerojë fushën e veprimtarisë duke përfshirë informacione mbi administrimin e burimeve të tjera natyrore.
4. Raporti EITI hartohet dhe publikohet nëpërputhje me parashikimet e Standardit EITI.
5. Grupi shumë-palësh inkurajohet për të shqyrtuar mundësi për të publikuar të dhëna sa më parë që praktikisht të jetë e mundur, por në çdo rast brenda afateve të përcaktuara në kërkesën përkatëse të Standardit EITI, dhe sipas ndryshimeve që ai mund të ketë në të ardhmen.
6. Mospëmbushja e detyrimit për të dorëzuar në kohë raporte të pranueshme në përputhje me kërkesat e Standardit EITI shkakton pezullimin ose revokimin e statusit të Shqipërisë si vend zbatues i EITI.

Neni 6

Materiali i raportimit

1. Raporti vjetor duhet të pasqyrojë një rakordim të plotë të pagesave të subjekteve private dhe publike që kryejnë veprimtari në sektorët e industrisë nxjerrëse dhe hidroenergjisë si edhe të ardhurave që përfiton shteti nga këto veprimtari.
2. Raporti EITI përmban informacion dhe të dhëna në lidhje me
 - a) ndryshimet ligjore dhe reformat e ndërmarra në sektorët e përmendur në pikën 1 të këtij neni, përfshirë parashikimet fiskale;
 - b) kontratat e përfunduara dhe licensat e lëshuara dhe të regjistruara;
 - c) pronarët përfitues të personave juridikë publikë dhe privatë, të që kanë kryer veprimtari ose transaksione në sektorët e përmendur në pikën 1 të këtij neni;
 - d) volumet e shfrytëzimit, prodhimit dhe eksportit;
 - e) pagesat e natyrës fiskale e jo-fiskale dhe të ardhurat e realizuara nga veprimtaritë e transaksionet në sektorët e përmendur në pikën 1 të këtij neni;
 - f) alokimin e të ardhurave nga këto sektorë;
 - g) kontributin e tyre në zhvillimin ekonomik e social të vendit.
2. Informacioni që përfshihet në raport sigurohet nga çdo subjekt i parashikuar në pikën 2 të nenit 3 të këtij ligji, në përputhje me formatin e përcaktuar nga grupi shumë-palësh.

Neni 7

Grupi shumë-palësh

1. Grupi Shumë-palësh (këtu e në vijim referuar si MSG), përbëhet nga përfaqësues të qeverisë, subjekteve që kryejnë veprimtari në industritë nxjerrëse dhe sektorin e hidroenergjisë dhe organizatat të shoqërisë civile.
2. MSG është një organ vendimmarrës i ngarkuar për të udhëhequr dhe menaxhuar zbatimin e standardit EITI në Shqipëri me qëllim për të arritur pajtueshmërinë me EITI, në mënyrë efektive.
3. Organizimi dhe funksionimi i MSG rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 8

Sekretariati Shqiptar i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI Shqipëri)

1. EITI Shqipëri është person juridik publik, në varësi të Ministrisë përgjegjëse për industritë nxjerrëse, që ushtron funksionet në kuadër të anëtarësimit të vendit në organizatën ndërkombëtare "EITI Ndërkombëtar".
2. EITI Shqipëri shërben si sekretariat teknik për aktivitetin e MSG dhe mbledh të gjitha informacionet e dorëzuara nga subjektet e listuara në pikën 2 të nenit 3 të këtij ligji.
3. EITI Shqipëri ka të drejtë të kërkojë informacion shtesë, korrigjime apo sqarime për të dhënat/informacionet e raportuara nga subjektet e përmendura në nenin 3 pika 2 të këtij ligji, të cilat duhet të vihen në dispozicion brenda afatit të përcaktuar në kërkesën për informacion shtesë.
4. Organizimi dhe funksionimi i Sekretariatit të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9

Detyrimi për publikimin e informacionit

1. Subjektet e përcaktuara në nenin 3, pika 2, shkronja b) dhe c) të këtij ligji, janë të detyruar të publikojnë dhe të japin informacione shpjeguese mbi rregullat dhe procedurat në lidhje me mënyrën se si administrohen sektorët e industrive nxjerrëse dhe hidroenergjisë.
2. Secili nga subjektet e përcaktuara në nenin 3, pika 2, shkronja b) të këtij ligji, është i detyruar të japë informacione dhe të publikojë në faqen e vet zyrtare një listë të plotë të kontratave të nënshkruara, lejeve, licencave dhe autorizimeve të dhëna për kërkimin

dhe/ose shfrytëzimin në sektorin e industrisë nxjerrëse dhe hidroenergjisë, përfshirë tekstin këtyre dokumentave, përvec informacioneve që trajtohet si konfidencial.

3. Lista dhe/ose informacionet e përmendura në pikën 1 dhe 2 të këtij neni, duhet të përditësohen në mënyrë periodike për të reflektuar nënshkrimin ose ndërprerjen e kontratave dhe/ose dhënien ose heqjen e lejeve, licencave dhe autorizimeve, sipas rastit.

4. Format i publikimit dhe të dhënat që përjashtohen nga detyrimi për publikim përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për industrinë nxjerrëse.

Neni 10

Detyrimet për raportim periodik

1. Subjektet e përcaktuara në nenin 3, pika 2, shkronja b) të këtij ligji, janë të detyruar të paraqesin tek EITI Shqipëri, informacione periodike dhe raportime në lidhje me kontratat e nënshkruara, lejet, licencat dhe autorizimet e dhëna për kërkim-shfrytëzim në sektorin e industrive nxjerrëse dhe hidroenergjisë.

2. Informacioni dhe raportimi duhet të përfshijnë edhe të dhëna për të ardhurat e mbledhura nga kontraktorët dhe/ose mbajtësit e licencave, lejeve dhe autorizimeve të tilla si pagesat për bonuse të trajnimit, bonuse të nënshkrimit, bonuset e kërkimit, pagesat e tarifave të licencave, pagesat për leje autorizimi, pagesat e qirasë dhe/ose servitutit, tarifat e uzufuktit si edhe pagesa të tjera sikurse përcaktohet në formatet e raportimit.

3. Raportimi i të dhënave sipas pikës 2 të këtij neni, bëhet brenda afateve kohore të përcaktuara në nenin 16 të këtij ligji dhe në përputhje me procedurën dhe formatet e raportimit të propozuara nga ministri përgjegjës për industrinë nxjerrëse dhe miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 11

Detyrimet e subjekteve juridike publike dhe private për raportim periodik

1. Subjektet e përcaktuara në nenin 3, pika 2, shkronja a) të këtij ligji, janë të detyruara të dorëzojnë tek EITI Shqipëri, informacione periodike dhe raportime mbi prodhimin realizuar, prodhimin e eksportuar, të dhënat për proceset përkatëse të prodhimit, vlerat e tarifave dhe taksave të paguara në organet e administratës tatimore dhe doganore si edhe pagesa të tjera, përfshirë por pa u kufizuar në pagesat e bonuseve për prodhim, trajnim, detyrime, pagesat e qirasë, pagesat e uzufuktit, servitutit, tarifat e licencave, lejeve e autorizimeve si edhe pagesa të tjera të ngjashme.

2. Informacioni dhe raportimi duhet të përfshijë edhe të dhëna për pagesat e bëra nga kontraktorët dhe / ose mbajtësit e licencave, lejeve dhe autorizimeve të tilla si pagesat për bonuse të trajnimit, shpërblime nënshkrimi, bonuset e kërkimit, shpërblimet e

prodhimit, pagesat e tarifave të licencave, pagesat për lejet e autorizimit, pagesat e qirasë dhe/ose servituti, tarifat e uzufrukti si edhe pagesa të tjera sikurse përcaktohet në formatet e raportimit.

3. Raportimi i të dhënave sipas pikës 1 dhe 2 të këtij neni, bëhet brenda afateve kohore të përcaktuara në nenin 16 të këtij ligji dhe në përputhje me procedurën dhe formatet e raportimit të propozuara nga ministri përgjegjës për industrinë nxjerrëse dhe miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 12

Detyrimi për raportim i administratës doganore e tatimore dhe njësive të qeverisjes vendore

1. Subjektet e përcaktuara në nenin 3, pika 2, shkronja c) të këtij ligji janë të detyruara të raportojnë tek EITI Shqipëri dhe të japin informacione periodike mbi prodhimin, prodhimin e eksportuar, vlerat e tarifave dhe taksave të paguara në administratën tatimore dhe doganore, në nivel qendror dhe vendor dhe pagesa të tjera të realizuara në favor të buxhetit të shtetit dhe/ose buxhetit të pushtetit vendor nga subjektet e përcaktuara në nenin 3 pika 2 shkronja a) të këtij ligji.

2. Raportimi i të dhënave sipas pikës 1 të këtij neni, bëhet brenda afateve kohore të përcaktuara në nenin 16 të këtij ligji dhe në përputhje me procedurën dhe formatet e raportimit të propozuara nga ministri përgjegjës për industrinë nxjerrëse dhe miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 13

Informacioni mbi pronarin përfitues

1 Një pronar përfitues, për qëllim të këtij ligji, konsiderohet individ që zotëron ose kontrollon më shumë se 25% të aksioneve të shoqërisë ose të të drejtave të votimit dhe/ose ai/ajo është i ekspozuar politikisht, pavarësisht pjesëmarrjes. Në rastin e shoqërive të cilat nuk kryejnë aktivitete ekonomike, por veprojnë si ndërmjetës, pragu i zbatueshëm do të ulet në 10%..

2. Subjektet e përcaktuara në nenin 3, pika 2, shkronja a) të këtij ligji, janë të detyruara të japin informacione dhe të raportojnë të dhëna për pronarin/ët përfitues të tyre, duke paraqitur çdo vit Formularin e Deklarimit të Pronësisë Përfituese. Formulari publikohet në faqen zyrtare të EITI Shqipëri dhe depozitohet pranë ministrisë përgjegjëse për industrinë nxjerrëse.

3. Të dhënat e deklaruara në formular do të përfshijë informacion të saktë në lidhje me:

a) emrin e plotë, datën e lindjes, shtetësinë, vendin apo shtetin e banimit, adresat e banimit dhe adresat e shërbimit të çdo pronari përfitues; dhe

b) një deklaratë për natyrën dhe masën e interesit të mbajtur nga secili pronar përfitues.

4. Të dhënat mbi pronësinë përfituese dhe çdo ndryshim i ndodhur raportohen menjëherë në ministrinë përgjegjëse për burimet nxjerrëse, por në çdo rast jo më vonë se 10 ditë pasi ka ndodhur transaksioni.
5. Informacioni mbi pronësinë përfituese është i aksesueshëm në çdo rast nga:
 - a) autoritetet kompetente dhe Drejtoria e Parandalimit të Pastrimit të Parave, pa asnjë kufizim;
 - b) çdo subjekt ose person që tregon një interes të ligjshëm.
6. Subjektet juridike publike dhe private, të huaja apo vendase, të cilat ofertojnë në një procedurë konkurruese dhe/ose në çdo lloj procedure ligjore në mënyrë që të fitojnë një kontratë dhe/ose licencë dhe/ose leje dhe/ose autorizim për të vepruar dhe/ose investuar në industrinë nxjerrëse dhe sektorin e hidroenergjisë duhet të zbulojnë identitetin e pronarit/ëve të tyre përfitues.
7. Subjektet e përcaktuara në nenin 3, pika 2 shkronja b), të këtij ligji, janë të detyruar të përfshijnë kushtin e zbulimit të të dhënave të pronarit përfitues në dokumentat e procedurës konkurruese.

Article 14

Regjistri i pronarëve përfitues

1. Ministria përgjegjëse për industrinë nxjerrëse është përgjegjëse për krijimin, administrimin dhe përditësimin e regjistrit të pronarëve përfitues të subjekteve që ofertojnë, operojnë dhe/ose investojnë në industrinë nxjerrëse dhe sektorin e hidroenergjisë.
2. Informacioni i regjistrit duhet të jetë i aksesueshëm nga publiku, përveç informacionit për datën e lindjes dhe adresën e banimit të pronarit përfitues.
3. Formati i regjistrit, kushtet dhe procedurat e reflektimit të të dhënave dhe informacionit, metodologjia për vlerësimin e informacionit të mbledhur miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 15

Bashkëpunimi ndër-institucional

1. Institucionet shtetërore dhe/ose subjektet juridike publike që mbledhin dhe/ose menaxhojnë dhe/ose publikojnë të dhënat në lidhje me veprimtaritë e kërkimit dhe/ose shfrytëzimit në sektorët e industrisë nxjerrëse dhe hidroenergjisë janë të detyruara që të bashkëpunojnë në mënyrë efektive me EITI Shqipëri përmes shkëmbimit të ndërsjellë të informacionit të administruar prej tyre, në drejtim të përcaktimit dhe përditësimit të informacionit të raportuar nga ana e tyre.

2. Të dhënat mbi pronësinë e subjekteve që veprojnë në sektorët e industrisë nxjerrëse dhe hidroenergjisë, vëllimi i tyre i prodhimit, prodhimi i eksportuar, të dhënat për proceset përkatëse të prodhimit, vlerat e tarifave dhe taksave të paguara dhe pagesat e tjera, të tilla si pagesa të bonusit të prodhimit, trajnimit, nënshkrimit, pagesa e qirasë, uzufuktit, servitutit, tarifës së licencave, lejeve dhe autorizimeve dhe pagesa të tjera të ngjashme, nuk konsiderohen konfidenciale.

3. Administratës doganore dhe tatimore në nivel qendror dhe njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruara të bashkëpunojnë me EITI Shqipëri në kontekstin e përcaktimit dhe përditësimit të informacionit të raportuar nga ana e tyre.

4. EITI Shqipëri mban të informuar rregullisht institucionet përkatëse për aspekte që nuk janë në përputhje të plotë me kërkesat e Standardit EITI, kërkesat dhe afatet e përcaktuara në këtë ligj dhe me aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 16

Afatet e raportimit

Të gjitha subjektet e përmendura në nenin 3 pika 2 shkronja a), b), c) dhe e) të këtij ligji, janë të detyruara të raportojnë tek EITI Shqipëri, informacionin përkatës të disponuar nga ana e tyre, për secilin vit raportues jo më vonë se në datën 31 Mars të vitit pasardhës.

Neni 17

Kundërvajtjet administrative

1. Shkeljet e mëposhtme të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

- a) Mospërbushja e detyrimit për sigurimin e një informacion të saktë dhe të plotë sipas nenit 6 pika 2 dhe 3 të këtij ligji, do të dënohen me gjobë në shumën nga ____deri ____lekë.
- b) Shkelja e nenit 8, pikës 3, do të dënohet me gjobë në shumën prej ____lekë, për çdo kërkesë EITI Shqipëri.
- c) Shkelja e nenit 11 pika 2 do të dënohet me gjobë në shumën prej ____lekë.
- d) Shkelja e nenit 13 pika 3 do të dënohet me gjobë në shumën prej ____lekë dhe mosdeklarimi brenda afatit të përcaktuar në nenin 13 pika 4 do të dënohet me gjobë në shumën prej ____lekë për çdo ditë vonesë.
- e) Shkelja e nenit 16 do të dënohet me gjobë në shumë prej ____lekë për çdo ditë pune vonesë.

2. Në rastin kur institucionet shtetërore dhe publike nuk përmbushin kërkesat dhe afatet kohore të parashikuara në këtë ligj, sipas informacionit të dhënë nga EITI Shqipëri, drejtuesi i institucionit përkatës duhet të zbatojë masa disiplinore ndaj nëpunësit/punonjësit përgjegjës, në përputhje me dispozitat e ligjit për nëpunësit civil, Kodin e Punës ose rregulloren e brendshme.

3. Gjobat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, përcaktohen nga struktura përkatëse pranë ministrisë përgjegjëse për industrinë nxjerrëse sipas verifikimeve të veta dhe informacionit të ofuar nga EITI Shqipëri, në përputhje me natyrën e shkeljes.

4. Në rast se subjektet e përcaktuara në nenin 3, pika 2, shkronja a) të këtij ligji nuk përmbushin, në mënyrë të përsëritur, kërkesat sipas këtij ligji edhe pas aplikimit të masave administrative, sipas pikës 1 të këtij neni, subjekteve të përcaktuara në nenin 3, pika 2 shkronja b) të këtij ligji, pas informacionit të paraqitur nga EITI Shqipëri, i lind e drejta të fillojnë procedurat për anulimin e kontratës dhe / ose heqjen e lejes, licencës apo autorizimit përkatës mbi bazën e të cilit ato subjekte operojnë.

Neni 18

Aktet nënligjore dhe dispozitat tranzitore

1. Këshilli i Ministrave, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, nxjerr aktet nënligjore në zbatim të nenit 7 pika 3, nenit 8 pika 4, nenit 10 pika 3, nenit 11 pika 3, nenit 12 pika 2 dhe nenit 14 pika 3, të këtij ligji.

2. Aktet nënligjore, të cilat rregullojnë veprimtarinë e raportimit të EITI në sektorët e industrisë nxjerrëse dhe hidroenergjisë, të miratuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të zbatohen për aq sa ato janë të zbatueshme dhe nuk e bien në kundërshtim me këtë ligj, deri në miratimin e akteve të reja nënligjore, në përputhje me kërkesat dhe afatet e përcaktuara nga ky ligj.

Neni 19

Shfuqizimi i akteve ligjore

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, neni 36, paragrafi 25, neni 50 pika 5, i Ligjit 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe neni 9, pika 3 e Ligjit 7746, datë 28.07.1993 “Për hidrokarburet ”(kërkimi dhe prodhimi), i ndryshuar, si dhe çdo dispozitë tjetër ligjore e cila nuk është në përputhje me këtë ligj, shfuqizohen.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare

Miratuar më _____

Ky punim u mbështet nga Fondi Shumëdonator i Mbështetjes Programatike Globale për Industrinë Nxjerrëse (EGPS), i administruar nga Banka Botërore. Gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në këtë punim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bankës Botërore, Bordit të Drejtorëve Ekzekutivë të saj apo qeverive që ata përfaqësojnë.